



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT**

**NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE - SHKALLA E TRETË DHE E KATËRT
KLASA VI, VII, VIII, IX**

Shtator 2016

PËRMBAJTJA

PËRMBAJTJA.....	1
1 HYRJE	3
2 KËRKESA PËR ZBATIMIN E NIVELEVE TË ARRITJES	4
3 PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I NIVELEVE TË ARRITJES.....	5
4 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË FUSHËN “GJUHËT DHE KOMUNIKIMI”	7
4.1 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI”	7
4.2 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “GJUHËT E HUAJA”.....	18
5 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË FUSHËN “MATEMATIKË”	28
6 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË FUSHËN “SHKENCAT E NATYRËS”	38
6.1 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “FIZIKË”	38
6.2 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “BIOLOGJI”	49
6.3 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “KIMI”	57
7 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË FUSHËN “SHOQËRIA DHE MJEDISI”	62
7.1 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “QYTETARI”	62
7.2 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “HISTORI”	101
7.3 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “GJEOGRAFI”	111
8 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË FUSHËN “TIK DHE TEKNOLOGJI”	118
8.1 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “TIK”	118
9 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË FUSHËN “ARTE”	131
9.1 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “ARTI PAMOR”	131
9.2 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “MUZIKË”.....	139



1 HYRJE

Vlerësimi në arsim është procesi gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së rezultatit të të nxënit, mbi bazën e një kriteri të caktuar. Qëllimi kryesor i vlerësimit është marrja e vendimeve, që synojnë përmirësimin e rezultateve të të nxënit dhe vetë procesin e tij. Marrja e vendimeve kërkon grumbullimin e vazhdueshëm të informacionit për të matur dhe për të vlerësuar të gjitha aspektet e procesit. Vlerësimi është pjesë integrale e të nxënit, mësimdhënies dhe programit mësimor dhe kjo sjell që qasja e sigurimit të cilësisë të zbatohet në mënyrë të barabartë gjatë vlerësimit. Në mënyrë që të sigurohet vlefshmëria dhe besueshmëria në vlerësim, duhet të rritet niveli i qëndrueshmërisë i të gjithë mësuesve dhe shkollave, gjë që realizohet nëpërmjet hartimit, mirëkuptimit dhe zbatimit të niveleve të arritjes për rezultatet e të nxënit të kompetencave.

Nivelet e arritjes shprehin kritere të njësuar për vlerësimin e njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve të nxënësve sipas fushave përkatëse. Këto nivele hartohen për të mundësuar që mësuesit të përcaktojnë arritjen e kompetencës nga nxënësi në fund të çdo viti sipas shkallëve përkatëse. Vlerësimi rigoroz bazuar në nivele të përcaktuara, krijon besim në gjykimet e mësuesve, jep siguri te prindërit dhe të tjerët që të gjithë nxënësit i kanë arritjet e tyre në përputhje me pritshmëritë.

2 KËRKESA PËR ZBATIMIN E NIVELEVE TË ARRITJES

Nivelet e arritjes bazohen në rezultatet e të nxënit të kompetencave të përcaktuara sipas shkallëve për fushat përkatëse në dokumentin e kurrikulës bërthamë. Ato përdoren nga mësuesit, hartuesit e teksteve shkollore e materialeve të tjera ndihmëse, specialistët e vlerësimit dhe inspektorët e arsimit.

Në veçanti, nivelet e arritjes ndihmojnë mësuesin për të planifikuar mësimdhënien individuale, punën e diferencuar sipas niveleve të nxënësit, për të ndikuar pozitivisht në progresin e tij dhe për të raportuar të nxënit e nxënësit. Për të përcaktuar nivelin e arritjes së nxënësit duhen bërë një sërë vëzhgimesh dhe duhen përdorur një sërë instrumentesh vlerësimi të cilat do të shërbejnë më pas për progresin e tij.

Hartimi i instrumenteve të vlerësimit të arritjeve të të nxënit duhet kryer duke u mbështetur në nivelet e arritjeve që janë përshkruar në këtë dokument.

3 PËRSHKRIM I PËRGJITHSHËM I NIVELEVE TË ARRITJES

Në parim janë përcaktuar **katër nivele arritjeje** (1,2,3,4) të njohurive, aftësive dhe qëndrimeve që demonstroi nxënësi:

- niveli I (**pamjaftueshëm**);
- niveli II (**mjaftueshëm**);
- niveli III (**mirë**);
- niveli IV (**shumë mirë**);

Këto nivele korrespondojnë përkatësisht me notat: **4; 5-6; 7-8; 9-10**; të sistemit të vlerësimit me notë.

Përveç përshkrimit të profilin të përgjithshëm (diagrama 1), secili nivel është specifikuar edhe për secilën kompetencë sipas fushave¹ në përshtatje me rezultatet përkatëse të të nxënësit, në përfundim të shkallës III dhe IV.

Tabela 1: Nivelet e arritjes së kompetencave dhe përshkrimi i tyre

NIVELI I (Notat 4)	NIVELI II (Notat 5-6)	NIVELI III (Notat 7-8)	NIVELI IV (Nota 9-10)
Nxënësit në këtë nivel demonstrojnë një shkallë të pamjaftueshme të zotërimit dhe zbatimit të	Nxënësit në këtë nivel zotërojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime dhe i zbatojnë ato në situata të përcaktuara/të njohura; ata kryejnë detyra	Nxënësit në këtë nivel zotërojnë njohuri, aftësi dhe qëndrime dhe i zbatojnë ato në situata analoge ose të ngjashme; ata shprehin qëndrimin e tyre personal, duke vepruar më shumë në nivelin e	Nxënësit në këtë nivel zotërojnë njohuri, aftësi, qëndrime dhe i zbatojnë ato në mënyrë të pavarur dhe krijuese, në situata të reja dhe të panjohura për ta; ata janë të aftë të zgjidhin situata problemore të

¹ Në varësi të specifikave të fushës dhe lëndëve përkatëse, nivelet e arritjes mund të hartohen për fushë ose për lëndë



njohurive, shkathtësive dhe qëndrimeve.	lëndore sipas modeleve të ofruara.	pohimeve dhe konkluzioneve të formuluar se sa në nivel analize.	ndryshme, të mbrojnë pikëpamjet dhe qëndrimet e tyre bazuar në argumente.
---	------------------------------------	---	---



4 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË FUSHËN “GJUHËT DHE KOMUNIKIMI”

4.1 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI”

SHKALLA III		
KOMPETENCA I: Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi merr njohuri, zhvillon qëndrime dhe vlera, si dhe zbaton aftësi dhe shkathtësi duke dëgjuar tekste të ndryshme. Më konkretisht, nxënësi kupton se sjellja dhe qëndrimet e duhura gjatë të dëgjuarit ndikojnë pozitivisht te të tjerët. Ai dallon disa cilësi të zërit të folësit si: intonacioni, ritmi, theksi, volumi i zërit. Gjithashtu, nxënësi tregon brendinë, veçon idenë kryesore, dallon fjalët ose frazat kyçe, bën konkluzione, krahason ose klasifikon, si dhe bën vlerësime të thjeshta për tekstet që dëgjon.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ demonstroi gjatë të dëgjuarit qëndrime dhe sjellje të përshtatshme, si: <i>vëmendje dhe kontakt me sy</i>; ✓ tregon shkurtimisht brendinë e tekstit që dëgjon; ✓ analizon në mënyrë sipërfaqësore dhe bën një përmbledhje të shkurtër të tekstit që dëgjon; ✓ krahason, në mënyrë sipërfaqësore, informacionin e dëgjuar me njohuritë e tij të mëparshme.	Nxënësi: ✓ demonstroi gjatë të dëgjuarit qëndrime dhe sjellje të përshtatshme, si: <i>vëmendje, interes, kontakt me sy, mbajtje të trupit në pozicion korrekt</i>; ✓ analizon dhe bën një përmbledhje të tekstit që dëgjon, duke e ilustruar me pak fragmente dhe detaje; ✓ krahason informacionin e dëgjuar me njohuritë e tij të mëparshme, si dhe bën disa përgjithësime të thjeshta; ✓ bën dallimin mes shkakut dhe pasojës.	Nxënësi: ✓ analizon dhe bën një përmbledhje të tekstit që dëgjon, duke e ilustruar me fragmente dhe detaje; ✓ krahason informacionin e dëgjuar me njohuritë e tij të mëparshme; ✓ bën disa përgjithësime të thjeshta; ✓ bën dallimin mes shkakut dhe pasojës, si dhe gjen problemin dhe zgjidhjen në një tekst.
KOMPETENCA II: Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar		



Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi: përdor drejt gjuhën standarde gjatë folurit; kupton dhe zbaton në komunikim karakteristikat e gjuhës së folur; shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë, me qëllim që të jetë i kuptueshëm dhe interesantë për të tjerët; shoqëron të folurin edhe me elemente të komunikimit joverbal; diskuton dhe bashkëvepron me të tjerët gjatë punës në grup.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ flet duke shqiptuar mirë dhe me theksin e duhur tingujt, fjalët dhe fjalitë; ✓ komunikon thjesht, por i rendit logjikisht idetë, ndjesitë dhe informacionin; ✓ në përgjithësi, është aktiv gjatë diskutimeve në grup; ✓ prezanton me një fjalor korrekt e disi shprehës mendimet dhe këndvështrimet e tij; ✓ përdor gjatë komunikimit edhe elemente joverbale.	Nxënësi: ✓ flet duke shqiptuar saktë dhe me theksin e duhur tingujt, fjalët dhe fjalitë, përpiket të flasë me intonacionin e duhur në çdo situatë; ✓ përzgjedh disa forma për të shprehur mendimet, informacionet dhe ndjenjat e tij; ✓ i rendit idetë, ndjesitë dhe informacionin në mënyrë logjike dhe në disa raste e shoqëron të folurit edhe me elemente pamore; ✓ merr pjesë në diskutime në grup për çështje të ndryshme, por nuk është ai që përzgjedh temën dhe merr iniciativë; ✓ shfaq mendimet dhe këndvështrimet e tij me fjalë të thjeshta; ✓ përdor gjuhën standarde dhe përpiket të zgjedhë fjalët dhe frazat e duhura për të komunikuar qartë dhe për të tërhequr, në përgjithësi vëmendjen e dëgjuesit; ✓ përdor gjatë komunikimit edhe elemente joverbale.	Nxënësi: ✓ përdor forma të larmishme dhe të përshtatshme komunikimi, rendit logjikisht idetë, ndjesitë dhe informacionin dhe shoqëron të folurit edhe me elemente pamore, si: imazhe, foto, tabela, harta, grafikë; ✓ bashkëbisedon lirshëm për çështje të ndryshme, si dhe zgjedh tema të caktuara që janë interesante për moshën; ✓ shfaq dhe argumenton mendimet dhe këndvështrimet e tij, si dhe vlerëson kontributet e të tjerëve në diskutim; ✓ përdor gjuhën standarde dhe i shpreh mendimet e tij me një fjalor të pasur e shprehës; ✓ shoqëron gjithmonë të folurin me elemente joverbale, si: shprehjet e fytyrës, gjestet dhe lëvizjet e trupit.



KOMPETENCA III: Të lexuarit e teksteve të ndryshme		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi lexon tekste letrare dhe joletrare që u përkasin periudhave të ndryshme, tekste klasike dhe bashkëkohore, shqipe dhe botërore dhe demonstroi kuptimin, interpretimin, analizën, vlerësimin dhe gjykimin e këtyre teksteve (të përshtatshme për zhvillimin moshor të nxënësit).		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ drejtshqipton tingujt, lexon rrjedhshëm dhe përdor drejt theksin në fjalët e njohura; ✓ interpreton kuptimin e pjesës më të madhe të fjalëve dhe shprehjeve në tekstet që lexon; ✓ dallon temat dhe idetë kryesore në një tekst, por nuk i mbështet me shumë detaje dhe ilustrime nga teksti; ✓ përmbledh informacionin e një teksti dhe e lidh këtë informacion me njohuritë dhe përvojat e tij; ✓ dallon shkakun dhe pasojën (në përgjithësi) në një tekst.	Nxënësi: ✓ dallon dhe interpreton kuptimet e fjalëve dhe shprehjeve në tekstet që lexon; ✓ demonstroi të kuptuarit e një teksti, dallon idetë dhe informacionin kryesor, si dhe i ilustron ato me shembuj dhe detaje nga teksti; ✓ lidh informacionin e tekstit me njohuritë dhe përvojat e tij; ✓ shfaq këndvështrimet e tij në lidhje me tematikën dhe idetë e tekstit; ✓ krahason tekste të ndryshme, veçon qëllimin e autorit (me ndihmën e mësuesit), si dhe dallon shkakun dhe pasojën, problemin dhe zgjidhjen; ✓ përdor karakteristikat e teksteve për t'i kuptuar ato dhe veçon tiparet kryesore të teksteve.	Nxënësi: ✓ drejtshqipton tingujt, lexon gjithmonë rrjedhshëm; ✓ dallon dhe interpreton kuptimet e të gjitha fjalëve dhe shprehjeve në tekstet që lexon; ✓ demonstroi të kuptuarit e një teksti, dallon me lehtësi idetë dhe informacionin kryesor, si dhe i ilustron ato me shembuj dhe detaje nga teksti; ✓ lidh informacionin e tekstit me njohuritë dhe përvojat e tij; ✓ vlerëson dhe jep këndvështrimet e tij në lidhje me tematikën dhe idetë e tekstit; ✓ krahason tekste të ndryshme, veçon qëllimin e autorit, si dhe dallon lehtësisht shkakun dhe pasojën, problemin dhe zgjidhjen; ✓ përdor karakteristikat e teksteve për t'i kuptuar ato dhe analizon elementet letrare dhe stilistike të teksteve.



KOMPETENCA IV: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi shkruan për qëllime dhe lexues të ndryshëm. Ai ndjek gjatë të shkruarit hapa si: planifikimi, organizimi i ideve, rishikimi dhe redaktimi. Nxënësi, gjithashtu, respekton strukturën, tiparet e tekstit, si dhe rregullat gjuhësore.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ mbledh me ndihmën e mësuesit, fakte, informacione dhe komente nga burime të mjaftueshme, si dhe bën një punë paraprake për detyrën me shkrim; ✓ rendit informacionin gjatë përgatitjes për punën ose detyrën me shkrim, në mënyrë që të sigurojë koherencë gjatë të shkruarit; ✓ shkruan qartë dhe respekton, në përgjithësi, strukturën e punës me shkrim; ✓ bën gabime të rralla drejtshkrimore që nuk çenojnë të kuptuarit e tekstit, si dhe përdor kryesisht në mënyrë korrekte gjuhën standarde.	Nxënësi: ✓ mbledh informacione nga një ose më shumë burime për punët dhe për detyrat me shkrim (duke u orientuar nga mësuesi); ✓ rendit ose klasifikon informacionin gjatë përgatitjes për punën ose detyrën me shkrim; ✓ shkruan duke u përqendruar te tema dhe te lexuesit; ✓ shkruan saktë, me qartësi logjike lloje të ndryshme punësh dhe detyrash me shkrim; ✓ mbështet idetë e tij me detaje e shembuj, si dhe i shoqëron me figura, grafikë, tabela, ilustrime, kur është e nevojshme; ✓ përdor një gjuhë shprehëse dhe fjalor të pasur, respekton në përgjithësi, rregullat drejtshkrimore dhe përdor mirë gjuhën standarde gjatë të shkruarit; ✓ realizon punë me shkrim edhe duke përdorur TIK-un.	Nxënësi: ✓ mbledh, kryesisht në mënyrë të pavarur, informacione disa burime për punët dhe për detyrat me shkrim; ✓ rendit ose klasifikon informacionin gjatë përgatitjes për punën ose detyrën me shkrim; ✓ shkruan duke u përqendruar te tema dhe te lexuesit; ✓ shkruan saktë, me qartësi logjike dhe strukturore (brenda dhe mes paragrafëve) lloje të ndryshme punësh dhe detyrash me shkrim; ✓ mbështet idetë e tij me detaje e shembuj të shumtë, si dhe i shoqëron me figura, grafikë, tabela, ilustrime, kur është e nevojshme; ✓ përdor një gjuhë shprehëse dhe fjalor të pasur, respekton rregullat drejtshkrimore dhe përdor në përgjithësi, gjuhën standarde gjatë të shkruarit; ✓ prezanton punë me shkrim edhe duke përdorur TIK-un.



KOMPETENCA V: Përdorimi i drejtë i gjuhës		
Përshkrimi i kompetencës: Që nxënësi të flasë dhe të shkruajë në mënyrën e duhur, atëherë ai duhet të zotërojë njohuri e të demonstrojë shkathtësi, vlera dhe qëndrime në lidhje me sistemin gjuhësor të gjuhës shqipe. Kështu, nxënësi dallon pjesët e ndryshme të ligjëratës, kategoritë e tyre gramatikore dhe i përdor në trajtën e duhur gjatë komunikimit; dallon llojet e ndryshme të fjalive dhe funksionet e fjalëve në fjali dhe i zbaton këto njohuri në komunikimin e përditshëm; përdor gjuhën standarde, njeh dialektet e pjesë të tjera të leksikut dhe respekton diversitetin gjuhësor; demonstroi njohuri për mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe, dallon kuptimet e fjalëve dhe i përdor për të pasuruar fjalorin e tij.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ dallon fjalitë e thjeshta dhe të përbëra, <i>përcakton llojin e tyre</i>; ✓ dallon funksionet gramatikore të fjalëve në fjali (kryefjalë, kallëzues, kundrinor); ✓ përcakton klasat e fjalëve dhe kategoritë e tyre gramatikore; ✓ njeh mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe, <i>analizon fjalë të thjeshta sipas ndërtimit</i>; ✓ njeh fushën leksikore, familjen e fjalëve, si dhe kuptimin e parë dhe kuptimet e tjera të tyre; ✓ respekton, në përgjithësi, rregullat drejtshkrimore.	Nxënësi: ✓ analizon fjalitë e thjeshta dhe të përbëra, si dhe përcakton llojin e tyre; ✓ identifikon funksionet gramatikore të fjalëve në fjali; ✓ përcakton klasat e fjalëve dhe kategoritë e tyre gramatikore, si dhe i përdor në përgjithësi, në formën e duhur gjatë të folurit dhe të shkruarit; ✓ analizon mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe, analizon fjalët sipas ndërtimit; ✓ analizon fushën leksikore, familjen e fjalëve, si dhe kuptimin e parë dhe kuptimet e tjera të tyre dhe i përdor ato gjatë të shkruarit dhe të folurit; ✓ përdor mirë gjuhën standarde shqipe dhe respekton, në përgjithësi, rregullat drejtshkrimore.	Nxënësi: ✓ dallon, analizon dhe përdor me lehtësi fjalitë e thjeshta dhe të përbëra, përcakton llojin e tyre, si dhe argumenton përgjigjen e tij; ✓ dallon funksionet gramatikore të fjalëve në fjali, si dhe argumenton përgjigjen e tij; ✓ përcakton klasat e fjalëve dhe kategoritë e tyre gramatikore, si dhe i përdor në formën e duhur gjatë të folurit dhe të shkruarit; ✓ dallon mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe, analizon fjalët sipas ndërtimit, si dhe argumenton përgjigjen e tij; ✓ dallon fushën leksikore, familjen e fjalëve, si dhe kuptimin e parë dhe kuptimet e tjera të tyre.



		kuptimet e tjera të tyre dhe i përdor ato gjatë të shkruarit dhe të folurit; ✓ përdor mirë gjuhën standarde shqipe dhe respekton rregullat drejtshkrimore.
SHKALLA IV		
KOMPETENCA I: Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi merr njohuri, zhvillon qëndrime dhe vlera, si dhe zbaton aftësi dhe shkathtësi duke dëgjuar tekste të ndryshme. Më konkretisht, nxënësi kupton se sjellja dhe qëndrimet e duhura gjatë të dëgjuarit ndikojnë pozitivisht te të tjerët. Ai dallon disa cilësi të zërit të folësit si: intonacioni, ritmi, theksi, volumi i zërit. Gjithashtu, nxënësi tregon brendinë, veçon idenë kryesore, dallon fjalët ose frazat kyçe, bën konkluzione, krahason ose klasifikon, si dhe bën vlerësime të thjeshta për tekstet që dëgjon.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ dëgjon me vëmendje dhe me interes të tjerët; ✓ përdor gjuhën e trupit, kontaktin me sy dhe mimikën e duhur gjatë të dëgjuarit; ✓ tregon me fjalët e tij tekstin që dëgjon, jep interpretime të thjeshta, si dhe veçon disa nga idetë kryesore; ✓ krahason informacionet që dëgjon me njohuritë e mëparshme; ✓ klasifikon vetëm detajet kryesore; ✓ dallon me vështirësi problemin dhe zgjidhjen në një tekst.	Nxënësi: ✓ demonstroi të kuptuarit e tekstit që dëgjon, jep interpretimet e tij dhe përmbledh idetë kryesore me fjalët e tij; ✓ krahason informacionet që dëgjon me njohuritë e mëparshme; ✓ klasifikon detajet, bën dallimin mes shkakut dhe pasojës, dallon problemin dhe zgjidhjen në një tekst; dallon me vështirësi, faktin nga opinioni; ✓ përcakton se kujt i drejtohet folësi.	Nxënësi: ✓ analizon tekstin duke u përqendruar në mënyrat se si komunikohet informacioni ose emocionet dhe tregon se si ndikojnë këto te dëgjuesi; ✓ krahason në mënyrë të pavarur, informacionet që dëgjon me njohuritë e mëparshme; ✓ analizon dhe përmbledh idetë kryesore; ✓ argumenton interpretimet e tij duke dhënë detaje dhe ilustrime nga teksti, klasifikon saktë detajet, si dhe bën përgjithësime;



		✓ <i>dallon</i> në një tekst: shkakun dhe pasojën, problemin dhe zgjidhjen, faktin dhe opinionin; ✓ <i>përcakton në mënyrë të pavarur</i>, se kujt i drejtohet folësi.
KOMPETENCA II: Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi: përdor drejt gjuhën standarde gjatë folurit; kupton dhe zbaton në komunikim karakteristikat e gjuhës së folur; shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë, me qëllim që të jetë i kuptueshëm dhe interesantë për të tjerët; shoqëron të folurin edhe me elemente të komunikimit joverbal; diskuton dhe bashkëvepron me të tjerët gjatë punës në grup.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ <i>flet</i> qartë, rrjedhshëm, me intonacionin e duhur, duke respektuar theksin e fjalëve dhe fjalive; ✓ <i>mbledh, për zgjedh</i> fakte e ide në shumë pak burime të shtypura dhe elektronike për prezantimet e tij me gojë. ✓ <i>në përgjithësi, përpiket të organizojë</i> mendimet, idetë dhe ndjesitë e tij gjatë të folurit; ✓ <i>përdor me ndihmën e mësuesit</i>, TIK-un gjatë prezantimit të një projekti ose detyre në grup;	Nxënësi: ✓ <i>mbledh, për zgjedh</i> fakte e ide në pak burime të shtypura dhe elektronike për prezantimet e tij me gojë; ✓ <i>organizon mirë</i> mendimet, idetë dhe ndjesitë e tij, në disa mënyra e forma të ndryshme për të siguruar vëmendjen e dëgjuesit; ✓ <i>përdor me ndihmën e mësuesit</i>, TIK-un gjatë prezantimit të një projekti ose detyre në grup; ✓ <i>përfshihet</i> në bashkëbisedime për të dhënë mendimet e tij, duke u nxitur nga të tjerët;	Nxënësi: ✓ <i>mbledh, për zgjedh e vlerëson</i> fakte dhe ide nga shumë burime të shtypura dhe elektronike për prezantimet e tij me gojë; ✓ <i>organizon qartë</i> mendimet, idetë dhe ndjesitë e tij, në mënyra e forma të ndryshme për të mbështetur qëllimin dhe për të siguruar vëmendjen e dëgjuesit, si: rend kronologjik, renditje sipas rëndësisë etj.; ✓ <i>përdor TIK-un</i> gjatë prezantimit të një projekti ose detyre në grup; ✓ <i>bashkëbisedon lirshëm</i> duke dhënë mendimet dhe këndvështrimet e tij, si dhe duke respektuar mendimin ndryshe;



✓ <i>nuk është aktiv në bashkëbisedim ose projekte të ndryshme në klasë (duhet nxitur nga mësuesi);</i> ✓ <i>përdor mirë gjuhën standarde gjatë të folurit dhe shmang në përgjithësi, fjalët e huaja dhe ato dialektore;</i> ✓ <i>përdor edhe disa elemente joverbale si: shprehjen e duhur të fytyrës, gjuhën e trupit, në mënyrë që të mos japë mesazhe të gabuara.</i>	✓ <i>zgjedh dhe përdor fjalët dhe frazat e duhura, në varësi të dëgjuesit, të situatës dhe të qëllimit;</i> ✓ <i>përdor mirë gjuhën standarde gjatë të folurit dhe shmang në përgjithësi, fjalët e huaja dhe ato dialektore;</i> ✓ <i>flet duke u kujdesur për shprehjen e duhur të fytyrës, gjuhën e trupit dhe gjestet e përshtatshme, në mënyrë që të mos japë mesazhe të gabuara.</i>	✓ <i>përcakton dhe ndjek rregullat gjatë diskutimit në grup, ndan rolet gjatë diskutimeve, ndan detyrat në punë e projekte të ndryshme në klasë;</i> ✓ <i>zgjedh dhe përdor mirë format e gjuhës së folur, fjalorin teknik, regjistrin formal dhe joformal etj., në varësi të dëgjuesit, të situatës dhe të qëllimit;</i> ✓ <i>shpreh mendimet e tij me një fjalor të pasur duke përdorur: shprehje frazeologjike, fjalë të urta, fjalë me kuptim të figurshëm etj.;</i> ✓ <i>përdor gjuhën standarde gjatë të folurit dhe shmang fjalët e huaja dhe dialektore;</i> ✓ <i>flet duke u kujdesur për shprehjen e duhur të fytyrës, gjuhën e trupit dhe gjestet e përshtatshme, në mënyrë që të mos japë mesazhe të gabuara.</i>
KOMPETENCA III: Të lexuarit e teksteve të ndryshme		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi lexon tekste letrare dhe joletrare që u përkasin periudhave të ndryshme, tekste klasike dhe bashkëkohore, shqipe dhe botërore dhe demonstroi kuptimin, interpretimin, analizën, vlerësimin dhe gjykimin e këtyre teksteve (të përshtatshme për zhvillimin moshor të nxënësit).		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ <i>lexon rrjedhshëm dhe me shprehësi tekste të llojeve të ndryshme;</i>	Nxënësi: ✓ <i>dallon kuptimin e fjalëve dhe shprehjeve, si dhe gjen sinonimet dhe antonimet e tyre;</i>	Nxënësi: ✓ <i>dallon lehtësisht kuptimin e fjalëve dhe shprehjeve, si dhe gjen sinonimet dhe antonimet e tyre;</i>



✓ <i>përdor të dhënat kontekstuale për të dalluar kuptimet e fjalëve dhe shprehjeve të ndryshme;</i> ✓ <i>kupton dhe analizon tekste të përshtatshme për moshën e tij;</i> ✓ <i>dallon idetë dhe temat kryesore;</i> ✓ <i>dallon shkakun dhe pasojën, problemin dhe zgjidhjen;</i> ✓ <i>bën krahasime të thjeshta brenda dhe mes teksteve;</i> ✓ <i>veçon karakteristikat kryesore të teksteve.</i>	✓ <i>dallon nuancat kuptimore të fjalëve në tekste të ndryshme;</i> ✓ <i>bën dallimet kryesore mes teksteve letrare dhe teksteve joletrare;</i> ✓ <i>kupton, analizon dhe vlerëson në përgjithësi, tekste të përshtatshme për moshën e tij;</i> ✓ <i>veçon idetë dhe çështjet kryesore, duke i ilustruar me detaje dhe shembuj nga teksti, si dhe përmbledh me fjalët e tij çështjet kryesore;</i> ✓ <i>dallon shkakun nga pasoja, problemin nga zgjidhja, faktin nga opinionin;</i> ✓ <i>bën krahasime brenda dhe mes teksteve;</i> ✓ <i>dallon dhe analizon qëllimin e autorit dhe mjetet që përdor ai në tekst;</i> ✓ <i>përdor informacionin dhe konceptet që ka marrë nga një tekst në situata dhe tekste të reja, si dhe bën disa përgjithësime;</i> ✓ <i>dallon qëllimin e autorit në një tekst duke e ilustruar mendimin e tij me detaje nga teksti;</i> ✓ <i>analizon mjetet stilistike të tekstit.</i>	✓ <i>dallon nuancat kuptimore të fjalëve në tekste të ndryshme;</i> ✓ <i>dallon lehtësisht tekstet letrare nga tekstet joletrare;</i> ✓ <i>kupton, analizon dhe vlerëson tekste të përshtatshme për moshën e tij;</i> ✓ <i>veçon me lehtësi idetë dhe çështjet kryesore, duke i ilustruar me detaje dhe shembuj të shumtë nga teksti, si dhe përmbledh me fjalët e tij çështjet kryesore;</i> ✓ <i>dallon lehtësisht shkakun nga pasoja, problemin nga zgjidhja, faktin nga opinionin;</i> ✓ <i>bën krahasime brenda dhe mes teksteve;</i> ✓ <i>dallon dhe analizon qëllimin e autorit dhe vlerëson mjetet që përdor ai në tekst;</i> ✓ <i>përdor lehtësisht informacionin dhe konceptet që ka marrë nga një tekst në situata dhe tekste të reja, si dhe bën përgjithësime duke përdorur detaje të shumta nga burime të ndryshme;</i> ✓ <i>dallon dhe analizon qëllimin e autorit në një tekst duke e ilustruar mendimin e tij me detaje nga teksti;</i>
--	---	--



		✓ <i>analizon mjetet stilistike të tekstit dhe sqaron funksionet e tyre.</i>
KOMPETENCA IV: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi shkruan për qëllime dhe lexues të ndryshëm. Ai ndjek gjatë të shkruarit hapa si: planifikimi, organizimi i ideve, rishikimi dhe redaktimi. Nxënësi, gjithashtu, respekton strukturën, tiparet e tekstit, si dhe rregullat gjuhësore.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ <i>mbledh (duke u orientuar nga mësuesi) informacion nga burime të ndryshme, të shtypura dhe elektronike;</i> ✓ <i>shkruan duke u përqendruar në përgjithësi te tema, te lexuesit dhe te qëllimi;</i> ✓ <i>rendit dhe organizon në paragrafë idetë kryesore, por nuk i ilustron me detaje dhe shembuj të shumtë;</i> ✓ <i>shkruan duke respektuar, në përgjithësi, strukturën e punës me shkrim;</i> ✓ <i>përzgjedh fjalët dhe frazat e duhura, si dhe zbaton gjatë të shkruarit, në përgjithësi, njohuritë gramatikore dhe drejtshkrimore;</i>	Nxënësi: ✓ <i>mbledh kryesisht të pavarur, informacion nga burime të ndryshme, të shtypura dhe elektronike;</i> ✓ <i>në përgjithësi, shkruan duke u përqendruar te tema, lexuesit dhe qëllimi i tij;</i> ✓ <i>rendit dhe organizon në paragrafë idetë kryesore duke i ilustruar dhe duke i mbështetur me detaje dhe shembuj;</i> ✓ <i>shkruan duke siguruar lidhje logjike mes fjalive e paragrafëve dhe respekton strukturën, formën dhe karakteristikat e punës me shkrim;</i> ✓ <i>përzgjedh fjalët dhe frazat e duhura gjatë të shkruarit, si dhe zbaton njohuritë gramatikore e drejtshkrimore dhe përdor gjuhën standarde;</i> ✓ <i>prezanton punët me shkrim duke përfshirë elemente të TIK-ut, kryesisht</i>	Nxënësi: ✓ <i>mbledh në mënyrë të pavarur, informacion nga burime të ndryshme, të shtypura dhe elektronike, si dhe klasifikon burimet e informacionit në të rëndësishme dhe dytësore;</i> ✓ <i>shkruan duke u përqendruar te tema, lexuesit dhe qëllimi i tij;</i> ✓ <i>rendit dhe organizon në paragrafë idetë kryesore duke i ilustruar dhe duke i mbështetur me detaje, shembuj, fakte dhe opinione të ndryshme;</i> ✓ <i>shkruan duke siguruar lidhje logjike mes fjalive e paragrafëve dhe respekton strukturën, formën dhe karakteristikat e punës me shkrim;</i> ✓ <i>përzgjedh fjalë dhe fraza që i japin punës gjallëri e shprehësi;</i> ✓ <i>zbaton gjatë të shkruarit njohuritë gramatikore dhe drejtshkrimore dhe përdor gjuhën standarde;</i>



✓ shkruan duke zbatuar në përgjithësi, formën, strukturën dhe karakteristikat kryesore të teksteve.	me anë të programeve: Word, PowerPoint, Excel.	✓ prezanton punët me shkrim duke përfshirë elemente të TIK-ut, kryesisht me anë të programeve: Word, PowerPoint, Excel.
KOMPETENCA V: Përdorimi i drejtë i gjuhës		
Përshkrimi i kompetencës: Që nxënësi të flasë dhe të shkruajë në mënyrën e duhur, atëherë ai duhet të zotërojë njohuri e të demonstrojë shkathhtësi, vlera dhe qëndrime në lidhje me sistemin gjuhësor të gjuhës shqipe. Kështu, nxënësi dallon pjesët e ndryshme të ligjëratës, kategoritë e tyre gramatikore dhe i përdor në trajtën e duhur gjatë komunikimit; dallon llojet e ndryshme të fjalive dhe funksionet e fjalëve në fjali dhe i zbaton këto njohuri në komunikimin e përditshëm; përdor gjuhën standarde, njëh dialektet e pjesë të tjera të leksikut dhe respekton diversitetin gjuhësor; demonstroi njohuri për mënyrat e formimit të fjalëve në gjuhën shqipe, dallon kuptimet e fjalëve dhe i përdor për të pasuruar fjalorin e tij.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ dallon llojet e fjalive sipas kumtimit, intonacionit, ndërtimit, gjymtyrëve kryesore; ✓ dallon llojet e gjymtyrëve kryesore dhe gjymtyrëve të dyta; ✓ dallon klasat e fjalëve të ndryshueshme dhe të pandryshueshme, si dhe kategoritë e tyre gramatikore; ✓ dallon stilet dhe regjistrat e gjuhës; ✓ dallon pjesët e leksikut të shqipes, përdor mirë gjuhën standarde dhe zbaton mirë rregullat drejtshkrimore dhe shenjat e	Nxënësi: ✓ analizon llojet e fjalive sipas kumtimit, intonacionit, ndërtimit, gjymtyrëve kryesore, si dhe përpiket të argumentojë përgjigjen e tij; ✓ analizon llojet e gjymtyrëve kryesore dhe gjymtyrëve të dyta, si dhe përpiket të argumentojë përgjigjen e tij; ✓ dallon, përdor dhe analizon në përgjithësi, klasat e fjalëve të ndryshueshme dhe të pandryshueshme, si dhe përpiket të argumentojë përgjigjen e tij; ✓ analizon stilet dhe regjistrat e gjuhës, si dhe përpiket të argumentojë përgjigjen e	Nxënësi: ✓ përdor dhe analizon llojet e fjalive sipas kumtimit, intonacionit, ndërtimit, gjymtyrëve kryesore, si dhe argumenton përgjigjen e tij; ✓ përdor dhe analizon llojet e gjymtyrëve kryesore dhe gjymtyrëve të dyta, si dhe argumenton përgjigjen e tij; ✓ përdor dhe analizon klasat e fjalëve të ndryshueshme dhe të pandryshueshme, si dhe argumenton përgjigjen e tij; ✓ analizon dhe përdor stilet dhe regjistrat e gjuhës, si dhe argumenton përgjigjen e tij; ✓ analizon dhe vlerëson pasurinë



pikësimit.	tij; ✓ <i>analizon</i> pasurinë leksikore të shqipes, <i>përdor mirë</i> gjuhën standarde dhe <i>zbaton në përgjithësi</i> , rregullat drejtshkrimore dhe shenjat e pikësimit.	leksikore të shqipes, <i>përdor</i> gjuhën standarde dhe <i>zbaton drejt</i> rregullat drejtshkrimore dhe shenjat e pikësimit.
------------	--	--

4.2 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “GJUHËT E HUAJA”

SHKALLA III
Nivelet e arritjes janë përcaktuar duke u mbështetur tek Kuadri i Përbashkët Evropian i Referencave (KPER) për gjuhët. Nxënësi në përfundim të shkallës III e cila përkon me përfundimin e klasës së 7^{te} duhet të ketë arritur nivelin A2.1.2 sipas KPER. Më poshtë jepet përshkrimi i nivelit A2 sipas shkallës globale KPER. <i>“Nxënësi mund të kuptojë pikat kryesore të një informacioni të qartë dhe standard për çështje me të cilat përballet rregullisht në shkollë, familje, kohë të lirë etj. Ai mund të zgjidhë situata që mund t’i shfaqen duke udhëtuar në vendet ku flitet gjuha që po mëson. Nxënësi gjithashtu mund të prodhojë një tekst të thjeshtë me tema që janë të njohura ose me interes për të. Ai mund të përshkruajë ngjarje, ëndrra, shpresa, ambicie dhe të japë shkurtimisht arsye dhe shpjegime për planet dhe opinionet e tij.”</i>
Kompetenca I: Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi kupton shprehje dhe një fjalor shumë të përdorshëm në lidhje me veten e tij, familjen e tij dhe mjedisin e afërt. Nxënësi merr njohuri, zhvillon qëndrime dhe vlera të ndryshme, dhe kupton se sjellja dhe qëndrimet e duhura gjatë të dëgjuarit ndikojnë pozitivisht te të tjerët. Ai dallon disa cilësi si: intonacioni, theksi, tingulli i gjatë e i shkurtër, etj. në gjuhën e huaj.



NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi : ✓ dallon fjalët me frekuencë më të lartë që lidhen me fushën e tij të interesit kur dëgjon një bisedë; ✓ identifikon temën e një bisede kur ajo është e qartë dhe zhvillohet shumë ngadalë dhe me artikulum të kujdesshëm; ✓ kupton pikat kryesore të një mesazhi/reklame të qartë dhe të thjeshtë.	Nxënësi : ✓ kupton fjalët, frazat që lidhen me fushën e tij të interesit kur dëgjon një bisedë; ✓ identifikon temën e një bisede që zhvillohet ngadalë; ✓ kupton pikat kryesore dhe disa nga detajet e një mesazhi/reklame të thjeshtë.	Nxënësi : ✓ zgjedh fjalët, frazat, shprehjet më të rëndësishme kur dëgjon një bisedë; ✓ lidh temën e një bisede që zhvillohet ngadalë me njohuritë e mëparshme; ✓ kupton pikat kryesore dhe të gjitha detajet e një mesazhi/reklame të thjeshtë.
Kompetenca II: “Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar”		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi komunikon gjatë kryerjes së detyrave të thjeshta dhe të zakonshme mbi tema dhe veprimtari të njohura si koha e lirë dhe jeta e përditshme. Nxënësi përdor drejt gjuhën standarde gjatë të folurit; kupton dhe zbaton në komunikim karakteristikat e gjuhës së folur; shqipton saktë dhe me intonacionin e theksin e duhur fjalët dhe fjalitë, me qëllim që të jetë i kuptueshëm për audiencën; shoqëron të folurin edhe me elemente të komunikimit jo verbal; bashkëvepron me të tjerët gjatë punës në grup.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ shpreh me gjuhë të thjeshtë dhe fjalë të shkëputura dëshirat e tij dhe flet thjeshtë për kohën e tij të lirë;	Nxënësi: ✓ komunikon me fjali të plota por të thjeshta dëshirat dhe interesat e tij;	Nxënësi: ✓ ndërton një dialog të thjeshtë mbi fushat e tij të interesit;



✓ përdor shprehjet e mirësjelljes në modele të gatshme; ✓ sugjeron/jep ose kërkon këshillë duke përdorur modele të dhëna nga mësuesi; ✓ merr pjesë me fjalë të shkëputura në një dialog të shkurtër; ✓ jep dhe merr informacion shumë të thjeshtë personal mbi jetën e përditshme.	✓ zgjedh shprehjet e duhura për të dhënë ose marrë këshillë/sugjerim në një dialog të thjeshtë me temë nga jeta e përditshme; ✓ jep dhe merr informacion të thjeshtë me fjali të plota por të thjeshta mbi jetën e përditshme; ✓ kërkon në mënyrë të thjeshtë informacionin ose përsëritjen e tij.	✓ merr pjesë aktive duke e filluar ose përfunduar një bisedë të thjeshtë mbi fushat e jetës së përditshme; ✓ eksperimenton me fjalët dhe shprehjet e mësuara duke i përdorur ato në kontekste të ndryshme nga ato në të cilat i ka mësuar.
Kompetenca III: Të lexuarit e teksteve të ndryshme		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi kupton tekste të shkurtëra dhe të thjeshta që përmbajnë fjalor të një frekuence të lartë duke përfshirë edhe fjalë të një fjalori të përbashkët ndërkombëtar.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ gjen/nënvizon fjalët e reja në një tekst të thjeshtë; ✓ identifikon llojin e pjesës që lexon (letër/ kartolinë/ lajmërim/ tregim etj); ✓ kupton mesazhin e dhënë në një letër të thjeshtë personale; ✓ identifikon shenjat dhe lajmërimet e përditshme në vendet publike si p.sh; në restorant/ park/ stacion autobuzi, treni etj.	Nxënësi: ✓ kombinon fjalët e reja me kuptimin e tyre; ✓ perifrazon mesazhe të thjeshta të dhëna në një letër personale; ✓ klasifikon detajet e një pjese që lexon sipas kërkesës së dhënë. ✓ kupton disi me vështirësi udhëzimet e dhëna në pajisje që ndeshen në jetën e përditshme si telefoni, kompjuteri etj.;	Nxënësi: ✓ zgjedh informacionin më të rëndësishëm në një pjesë të thjeshtë leximi ku përshkruhen ngjarje. ✓ gjen informacionin specifik në lista dhe zgjedh informacionin e kërkuar. ✓ kupton pa vështirësi udhëzimet e dhëna në pajisje që ndeshen në jetën e përditshme si telefoni, kompjuteri etj.; ✓ aplikon informacionin e marrë në detyrat që i jepen.



	✓ identifikon informacionin specifik në materiale të shkruara thjeshtë si letra/broshura / tekste që përshkruajë ngjarje.	
Kompetenca IV: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi mban shënime dhe shkruan tekste të shkurtra mbi çështje të fushës së tij të interesit. Ai/ajo shkruan tekste shumë të shkurtra përshkrues.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ shkruan përshëndetje të thjeshta; ✓ plotëson vendet bosh në letra shumë të thjeshta duke përdorur modele të gatshme; ✓ liston informacion shumë të thjeshtë mbi të dhënat personale/biografike; ✓ shkruan fjali të thjeshta duke imituar modelin e dhënë.	Nxënësi: ✓ shkruan një letër/kartolinë të thjeshtë që shpreh falenderim duke përdorur fjali të gatshme; ✓ përdor rregullat e mësuara për të shkruar një biografi të thjeshtë; ✓ përshkruan me fjali të thjeshta dhe fjalor të kufizuar një ngjarje nga jeta e përditshme/familja etj.	Nxënësi: ✓ shkruan një letër të thjeshtë që shpreh falenderim duke mos kopjuar modelin e dhënë; ✓ modelon një biografi imagjinare të thjeshtë; ✓ krijon poema shumë të thjeshta dhe të shkurtra; ✓ përshkruan me fjali të thjeshta një ngjarje nga jeta e përditshme/familja etj.
Kompetenca V: Përdorimi i drejtë i gjuhës		
Përshkrimi i kompetencës: : Nxënësi komunikon gjatë kryerjes së detyrave të thjeshta, të zakonshme që kërkojnë një shkëmbim informacioni të drejtpërdrejtë. Nxënësi kupton, shqipton dhe përcjell mesazhin (me shkrim dhe me gojë) nëpërmjet strukturave të thjeshta gramatikore, që i përkasin një repertori të memorizuar dhe situatave të njohura për të.		



NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ gërmëzon fjalë të thjeshta; ✓ shkruan fjalët me frekuencë më të lartë pa gabime; ✓ përsërit sipas modelit zgjedhimin e foljeve në kohë të tashme dhe të shkuar të thjeshtë; ✓ dallon mbiemrat/ ndajfoljet/emrat/foljet.	Nxënësi: ✓ përdor fjali të shkurtra pa gabime gramatikore duke u bazuar mbi një model të dhënë; ✓ zgjedhon foljet në kohët kryesore; ✓ klasifikon mbiemrat sipas shkallëve; ✓ riprodhon rregullat gramatikore të mësuara.	Nxënësi: ✓ krijon fjali të thjeshta me shkrim dhe me gojë pa bërë gabime gramatikore; ✓ krahason persona, vende dhe objekte duke përdorur saktë shkallët e mbiemrave; ✓ aplikon rregullat gramatikore të mësuara në situata të ndryshme.

SHKALLA IV

Nivelet e arritjes janë përcaktuar duke u mbështetur tek Kuadri i Përbashkët Evropian i Referencave (KPER) për gjuhët. Nxënësi në përfundim të shkallës 4 e cila përkon me përfundimin e klasës së 9^{të} duhet të ketë arritur nivelin A2.2 sipas KPER.

Më poshtë jepet përshkrimi i nivelit A2 sipas shkallës globale KPER.

“Nxënësi mund të kuptojë pikat kryesore të një informacioni të qartë dhe standard për çështje me të cilat përballet rregullisht në shkollë, familje, kohë të lirë etj. Ai mund të zgjidhë situata që mund t’i shfaqen duke udhëtuar në vendet ku flitet gjuha që po mëson. Nxënësi gjithashtu mund të prodhojë një tekst të thjeshtë me tema që janë të njohura ose me interes për të. Ai mund të përshkruajë ngjarje, ëndrra, shpresa, ambicie dhe të japë shkurtimisht arsye dhe shpjegime për planet dhe opinionet e tij/saj.”

Kompetenca I: Të dëgjuarit e teksteve të ndryshme



Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi kupton mjaftueshëm për të plotësuar nevojat e përditshme në të dëgjuarin e mesazheve të ndryshme kur e folura është e qartë, standarde dhe flitet për tema të njohura dhe me interes personal. Nxënësi merr njohuri, zhvillon qëndrime dhe vlera të ndryshme dhe kupton se sjellja dhe qëndrimet e duhura gjatë të dëgjuarit ndikojnë pozitivisht te të tjerët.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi : ✓ dallon informacionin që lidhet me fushën e tij të interesit kur dëgjon një bisedë ose lajm kur ai jepet në modelet gjuhësore të mësuara; ✓ identifikon temën e një bisede ose informacionin bazë të një lajmi televiziv kur e folura është e qartë, e ngadaltë dhe standarde; ✓ kupton disa detaje të një mesazhi/reklame të qartë dhe të thjeshtë.	Nxënësi : ✓ kupton fjali dhe fraza të thjeshta idiomatike që lidhen me fushën e tij të interesit kur dëgjon një bisedë, si psh; informacione për veten dhe familjen, për vendbanimin, klasën e shkollën, shpjegime si të shkojnë diku, për veprimtaritë që ai bën etj.; ✓ dallon temën nga detajet që jepen në një bisedë që zhvillohet ngadalë; ✓ kupton pikat kryesore dhe detajet e një mesazhi/ reklame të thjeshtë; ✓ dallon ndryshimin e temës kur dëgjon lajmet në TV dhe krijojnë ide të përgjithshme për përmbajtjen.	Nxënësi : ✓ parashikon përmbajtjen e një informacioni që do dëgjojë duke u bazuar tek materiali i dhënë paraprak; ✓ përdor njohuritë e marra për të vlerësuar një informacion që dëgjon; ✓ krahason pikat kryesore me të gjitha detajet e një mesazhi/reklame të thjeshtë; ✓ zgjedh informacionin që i duhet nga një pjesë që dëgjon.

Kompetenca II: Të folurit për të komunikuar dhe për të mësuar

Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi ndërvepron me lehtësi në situata të strukturuar dhe dialogje të shkurtra me ndihmën e bashkëfolësit. Ai arrin pa vështirësi të zotërojë një bashkëbisedim të thjeshtë mbi temat e rutinës së përditshme duke pyetur e marrë përgjigje. Nxënësi përshkuan ose prezanton thjesht njerëz, kushtet e jetesës ose të shkollës, dëshirat, etj.



NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ shpreh me gjuhë të thjeshtë, fjali të plota dëshirat e tij ose flet për kohën e tij të lirë duke u bazuar në një model të dhënë; ✓ përdor shprehjet e mirësjelljes dhe të përshëndetjes në situata të mësuara; ✓ pyet për dhe jep informacion personal; ✓ merr pjesë me fjali të shkëputura dhe të mësuara përmendësh në një dialog të shkurtër; ✓ dallon pyetjet që bëhen për të marrë këshillë/ sugjerim ose për orientime; ✓ riprodhon shprehjet e mësuara për të përshkruar veten, shokët, familjen.	Nxënësi: ✓ zgjedh shprehjet e duhura për të dhënë ose marrë këshillë/sugjerim në një dialog të thjeshtë me temë nga jeta e përditshme; ✓ merr pjesë në një bisedë ku kërkohet informacion dhe bën veprime të thjeshta në dyqan, në bankë, në postë etj.; ✓ diskuton mbi planet e së ardhmes në një bisedë të thjeshtë; ✓ shpreh qartë qëndrimin e tij në një diskutim të thjeshtë dhe jep shembuj mbi temën, që po diskutohet; ✓ përshkruan me fjali të plota por të thjeshta dëshirat dhe interesat e tij, aktivitete, përvoja etj.	Nxënësi: ✓ modifikon shprehjet e mësuara dhe i përdor ato për të krijuar dialogje mbi tema të interesit të tij duke lidhur grupe fjalësh edhe me lidhëza të mësuara tashmë: por, sepse, edhe etj.; ✓ demonstroi aftësi komunikuese duke e filluar, vazhduar dhe përfunduar një bisedë/ fjalim të thjeshtë mbi fushat e jetës së përditshme; ✓ ndryshon temën e diskutimit duke manipuluar me shprehjet e mësuara; ✓ tregon me shembuj se bie dakort ose jo mbi temën që diskutohet; ✓ tregon një histori mbi jetën e përditshme, aktivitetet në të shkuarën, përvojat personale etj.; ✓ prezanton një temë të thjeshtë duke dhënë argumente dhe shembuj.
Kompetenca III: Të lexuarit e teksteve të ndryshme		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi kupton tekste të shkurtra dhe të thjeshta mbi tema të njohura për të që përmbajnë fjalor të një frekuece të lartë dhe me fjalor mbi jetën e përditshme, shkollën, familjen dhe punën.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV



Nxënësi: ✓ përkufizon kuptimin e drejtpërdrejtë të fjalëve të reja; ✓ dallon llojin e pjesës që lexon (letër/ kartolinë/ lajmërim/ tregim/e-mail/fax etj); ✓ dallon informacionet kryesore në përmbledhjen e një artikulli ose lajmi, kur janë të shkruara dhe të strukturuar qartë; ✓ liston detajet e dhëna në një pjesë të thjeshtë leximi; ✓ riprodhon një tekst të shkurtër dhe të thjeshtë; ✓ identifikon llojin e informacionit në lajmërimet e përditshme në vendet publike si p.sh; në restorant/ park/ stacion autobuzi, treni etj.; ✓ dallon paragrafët përbërës të një letre ose tregimi.	Nxënësi: ✓ zgjedh fjalët kyçe që e ndihmojnë të kuptojë tekstin; ✓ përmbledh një tregim duke u bazuar tek pikat e dhëna; ✓ klasifikon detajet e një pjese që lexon sipas kërkesës së dhënë; ✓ kupton udhëzimet e dhëna në pajisje që ndeshen në jetën e përditshme si telefoni, kompjuteri etj.; ✓ kupton informacionin në një letër/e-mail/fax të thjeshtë personal; ✓ kupton një mesazh të thjeshtë të shkruar nga shokët e tij , ku lihet takimi, vendi dhe ora për të shkruar diku si : në kinema, ndeshje etj.	Nxënësi: ✓ përcakton kuptimin e fjalës nga konteksti; ✓ skicon informacionin e marrë në harta të thjeshta semantike; ✓ ilustron me shembuj udhëzimet që jepen në pajisje që ndeshen në jetën e përditshme si telefoni, kompjuteri etj.; ✓ përdor lehtësisht informacionin e marë në detyrat që i jepen; ✓ krahason strukturën e një letre /e-mail me atë të një tregimi.
Kompetenca IV: Të shkruarit për qëllime personale dhe funksionale		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi mban shënime dhe shkruan tekste të shkurtra koherente mbi tema të njohura të fushës së tij të interesit. Ai shkruan tekste të shkurtra duke respektuar strukturën dhe llojin e tekstit.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV



Nxënësi: ✓ shkruan një letër/e-mail të thjeshtë falenderimi duke kopjuar modele të gatshme; ✓ mban shënime të shkurtra, të thjeshta dhe dërgon mesazhe të shkurtra për nevoja të çastit; ✓ plotëson informacion personal shumë të thjeshtë në një formular; ✓ riprodhon me shkrim fjali të thjeshta që shprehin falenderim/falje; ✓ riprodhon fjali të thjeshta rreth familjes, kushteve të jetesës, shkollës etj dhe për jetën e tij të përditshme (rutina e ditës etj).	Nxënësi: ✓ shkruan një letër/ kartolinë të thjeshtë që shpreh falenderim duke ju referuar një modeli; ✓ përshkruan me fjali të thjeshta dhe fjalor të kufizuar një ngjarje nga jeta e përditshme/familja; ✓ shkruan një listë me sendet që duhen blerë dhe për veprimet që duhet të kryhen gjatë ditës; ✓ shpjegon me fjali të thjeshta, por të shkruara saktë një përvojë / një ngjarje të ndodhur/ një situatë në shkollë etj.	Nxënësi: ✓ rishkruan një letër të thjeshtë që shpreh falenderim/ falje pa ju referuar modelit të dhënë; ✓ modifikon një tregim të thjeshtë duke përdorur persona, sende, ngjarje të ndryshme; ✓ interpreton me fjali të thjeshta qëndrimin e vet; ✓ aplikon njohuritë që ka në TIK për prezantimin e punëve me shkrim; ✓ krijon poezi mbi natyrën, njerëzit etj.
Kompetenca V: Përdorimi i drejtë i gjuhës		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi kupton, shqipton dhe përcjell mesazhin (me shkrim dhe me gojë) nëpërmjet strukturave të mësuara gramatikore, që i përkasin një repertori të memorizuar dhe situatave të njohura për të.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ dallon gjymtyrët kryesore të fjalisë. (kryefjalë/ kallëzues /kundrinor); ✓ dallon llojet e fjalive (pohore/ urdhërore/ pyetëse);	Nxënësi: ✓ ndërton fjali të thjeshta dhe të përbëra pa gabime gramatikore duke u bazuar mbi një model të dhënë;	Nxënësi: ✓ ndërton fjali të thjeshta dhe të përbëra me shkrim dhe me gojë pa bërë gabime gramatikore;



Faqe 27 nga 154

5 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË FUSHËN “MATEMATIKË”

SHKALLA III		
Kompetenca I: Zgjidhja problemore		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi përshkruan dhe zgjidh situata problemore të nivelit praktik të marra nga përvojat e përbashkëta të jetës së përditshme dhe të nivelit abstrakt duke zhvilluar kapacitetin e tij intelektual dhe intuitën krijuese.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ <i>ka njohuri</i> për simbole dhe fakte për zgjidhjen problemore që lidhen me numra; ✓ <i>kupton</i> marrëdhëniet ndërmjet numrave; ✓ <i>liston disa koncepte</i> të matjes dhe gjeometrisë në figurat 2D (D = dimensionale) dhe në objekte 3D për zgjidhjen problemore; ✓ <i>përcakton, pjesërisht, teknikën</i> e përshtatshme për zgjidhjen e problemave të thjeshta.	Nxënësi: ✓ <i>përdor një pjesë të</i> simboleve dhe fakteve për zgjidhjen problemore që lidhen me numra; ✓ <i>identifikon</i> marrëdhëniet ndërmjet numrave; ✓ <i>përdor një pjesë të</i> koncepteve të matjes dhe gjeometrisë në figurat 2D (D -dimensionale) dhe në objekte 3D për zgjidhjen problemore. ✓ <i>zbaton teknikën</i> e përshtatshme për zgjidhjen e problemave në situata të thjeshta; ✓ <i>kupton</i> tabela dhe diagrame të gatshme.	Nxënësi: ✓ <i>përdor</i> simbole dhe fakte për zgjidhjen problemore që lidhen me numra; ✓ <i>analizon</i> marrëdhëniet ndërmjet numrave; ✓ <i>zbaton</i> konceptet e matjes dhe gjeometrisë në figurat 2D (D = dimensionale) dhe në objekte 3D për zgjidhjen problemore; ✓ <i>përzgjedh dhe zbaton</i> strategji të përshtatshme për zgjidhjen e problemave në situata të reja të pafamiljarizuara; ✓ <i>kryen vrojtime dhe interpretime</i> të tabelave dhe diagrameve të gatshme.



Kompetenca II: Arsyetimi, vërtetimi matematik dhe të menduarit e komunikimi matematik

Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi përdor arsyetimin, argumentimin dhe vërtetimin si aspekte themelore të matematikës duke organizuar në mënyrë logjike faktet, idetë ose konceptet në mënyrë që të arrijë në një rezultat më të besueshëm se intuita. Ai përdor komunikimin nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit për të organizuar dhe qartësuar të menduarin matematik duke kuptuar se kjo gjuhë përdoret jo vetëm në lëndë të tjera, por edhe në jetën e përditshme.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ <i>njeh</i> terminologjinë matematikore (p.sh. numër dhjetor, thyesë, përqindje, modë, medianë etj.) dhe simbolet algjebrike e gjeometrike; ✓ <i>njeh</i> disa lloje të numrave racionalë dhe ✓ <i>kupton</i> pjesërisht argumentet për shndërrimet algjebrike, gjeometrike etj.; ✓ <i>kupton</i> të dhënat empirike për figurat 2D dhe objektet 3D; ✓ <i>ka njohuri</i> për ndërtimet e figurave gjeometrike; ✓ <i>identifikon</i> matjet për figurat 2D dhe objektet 3D; ✓ <i>dallon</i> konceptet në problema nga situata të thjeshta praktike.	Nxënësi: ✓ <i>përdor</i> terminologjinë matematikore (p.sh. numër dhjetor, thyesë, përqindje, modë, medianë etj.) dhe simbolet algjebrike e gjeometrike; ✓ <i>identifikon</i> llojet e numrave racionalë dhe <i>përdor</i> argumentet për shndërrimet algjebrike, gjeometrike etj. ✓ <i>identifikon</i> kundërshebullin për të argumentuar rezultatin; ✓ <i>grumbullon</i> të dhëna empirike për figurat 2D dhe objektet 3D; ✓ <i>ka njohuri</i> për disa formula dhe <i>ndërton pjesërisht</i>, figura gjeometrike; ✓ <i>identifikon</i> matjet për figurat 2D dhe objektet 3D; ✓ <i>zbaton</i> konceptet në problema nga situata të thjeshta praktike.	Nxënësi: ✓ <i>përzgjedh dhe përdor</i> terminologjinë e duhur matematikore (p.sh. numër dhjetor, thyesë, përqindje, modë, medianë etj.) dhe simbolet algjebrike e gjeometrike; ✓ <i>klasifikon</i> numrat racionalë dhe argumenton shndërrimet algjebrike, gjeometrike etj. ✓ <i>analizon</i> kundërshebullin, gjatë arsyetimit, për të argumentuar rezultatin; ✓ <i>prezanton</i> të dhëna empirike për figurat 2D dhe objektet 3D; ✓ <i>sugjeron</i> formula të ndryshme dhe ndërton, lehtësisht, figura gjeometrike; ✓ <i>kryen</i> matje për figurat 2D dhe objektet 3D;



		✓ <i>krijon</i> paraqitje të koncepteve matematike (për shembull: me mjete konkrete, vizatime, numra, simbole, tabela, diagrame) dhe i zbaton në problema nga situata reale të pafamiljarizuara.
Kompetenca III: Modelimi matematik dhe lidhja konceptuale		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi përshkruan dhe krijon modele duke përdorur veprimet themelore matematikore në situata të jetës së përditshme. Ai modelon situata nga jeta reale me gjuhën matematikore duke përdorur koncepte matematike për të formuar një të tërë si dhe kupton varësitë ndërmjet këtyre koncepteve.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ <i>kupton</i> modele që përmbajnë konceptet bazë matematikore si numër dhjetor, thyesë, përqindje, eksponent, kënde, kongruencë dhe simetri etj; ✓ <i>dallon</i> figurat simbolike përmes vijave dhe grafikëve për zgjidhjen e problemeve në situata të thjeshta praktike. ✓ <i>lidh pjesërisht</i> konceptet dhe procedurat e njohura matematikore.	Nxënësi: ✓ <i>përdor</i> modele që përmbajnë konceptet bazë matematikore si numër dhjetor, thyesë, përqindje, eksponent, kënde, kongruencë dhe simetri etj; ✓ <i>identifikon</i> figurat simbolike përmes vijave dhe grafikëve, për zgjidhjen e problemeve në situata të thjeshta praktike; ✓ <i>lidh</i> konceptet e ndryshme matematike në mënyrë që të zgjidhë	Nxënësi: ✓ <i>krijon</i> modele që përmbajnë konceptet bazë matematikore si numër dhjetor, thyesë, përqindje, eksponent, kënde, kongruencë dhe simetri etj; ✓ <i>analizon</i> figurat simbolike përmes vijave dhe grafikëve, për përshkrimin dhe zgjidhjen e problemeve në situata praktike; ✓ <i>integron</i> njohuritë e shprehurit matematike me situata ose dukuri



	problema në situata praktike të njohura.	të marra nga kontekste të tjera (jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet etj.); ✓ integron/lidh konceptet e ndryshme matematike në mënyrë që të zgjidhë problema në situata praktike të pafamiljarizuara.
Kompetenca IV: Përdorimi i teknologjisë në matematikë		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi përdor teknologjinë si mjet për të zgjidhur apo verifikuar zgjidhjet si dhe për të mbledhur, komunikuar e zbuluar informacione.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ <i>njih dhe kupton</i> makinën llogaritëse për verifikimin e zgjidhjes së problemeve të thjeshta matematikore; ✓ <i>zgjidh pjesërisht</i> detyra matematike duke përdorur aftësitë e fituara në fushën e Teknologjisë dhe TIK-ut.	Nxënësi: ✓ <i>përdor</i> makina llogaritëse të avancuara për verifikimin e zgjidhjes së problemeve të thjeshta matematikore; ✓ <i>zgjidh pjesërisht</i> detyra matematike, duke përdorur aftësitë e fituara në fushën e Teknologjisë dhe TIK-ut; ✓ <i>përdor</i> teknologjinë për të komunikuar informacionin matematik.	Nxënësi: ✓ <i>përdor</i> makina llogaritëse të avancuara për verifikimin dhe zgjidhjen e problemeve situata të panjohura; ✓ <i>zgjidh</i> detyra matematike, duke përdorur aftësitë e fituara në fushën e Teknologjisë dhe TIK-ut; ✓ <i>përdor</i> teknologjinë për të analizuar, komunikuar dhe zbuluar informacion matematik si dhe për zbatime të matematikës në shkencat e tjera.



Kompetenca I: Zgjidhja problemore

Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi përshkruan dhe zgjidh situata problemore të nivelit praktik të marra nga përvojat e përbashkëta të jetës së përditshme dhe të nivelit abstrakt duke zhvilluar kapacitetin e tij intelektual dhe intuitën krijuese.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ <i>ka njohuri dhe kupton</i> konceptet, simbolet për zgjidhjen e situatave problemore që lidhen me numra; ✓ <i>kupton</i> hapat për zgjidhjen e problemave që lidhen me shprehjet algjebrike dhe transformime gjeometrike; ✓ <i>përdor</i> matje të thjeshta në figurat 2D dhe në objekte 3D; ✓ <i>kupton</i> situata problemore që krijohen me numrat, shprehje algjebrike, figura 2D, objekte 3D nga përvojat të thjeshta të jetës së përditshme.	Nxënësi: ✓ <i>përdor</i> një pjesë të koncepteve, simboleve për zgjidhjen problemore që lidhen me numra; ✓ <i>zbaton</i> hapat për zgjidhjen e problemave që lidhen me shprehjet algjebrike dhe transformime gjeometrike; ✓ <i>përdor</i> matjet në figurat 2D dhe në objekte 3D në situata praktike; ✓ <i>kryen vrojtime</i> që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike; ✓ <i>përshkruan matematikisht</i> situata problemore që krijohen me numra, shprehje algjebrike, figura 2D, objekte 3D nga përvojat e përbashkëta të jetës së përditshme të njohura.	Nxënësi: ✓ <i>përdor</i> koncepte, simbole dhe fakte për zgjidhjen problemore që lidhen me numra; ✓ <i>demonstron zgjidhjen problemore</i> që lidhet me shprehjet algjebrike dhe transformime gjeometrike; ✓ <i>përdor</i> matjet në figurat 2D dhe në objekte 3D në situata praktike të pafamiljarizuara; ✓ <i>përzgjedh</i> dhe <i>zbaton</i> strategji të përshtatshme për zgjidhjen e problemave; ✓ <i>kryen vrojtime</i> dhe <i>hetime</i> që ndihmojnë në të kuptuarit e njohurive dhe zotërimin e shprehive matematike; ✓ <i>krijon</i> situata problemore duke përdorur numra, shprehje algjebrike, figura 2D, objekte 3D nga lëndët e tjera dhe nga përvojat e përbashkëta të jetës së përditshme.

Kompetenca II: Arsytimi, vërtetimi matematik dhe të menduarit e komunikimi matematik


Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi përdor arsyetimin, argumentimin dhe vërtetimin si aspekte themelore të matematikës duke organizuar në mënyrë logjike faktet, idetë ose konceptet në mënyrë që të arrijë në një rezultat më të besueshëm se intuita. Ai përdor komunikimin nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit për të organizuar dhe qartësuar të menduarin matematik duke kuptuar se kjo gjuhë përdoret jo vetëm në lëndë të tjera, por edhe në jetën e përditshme.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ <i>kupton</i> pohime matematike përmes metodave direkte, të zbatuara në veprimet me numra, transformime gjeometrike, matje, probabilitet dhe statistikë etj; ✓ <i>identifikon</i> shprehitë e arsyetimit (si: dallimi i marrëdhënieve, deduksione të thjeshta); ✓ <i>përdor</i> argumente të thjeshta matematike për përfundimet e gjetura; ✓ <i>grumbullon</i> të dhëna nga burime të ndryshme që lidhen me numrat dhe vetitë e tyre, shprehje algjebrike, statistikë dhe probabilitet; ✓ <i>dallon</i> koncepte matematike duke i përdorur, <i>pjesërisht</i>, në zgjidhjen e problemave me <i>situata të thjeshta</i>;	Nxënësi: ✓ <i>arsyeton disa</i> pohime matematike përmes metodave direkte, të zbatuara në veprimet me numra, transformime gjeometrike, matje, probabilitet dhe statistikë etj; ✓ <i>zbaton</i> shprehitë e arsyetimit (si : dallimi i marrëdhënieve, përgjithësime me anë të induksionit, deduksione të thjeshta); ✓ <i>planifikon</i> argumente të pjesshme matematike për përfundimet e gjetura; ✓ <i>formulon</i> konkludime të përshtatshme matematike duke grumbulluar të dhënat nga burime që lidhen me numrat dhe vetitë e tyre, shprehje algjebrike, statistikë dhe probabilitet;	Nxënësi: ✓ <i>arsyeton dhe vërteton</i> pohime matematike përmes metodave direkte dhe indirekte, të zbatuara në veprimet me numra, transformime gjeometrike, matje, probabilitet dhe statistikë etj; ✓ <i>zhvillon dhe zbaton</i> shprehitë e arsyetimit (si: dallimi i marrëdhënieve, përgjithësime me anë të induksionit, deduksione të thjeshta, përdorimi empirik i kundërshtimit) duke <i>hamendësuar apo duke gjykuar hamendësime</i>; ✓ <i>strukturon</i> argumente matematike për përfundimet e gjetura. ✓ <i>gjeneron</i> konkludime të përshtatshme matematike duke grumbulluar dhe përpunuar të



✓ <i>përdor pak</i> burime për marrjen e informacionit.	✓ <i>përkthen pjesërisht</i> nga gjuha natyrore në atë të matematikës dhe komunikon të menduarin e tij matematik (nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, të dëgjuarit); ✓ <i>kryen krahasime të pjesshme</i> të koncepteve matematike dhe zbaton paraqitje të përshtatshme në zgjidhjen e problemave me <i>situata të njohura</i>; ✓ <i>përdor burime të kufizuara</i>, për marrjen e informacionit.	dhënat nga burime të ndryshme që lidhen me numrat dhe vetitë e tyre, shprehje algjebrike, statistikë dhe probabilitet; ✓ <i>përkthen nga gjuha natyrore</i> në atë të matematikës dhe anasjelltas dhe komunikon të menduarin e tij matematik (nëpërmjet të lexuarit, të shkruarit, diskutimit, të dëgjuarit, të pyeturit); ✓ <i>krijon shumëllojshmëri</i> të paraqitjeve me vizatime apo me përdorimin e teknologjisë, të koncepteve matematike (numerike, gjeometrike, algjebrike, grafike); ✓ <i>kryen krahasime të koncepteve matematike</i> dhe zbaton paraqitje të përshtatshme në zgjidhjen e problemave me <i>situata të reja të pafamiljarizuara</i>; ✓ <i>përdor shumëllojshmëri</i> burimesh për marrjen e informacionit.
Kompetenca III: Modelimi matematik dhe lidhja konceptuale		



Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi përshkruan dhe krijon modele duke përdorur veprimet themelore matematikore në situata të jetës së përditshme. Ai modelon situata nga jeta reale me gjuhën matematikore duke përdorur koncepte matematike për të formuar një të tërë si dhe kupton varësitë ndërmjet këtyre koncepteve.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ <i>kupton</i> modele që përmbajnë konceptet bazë matematikore si numër dhjetor, thyesë, përqindje, rrënjë katrore, ngjashmëri, funksion linear, polinome kënde, kongruencë, simetritë; ✓ <i>njeh</i> parimin e modelimit matematikor për zgjidhjen e situatave të thjeshta problemore nga matematika dhe jeta e përditshme; ✓ <i>dallon</i> figurat simbolike, tabelat dhe digramat në zgjidhjen e problemeve të thjeshta praktike. ✓ <i>lidh pjesërisht</i> koncepte të reja matematike me ato të përvetësuara më parë nga fusha e matematikës e fushat e tjera; ✓ <i>ka njohuri</i> për varësitë ndërmjet koncepteve matematike mbi njëri-tjetrit dhe <i>integron pjesërisht</i>	Nxënësi: ✓ <i>zbaton</i> modele që përmbajnë konceptet bazë matematikore si numër dhjetor, thyesë, përqindje, rrënjë katrore, ngjashmëri, funksion linear, polinome kënde, kongruencë simetri etj; ✓ <i>përdor</i> parimin e modelimit matematikor për zgjidhjen e situatave problemore të thjeshta nga matematika, fushat e tjera dhe jeta e përditshme; ✓ <i>përdor</i> figurat simbolike, tabelat dhe digramat për zgjidhjen e problemeve të thjeshta praktike ✓ <i>lidh</i> koncepte të reja matematike me ato të përvetësuara më parë nga fusha e matematikës e fushat e tjera; ✓ <i>analizon</i> varësitë ndërmjet koncepteve matematike mbi	Nxënësi: ✓ <i>krijon shumëllojshmëri</i> modelesh që përmbajnë konceptet bazë matematikore si numër dhjetor, thyesë, përqindje, rrënjë katrore, ngjashmëri, funksion linear, polinome kënde, kongruencë simetri, bazuar në parimin e modelimit matematikor; ✓ <i>analizon</i> marrëdhëniet ndërmjet bashkësive numerike dhe zbaton parimin e modelimit matematikor për zgjidhjen e situatave të reja problemore nga matematika, fushat e tjera dhe jeta e përditshme. ✓ <i>përdor</i> figurat simbolike përmes vijave dhe grafikëve, përdor tabelat dhe digramat për përshkrimin dhe zgjidhjen e problemeve të ndryshme të



njohuritë dhe shprehinë matematike në situata të thjeshta.	njëri- tjetrin dhe integron njohuritë dhe shprehinë matematike në situata të thjeshta praktike; ✓ <i>siguron pak informacione</i> lidhur me zhvillimin e koncepteve matematike përgjatë kohës dhe në kultura të ndryshme.	simuluara ose në situata të reja të pafamiljarizuara. ✓ <i>lidh koncepte dhe modele</i> të reja matematike me ato të përvetësuara më parë nga fusha e matematikës e fushat e tjera dhe <i>analizon</i> formimin e tyre; ✓ <i>gjykon dhe vlerëson</i> varësitë ndërmjet koncepteve matematike mbi njëri- tjetrin, për të formuar një të tërë, integron njohuritë dhe shprehinë matematike me situata ose dukuri të marra nga kontekste të reja nga jeta e përditshme, lëndët e tjera, sportet, arti dhe kultura, ngjarjet aktuale etj.; ✓ <i>shpreh gatishmëri</i> dhe siguron <i>shumëllojshmëri</i> informacionesh të ndryshme lidhur me zhvillimin e koncepteve matematike përgjatë kohës dhe në kultura të ndryshme.
Kompetenca IV: Përdorimi i teknologjisë në matematikë		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi përdor teknologjinë si mjet për të zgjidhur apo verifikuar zgjidhjet si dhe për të mbledhur, komunikuar e zbuluar informacione.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV



Nxënësi: ✓ <i>ka njohuri dhe kupton</i> përdorimin e makinave llogaritëse të avancuara për verifikimin e zgjidhjes së problemeve matematikore; ✓ <i>zbaton</i> aftësitë e fituara në fushën e teknologjisë e TIK- ut.	Nxënësi: ✓ <i>përdor pjesërisht</i> makina llogaritëse të avancuara për verifikimin e zgjidhjes së problemeve matematikore; ✓ <i>zgjidh, pjesërisht, detyra</i> matematike, duke përdorur aftësitë e fituara në fushën e teknologjisë e TIK- ut (p.sh. EXCEL); ✓ <i>përdor</i> teknologjinë për të interpretuar informacionin matematik.	Nxënësi: ✓ <i>përdor</i> makina llogaritëse të avancuara për verifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të ndërlikuara matematikore; ✓ <i>zgjidh detyra</i> matematike, duke përdorur aftësitë e fituara në fushën e teknologjisë e TIK- ut dhe <i>verifikon</i> rezultatet e problemeve të ndryshme duke përdorur TIK dhe programe (p.sh. EXCEL); ✓ <i>përdor</i> teknologjinë për të analizuar, interpretuar, zbuluar informacion matematik si dhe për zbatime të matematikës në shkencat e tjera.
--	--	--



6 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË FUSHËN “SHKENCAT E NATYRËS”

6.1 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “FIZIKË”

SHKALLA III		
Kompetenca I: Identifikimi i problemeve dhe zgjidhja e tyre		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi identifikon karakteristikat shkencore të problemit, thekson elementet që kanë lidhje me njëri-tjetrin dhe e formulon problemin. Ai merr parasysh strategji të ndryshme, kufizimet që shoqërojnë secilën prej tyre, zgjedh atë që mendon se është më e mira, argumenton zgjedhjen e bërë dhe planifikon procedurën. Nxënësi kërkon trendët domethënës në të dhënat ose provat tipike, kontrollon rezultatet sipas procedurës, formulon probleme të reja ose sugjeron mënyrat e përmirësimit të zgjidhjes dhe nxjerr rezultatet. Ai ndjek hapat e planit dhe nëse është e nevojshme, përshtat testet e tij, e rishikon planin ose kërkon një mënyrë të re për zgjidhjen e problemit. Ai mban shënim për çdo detaj ose vrojtim të nevojshëm për analizën e problemit.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV



Nxënësi : ✓ përzgjedh pak informacione shkencore për të prezantuar problemin; ✓ përshkruan disa nga hapat e procedurës për planifikimin e një kërkimi shkencor; ✓ identifikon disa nga karakteristikat shkencore të problemit; ✓ përshkruan me pak gabime hipotezat, konceptet, ligjet, teoritë, parimet e fizikës; ✓ identifikon madhësitë fizike, duke i interpretuar me shembuj nga teksti; ✓ përkufizon me pak gabime madhësitë fizike; ✓ vizaton simbolet e madhësive fizike.	Nxënësi : ✓ përzgjedh disa informacione shkencore për të prezantuar problemin; ✓ propozon hapat për ndjekjen e procedurës së zgjidhjes; ✓ identifikon karakteristikat kryesore shkencore të problemit; ✓ përshkruan hapat kryesorë që duhet të ndiqen për të mbledhur të dhënat dhe për të realizuar procedurat; ✓ prezanton zgjidhjet e tij me disa gabime, duke përdorur gjuhën bazë shkencore dhe teknologjike; ✓ formulon një hipotezë ose një zgjidhje të mundshme me një shkallë të konsiderueshme efektiviteti; ✓ shpjegon përgjithësisht mirë hipotezat, konceptet, ligjet, teoritë, parimet e fizikës, duke i interpretuar ato me shembuj nga teksti; ✓ shpjegon madhësitë fizike duke i interpretuar me shembuj të ngjashëm me ato të tekstit; ✓ përkufizon madhësitë fizike duke i interpretuar me shembuj nga teksti;	Nxënësi : ✓ përzgjedh informacione të sakta dhe të plota për zgjidhjen e një problemi; ✓ paraqet saktë hapat e procedurës së zgjidhjes dhe vendos lidhjen mes elementëve të problemit; ✓ analizon karakteristikat shkencore të problemit; ✓ përdor metodën e përpunimit të të dhënave për të interpretuar lehtësisht problemin; ✓ prezanton zgjidhjet e tij me metodat më efikase dhe i interpreton ato duke përdorur gjuhën e saktë shkencore dhe teknologjike; ✓ formulon hipoteza ose jep modele zgjidhjesh të mundshme të problemit me shkallën më të lartë të efektivitetit; ✓ kontrollon nëse përputhen hipotezat me rezultatet e analizave të bëra; ✓ argumenton hipotezat, konceptet, ligjet, teoritë, parimet e fizikës, duke i testuar vertetësinë e tyre me shembuj nga situata të jetës reale; ✓ analizon madhësitë fizike duke i interpretuar me shembuj nga situata të jetës reale;
--	---	---



✓ liston me ndihmën e mësuesit disa nga madhësitë fizike që përdoren për ndërtimin e hartës së koncepteve; ✓ përdor rallë simulimet për të konkretizuar dukuritë dhe proceset e fizikës.	✓ përdor me pak vështirësi pajisjet për të demonstruar parimet, dukuritë dhe ligjet kryesore të fizikës; ✓ përdor kompjuterin në raste të thjeshta; ✓ përdor njësitet matëse të madhësive fizike duke bërë gabime të vogla gjatë zgjidhjes së ushtrimeve; ✓ ndërton pjesërisht hartën e koncepteve për një tematikë të caktuar; ✓ përdor simulimet dhe përpiqet t'i shpjegojë dukuritë, proceset e fizikës përmes tyre.	✓ përdor saktë njësitet matëse të madhësive fizike gjatë zgjidhjes së ushtrimeve; ✓ argumenton hartën e koncepteve për një tematikë të caktuar; ✓ analizon dukuritë, proceset dhe ligjet e fizikës përmes simulimeve.
Kompetenca III : Komunikimi në gjuhën dhe terminologjinë e shkencës		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi shkëmben informacione shkencore me të tjerët. Ai kupton rolin e ndarjes së informacionit dhe është i hapur në këndvështrimet e të tjerëve, krahason të dhënat dhe procedurat e tij me ato të të tjerëve dhe vlerëson këndvështrimin ose zgjidhjen e tij duke i krahasuar me ato të të tjerëve. Nxënësi përhap dhe zhvillon njohuritë ose rezultatet shkencore. Ai merr parasysh përbërjen e audiencës, përdor mënyra të ndryshme për prezantimin e informacionit (p.sh., simbolet, tabelat, vizatimet teknike) dhe përshtat mesazhin sipas tipit të medias që përdor (p.sh. prezantim me gojë ose me shkrim etj.). Nxënësi interpreton dhe formulon mesazhe shkencore. Ai përdor informacionin shkencor dhe teknologjik të marrë nga burime të ndryshme duke u siguruar që burimet të jenë të besueshme dhe të përshtatshme. Ai prezanton informacionin sipas rregullave dhe konvencioneve të shkencës, teknologjisë dhe matematikës.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV



Nxënësi: ✓ përzgjedh disa të dhëna për të përfunduar detyrën; ✓ përdor disa burime të diskutueshme informacioni; ✓ përdor gjuhë dhe terminologji të papërshtatshme në kundërshtim me rregullat dhe marrëveshjet kur bën shpjegimet në lidhje me dukuritë dhe ligjet e fizikës që trajton; ✓ identifikon me pak gabime madhësitë fizike të vendosura në tabela, diagrame dhe grafikë; ✓ përkufizon me pak gabime koncepte, ide, teori, parime, ligje, procedura dhe procese fizike; ✓ përdor me vështirësi terminologjinë e duhur për të shprehur simbolikisht madhësitë fizike, formulat, njësitë matëse të sistemit SI.	Nxënësi: ✓ përzgjedh disa të dhëna kryesore për të përfunduar detyrën; ✓ përdor disa burime të besueshme të informacionit, për problemin që do të trajtohet; ✓ shpjegon madhësitë fizike më kryesore kur punon me tekste, diagrame, tabela dhe grafikë; ✓ përdor gjuhën dhe terminologjinë e thjeshtë në përputhje me rregullat dhe marrëveshjet, kur bën shpjegimet në lidhje me dukuritë dhe ligjet e fizikës që trajton; ✓ shpjegon pjesërisht madhësitë fizike të vendosura në tabela, diagrame dhe grafikë; ✓ shpjegon përgjithësisht mirë koncepte, ide, teori, parime, ligje, procedura dhe procese fizike, duke i ilustruar ato me shembuj nga teksti; ✓ përdor pjesërisht mirë terminologjinë e duhur për të shprehur simbolikisht madhësitë fizike, formulat, njësitë matëse të sistemit SI.	Nxënësi : ✓ përzgjedh saktë të dhënat e duhura për të përfunduar detyrën; ✓ përdor burimet përkatëse të informacionit dhe argumenton vërtetësinë e tyre; ✓ interpreton me efikasitet madhësitë fizike kur punon me tekste, diagrame, tabela dhe grafikë; ✓ përdor me efikasitet gjuhën dhe terminologjinë e duhur në përputhje me rregullat dhe marrëveshjet kur bën shpjegimet në lidhje me dukuritë dhe ligjet e fizikës që trajton; ✓ interpreton qartë madhësitë fizike të vendosura në tabela, diagrame dhe grafikë; ✓ interpreton saktë koncepte, ide, teori, parime, ligje, procedura dhe procese fizike duke i konkretizuar ato me shembuj nga situata të jetës reale; ✓ përdor saktë me lehtësi terminologjinë e duhur për të shprehur simbolikisht madhësitë fizike, formulat, njësitë matëse të sistemit SI.
---	--	---



SHKALLA IV

Kompetenca 1: “Identifikimi i problemeve dhe zgjidhja e tyre”

Përshkrimi i kompetencës:

Nxënësi identifikon karakteristikat shkencore të problemit, thekson elementet që kanë lidhje me njeri-tjetrin dhe e formulon problemin. Ai merr parasysh strategji të ndryshme, kufizimet që shoqërojnë secilën prej tyre, zgjedh atë që mendon se është më e mira, argumenton zgjedhjen e bërë dhe planifikon procedurën. Nxënësi kërkon trendët domethënës në të dhënat ose provat tipike, kontrollon rezultatet sipas procedurës, formulon probleme të reja ose sugjeron mënyrat e përmirësimit të zgjidhjes dhe nxjerr rezultatet. Ai ndjek hapat e planit dhe, nëse është e nevojshme, përshtat testet e tij, e rishikon planin ose kërkon një mënyrë të re për zgjidhjen e problemit. Ai mban shënim për çdo detaj ose vërtetim të nevojshëm për analizën e problemit.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi : ✓ bën supozime që lidhen pak a shumë me problemin që do të zgjidhet; ✓ propozon një plan jo të plotë të veprimit, duke identifikuar variabla që nuk kanë shumë rëndësi; ✓ përshkruan disa nga hapat për të realizuar zgjidhjen; ✓ identifikon variablat pa marrë parasysh rezultatit e zgjidhjes;	Nxënësi: ✓ identifikon elementet e problemit, që do të zgjidhet; ✓ formulon hipoteza apo zgjidhje të mundshme, që lidhen me problemin që duhet të zgjidhet; ✓ propozon një plan bazë veprimi që identifikon variablat që përcaktojnë rezultatit; ✓ punon me përgjegjësi për sigurinë e vet dhe të njerëzve të tjerë; ✓ paraqet disa nga informacionet e mbledhura dhe ndjek hapat e	Nxënësi: ✓ përshkruan në mënyrë të qartë dhe të plotë problemin që do të zgjidhet; ✓ argumenton hipoteza apo zgjidhje të mundshme që lidhen me konceptet e duhura; ✓ propozon një plan efikas të veprimit për zgjidhjen e plotë të problemit; ✓ sugjeron përmirësime në planin e tij të veprimit, bazuar në rezultatet e marra; ✓ planifikon hapat në planin e tij të veprimit, duke siguruar kontrollin e variablave që saktësisht ndikojnë në rezultat;



	✓ shpjegon pjesërisht karakteristikat e një madhësie fizike; ✓ demonstroi pjesërisht një dukuri apo ligj të fizikës; ✓ realizon ilustrime të thjeshta nëpërmjet demonstrimeve vizuale apo simulimeve ✓ për dukuritë dhe ligjet e fizikës.	
Kompetenca II: Përdorimi i mjeteve, objekteve dhe procedurave shkencore		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi studion ndikimet afatgjata të shkencës dhe të teknologjisë tek individët, shoqëria, mjedisi dhe ekonomia. Ai vendos shkencën dhe teknologjinë në kontekstet e tyre sociale dhe historike, si dhe studion ndikimin e tyre në mënyrën e jetesës së njerëzve. Nxënësi identifikon pyetje ose çështje etike. Ai kupton si funksionojnë objektet teknike, tregon kuriozitet për to, shqyrton përbërjen dhe funksionimin e tyre dhe, nëse është e nevojshme, i zbërthen në pjesë, identifikon materialet, pjesët dhe tipat e ndryshëm të lidhjeve në objektet teknike, dallon sisteme dhe nënsisteme të ndryshme dhe shpjegon si funksionojnë ato. Nxënësi kupton dukuritë natyrore, pyet veten rreth mjedisit të tij, shqyrton dukuri të veçanta dhe përshkruan karakteristikat e tyre, i ilustron ato me diagrama skematike, shpjegon dukuritë duke përdorur ligjet ose modelet dhe siguron koherencën e shpjegimit. Ai familjarizohet me konceptet që lidhen me dukuritë dhe pranon lidhjen e tyre.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ formulon pyetje që bazohen në elemente dytësore;	Nxënësi : ✓ formulon pyetje ose ofron një zgjidhje, duke përcaktuar aspektet thelbësore të çështjes;	Nxënësi: ✓ propozon zgjidhje ose jep shpjegimin e tij duke zbatuar parimet bazë të fizikës;



✓ propozon një zgjidhje që është e pabazuar; ✓ përdor disa koncepte që lidhen me çështjen; ✓ emërton disa nga madhësitë fizike kryesore; ✓ përshkruan shkurtimisht zgjidhjen e një problemi; ✓ përshkruan shkurtimisht me gabime dukuritë dhe ligjet e fizikës; ✓ përdor disa të dhëna për të argumentuar zgjidhjen e problemit; ✓ tregon pak siguri gjatë përdorimit të pajisjeve laboratorike; ✓ ndërton disa diagrama të thjeshta për të prezantuar madhësitë fizike, dukuritë, ligjet, parimet e fizikës; ✓ përdor në disa raste pajisje të thjeshta për të demonstruar parimet, dukuritë dhe ligjet e fizikës; ✓ përdor në disa raste kompjuterin, për përpunimin e të dhënave; ✓ përcakton me ndihmën e mësuesit njësitë matëse të madhësive fizike; ✓ emërton disa nga madhësitë fizike që përdoren për ndërtimin e hartës së koncepteve;	✓ përcakton karakteristikat e përgjithshme të një trupi ose sistem trupash; ✓ zbaton pjesërisht ligjet e fizikës në ushtrime të thjeshta praktike; ✓ përshkruan përgjithësisht mirë parimet dhe ligjet e fizikës; ✓ përdor aparatën matematikor në situata të thjeshta; ✓ jep shpjegime të pjesshme ose propozon zgjidhje që lidhen me problemin; ✓ përdor në përgjithësi mirë teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit, për të paraqitur të dhënat në tabela, grafikë dhe diagrama; ✓ tregon kujdes gjatë përdorimit të pajisjeve laboratorike; ✓ ndërton pjesërisht diagramat kryesore për të prezantuar madhësitë fizike, dukuritë, ligjet, parimet e fizikës; ✓ përdor në përgjithësi mirë pajisjet për të demonstruar parimet, dukuritë dhe ligjet kryesore të fizikës; ✓ përdor disa herë kompjuterin, për përpunimin e të dhënave;	✓ argumenton ligjet, parimet e fizikës në situata të jetës reeale; ✓ jep shpjegime, justifikon zgjidhjet e tij ose mbron mendimet e veta duke respektuar parimet bazë të fizikës; ✓ pasuron shpjegimet e tij duke përdorur aparatën matematikor; ✓ analizon tabelat, grafikët dhe diagramat, e ndërtuar duke përdorur TIK-un; ✓ tregon siguri të lartë në përdorimin e pajisjeve laboratorike; ✓ ndërton saktë të gjitha diagramat për të prezantuar madhësitë fizike, dukuritë, ligjet, parimet e fizikës; ✓ përdor të gjitha pajisjet e duhura për të demonstruar të gjithë parimet, dukuritë dhe ligjet e fizikës; ✓ përdor me efikasitet të lartë kompjuterin, për përpunimin e të dhënave; ✓ përdor saktë njësitë matëse të madhësive fizike gjatë zgjidhjes së ushtrimeve; ✓ argumenton hartën e koncepteve për një tematikë të caktuar; ✓ analizon dukuritë, proceset dhe ligjet e fizikës përmes simulimeve.
---	---	--



✓ përdor rallë simulimet për të konkretizuar dukuritë, proceset, ligjet e fizikës.	✓ përdor pjesërisht njësité matëse të madhësive fizike gjatë zgjidhjes së ushtrimeve; ✓ ndërton pjesëishtë hartën e koncepteve për një tematikë të caktuar; ✓ përdor disa herë simulimet dhe përpiqet ti shpjegojë dukuritë, proceset dhe ligjet e fizikës përmes tyre.	
--	---	--

Kompetenca III : Komunikimi në gjuhën dhe terminologjinë e shkencës

Përshkrimi i kompetencës:

Nxënësi shkëmben informacione shkencore me të tjerët. Ai kupton rolin e ndarjes së informacionit dhe është i hapur në këndvështrimet e të tjerëve, krahason të dhënat dhe procedurat e tij me ato të të tjerëve dhe vlerëson këndvështrimin ose zgjidhjen e tij duke i krahasuar me ato të të tjerëve. Nxënësi përhap dhe zhvillon njohuritë ose rezultatet shkencore. Ai merr parasysh përbërjen e audiencës, përdor mënyra të ndryshme për prezantimin e informacionit (p.sh., simbolet, tabelat, vizatimet teknike) dhe përshtat mesazhin sipas tipit të medias që përdor (p.sh. prezantim me gojë ose me shkrim etj.). Nxënësi interpreton dhe formulon mesazhe shkencore. Ai përdor informacionin shkencor dhe teknologjik të marrë nga burime të ndryshme duke u siguruar që burimet të jenë të besueshme dhe të përshtatshme. Ai prezanton informacionin sipas rregullave dhe konvencioneve të shkencës, teknologjisë dhe matematikës.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ jep pak informacione për të shpjeguar ✓ mesazhin; ✓ shpreh konceptet, idetë, teoritë parimet, ligjet e fizikës me një	Nxënësi: ✓ përzgjedh disa informacione për të shpjeguar mesazhin; ✓ shpjegon teoritë pa shkelur të drejtat e pronësisë intelektuale;	Nxënësi : ✓ interpreton me saktësi informacionet e duhura për të argumentuar në mesazh; ✓ përdor gjuhën dhe terminologjinë e duhur për të interpretuar konceptet, idetë, teoritë parimet, ligjet e fizikës;



terminologji, e cila nuk është në përputhje me rregullat dhe marrëveshjet; ✓ identifikon madhësitë fizike të vendosura në tabela, diagrame dhe grafikë; ✓ përkufizon me pak gabime koncepte, ide, teori, parime, ligje, procedura dhe procese fizike; ✓ përdor me vështirësi terminologjinë e duhur për të shprehur simbolikisht madhësitë fizike, formulat, njësitë matëse të sistemit SI.	✓ përdor përgjithësisht mirë terminologjinë shkencore, në përputhje me rregullat dhe marrëveshjet kur shpjegon koncepte të thjeshta; ✓ përdor një terminologji të thjeshtë për interpretimin e diagramave, tabelave dhe grafikëve; ✓ shpjegon pjesërisht madhësitë fizike të vendosura në tabela, diagrame dhe grafikë; ✓ shpjegon përgjithësisht mirë koncepte, ide, teori, parime, ligje, procedura dhe procese fizike, duke i ilustruar ato me shembuj nga teksti; ✓ përdor pjesërisht mirë terminologjinë e duhur për të shprehur simbolikisht madhësitë fizike, formulat, njësitë matëse të sistemit SI.	✓ përpunon informacionin e duhur dhe e interpreton me një gjuhë të thjeshtë për tu kuptuar nga të tjerët; ✓ përzgjedh dhe përdor burime të ndryshme dhe të besueshme të informacionit; ✓ interpreton përmbajtjen e njohurive në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme ; ✓ përdor terminologjinë e duhur kur interpreton diagramat, tabelat dhe grafikët; ✓ interpreton me efikasitet madhësitë fizike të vendosura në tabela, diagrame dhe grafikë; ✓ interpreton koncepte, ide, teori, parime, ligje, procedura dhe procese fizike duke i konkretizuar ato me shembuj nga situata të jetës reale; ✓ përdor saktë me lehtësi terminologjinë e duhur për të shprehur simbolikisht madhësitë fizike, formulat, njësitë matëse të sistemit SI.
--	---	---

6.2 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “BIOLOGJI”

SHKALLA III
Kompetenca I : Identifikimi dhe zgjidhja e problemeve në biologji
Përshkrimi i kompetencës:



Nxënësi identifikon karakteristikat shkencore të problemit, thekson elementet që kanë lidhje me njeri-tjetrin dhe e formulon problemin. Ai përdor konceptet që lidhen me problemin të tilla si ato: mjedisore, diversitetit të botës bimë dhe shtazore, mikroorganizmave dhe biologjisë qelizore. Nxënësi i trajton konceptet sa më shpesh të jetë e mundur me metodën sasiore duke marrë në konsideratë gabimet e lidhura me matjet. Ai kërkon për burime shtesë për të zgjidhur problemin, justifikon zgjedhjen e metodave, strategjive apo teknikave. Nxënësi demonstroi rigorozitetin në zbatimin e procedurave dhe kontrollon variablat pa marrë udhëzime. Ai zhvillon qëndrime lidhur me efektivitetin dhe efikasitetin kur reflekton vetëm ose në grup.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ përzgjedh pak informacione për të prezantuar një problem mjedisor, shëndetsor, bioteknologjik; ✓ propozon një plan veprimi që nuk lidhet me problemin; ✓ ndjek hapat e procedurës për zgjidhjen e tij; ✓ përshkruan disa nga hapat e ndjekur dhe bën shpjegime pa kontrolluar rezultatin e zgjidhjeve.	Nxënësi: ✓ përzgjedh disa informacione shkencore dhe teknologjike për të prezantuar problemin mjedisor, shëndetsor, bioteknologjik; ✓ formulon një hipotezë ose një zgjidhje të mundshme duke u bazuar në përmbajtjen që lidhet me problemin; ✓ propozon hapat për ndjekjen e procedurës së zgjidhjes; ✓ gjatë veprimtarive tregon kujdes për sigurinë e jetës së tij dhe të tjerëve; ✓ përshkruan hapat e përdorur për të mbledhur të dhënat dhe për të realizuar procedurat; ✓ prezanton zgjidhjet e tij dhe verifikon rezultatin; ✓ përdor gjuhën bazë shkencore dhe teknologjike.	Nxënësi: ✓ përzgjedh informacionin e duhur për zgjidhjen e një problemi mjedisor, shëndetsor, bioteknologjik; ✓ formulon hipoteza ose jep modele zgjidhjesh të mundshme të problemit; ✓ bazohet në burime të ndryshme informacioni për procedurën e zgjidhjes dhe planifikon hapat për realizimin e saj; ✓ përcakton elementët e nevojshëm për të realizuar zgjidhjen; ✓ gjatë veprimtarisë shkencore kontrollojnë nëse përputhen hipotezat me rezultatet e analizave të bëra; ✓ propozon shpjegime ose zgjidhje të bazuara mbi rezultatet dhe kur e



		shikon të nevojshme <i>jep sugjerime për përmirësimin e procedurave;</i> ✓ <i>përdor gjuhën dhe terminologjinë e duhur shkencore dhe teknologjike gjatë interpretimit të zgjidhjes.</i>
Kompetenca II: Përdorimi i mjeteve, objekteve dhe procedurave shkencore në biologji		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi studion ndikimet afatgjata të shkencës dhe të teknologjisë tek individët, shoqëria, mjedisi dhe ekonomia. Ai vendos shkencën dhe teknologjinë në kontekstet e tyre sociale dhe historike, si dhe studion ndikimin e tyre në mënyrën e jetesës së njerëzve. Nxënësi identifikon pyetje ose çështje etike që lidhen me klonimin, diseksionin e kafshëve, abortin etj.. Ai kupton si funksionojnë objektet teknike, tregon kuriozitet për to, shqyrton përbërjen dhe funksionimin e tyre dhe, nëse është e nevojshme, i zbërthen në pjesë, identifikon materialet, pjesët dhe tipat e ndryshëm të lidhjeve në objektet teknike, dallon sisteme dhe nënsisteme të ndryshme dhe shpjegon si funksionojnë ato. Nxënësi kupton dukuritë natyrore, pyet veten rreth mjedisit të tij, familjarizohet me konceptet që lidhen me dukuritë dhe pranon lidhjen e tyre. Ai përdor njohuritë biologjike për shpjegimin e dukurive ose zbatimin e koncepteve biologjike duke përdorur metodën e vëzhgimit, metodën eksperimentale si dhe modelimin. Nxënësi përdor aparatën matematikor për të mbështetur arsyetimin e tij dhe argumenton shpjegimet duke përdorur diagrama skematike.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ <i>formulon pak pyetje bazuar vetëm në një aspekt të situatës që lidhet me një dukuri ose çështje biologjike;</i> ✓ <i>përdor konceptet shkencore që janë pak a shumë të rëndësishme në lidhje me problemin që trajtohet;</i>	Nxënësi: ✓ <i>formulon disa pyetje të cilave u mungojnë elemente të caktuara për të identifikuar aspektet thelbësore të një problem që lidhet me një dukuri apo çështje;</i>	Nxënësi: ✓ <i>formulon një grup të plotë pyetjesh në të cilat vërehen edhe informacione shtesë për të përshkruar një problem që lidhet me një dukuri natyrore dhe ndikimet e saj për jetën e gjallesave pëfshirë dhe njeriun;</i>



✓ <i>përdor koncepte shkencore të problemit që trajton pa e lidhur me realitetin;</i> ✓ <i>bën shpjegime të pjesshme kur jep zgjidhjet e tij/saj në lidhje me problemin që trajton;</i> ✓ <i>bën një përshkrim të shkurtër se si funksionon një objekt apo si ndodh një dukuri;</i> ✓ <i>argumenton vendimet e tij të cilat janë të papërshtatshme.</i>	✓ <i>bën shpjegime të përgjithshme se si ndodh apo funksionon një objekt apo dukuri;</i> ✓ <i>përdor koncepte shkencore të problemit që trajton pa e lidhur me realitetin;</i> ✓ <i>bën shpjegime të pjesshme kur jep zgjidhjet e tij/saj në lidhje me problemin që trajton;</i> ✓ <i>bën një përshkrim të shkurtër se si funksionon një objekt apo si ndodh një dukuri;</i> ✓ <i>argumenton vendimet e tij të cilat rezultojnë të diskutueshme.</i>	✓ <i>bën shpjegime të sakta ose zgjidhje duke përdorur edhe elemente të tjerë, që lidhen me konceptet kyçe të problemit;</i> ✓ <i>bën një përshkrim të plotë të një objekti apo dukurie, tregon se si funksionon ose si ndodh dhe bën sugjerime për përmirësim;</i> ✓ <i>argumenton zgjidhjet e tij mbi bazën e koncepteve, ligjeve, teorive apo modeleve të marra nga informacione të ndryshme.</i> ✓ <i>argumenton vendimet e tij për zgjidhjen duke u mbështetur në koncepte, ligje, teori apo modele.</i>
--	--	--

Kompetenca III: Komunikimi i ideve biologjike duke përdorur gjuhën dhe terminologjinë e shkencës

Përshkrimi i kompetencës:

Nxënësi shkëmben informacione shkencore me të tjerët. Ai kupton rolin e ndarjes së informacionit dhe është i hapur në këndvështrimet e të tjerëve, krahason të dhënat dhe procedurat e tij me ato të të tjerëve dhe vlerëson këndvështrimin ose zgjidhjen e tij duke i krahasuar me ato të të tjerëve. Nxënësi përhap dhe zhvillon njohuritë ose rezultatet shkencore. Ai prezanton idetë që lidhen me konceptet të përgjithshme si : mjedisore, gjenetike, qelizore, shëndetsore, bioteknologjike. Ai merr parasysh përbërjen e audiencës, përdor mënyra të ndryshme për prezantimin e informacionit (p.sh., simbolet, tabelat, vizatimet teknike) dhe përshtat mesazhin sipas tipit të medias që përdor (p.sh. prezantim me gojë ose me shkrim etj.). Nxënësi interpreton dhe formulon mesazhe shkencore. Ai përdor informacionin shkencor dhe teknologjik të marrë nga burime të ndryshme duke u siguruar që burimet të jenë të besueshme dhe të përshtatshme. Ai prezanton informacionin sipas rregullave dhe konvencioneve të shkencës, teknologjisë dhe matematikës.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi:	Nxënësi:	Nxënësi:



✓ <i>përzgjedh disa elemente disi të rëndësishme për të përfunduar një detyrë tematike, eksperimentale etj. në biologji;</i> ✓ <i>përzgjedh pak informacion për problemin që do të interpretohet;</i> ✓ <i>përdor disa burime të diskutueshme informacioni;</i> ✓ <i>përdor gjuhë dhe terminologji të papërshtatshme në kundërshtim me rregullat dhe marrëveshjet kur bën shpjegimet në lidhje me problemin që trajtohet;</i> ✓ <i>përzgjedh mjete të papërshtatshme për t'i vendosur të dhënat në tabela, diagrame dhe grafikë.</i>	✓ <i>përzgjedh disa elemente të nevojshme për të përfunduar detyrën;</i> ✓ <i>përdor këto elemente për të bërë interpretimet e duhura veçanërisht kur punon me tekste, diagrame, tabela dhe grafikë;</i> ✓ <i>përdor disa burime të besueshme të informacionit, të cilat argumentojnë vërtetësinë e tyre;</i> ✓ <i>përdor gjuhën dhe terminologjinë e thjeshtë në përputhje me rregullat dhe marrëveshjet kur bën shpjegimet në lidhje me problemin që trajton;</i> ✓ <i>përzgjedh disa mjete për të bërë prezantimet në tabela, diagrame dhe grafikë.</i>	✓ <i>përzgjedh në mënyrë sistematike elementet e nevojshme për të përfunduar detyrën;</i> ✓ <i>përcakton me saktësi informacionin ose të dhënat që do të interpretohen, veçanërisht kur punohet me tekste, diagrame, tabela dhe grafikë;</i> ✓ <i>përdor burimet përkatëse të informacionit dhe argumenton vërtetësinë e tyre;</i> ✓ <i>përdor gjuhën dhe terminologjinë e duhur në përputhje me rregullat dhe marrëveshjet kur përdor informacionet ose kur trajton problemin;</i> ✓ <i>përzgjedh mjetet efikase për t'i vendosur të dhënat në tabela, diagrame dhe grafikë;</i> ✓ <i>përzgjedh mjetet e përshtatshme për t'i vendosur të dhënat në tabela, diagrame dhe grafikë.</i>
--	--	---

SHKALLA IV

Kompetenca I: Identifikimi dhe zgjidhja e problemeve në biologji

Përshkrimi i kompetencës:



NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ <i>bën supozime që lidhen pak a shumë me problemin gjenetik, mjedisor, shëndetsor që do të zgjidhet;</i> ✓ <i>propozon një plan jo të plotë të veprimit duke identifikuar variabla që janë me pak ose pa asnjë rëndësi;</i> ✓ <i>përshkruan disa nga hapat e kryer ose disa aspekte të zgjidhjes;</i> ✓ <i>paraqet rezultatet dhe propozon përgjigje ose zgjidhje pa kontrolluar nëse ato janë të lidhura me problemin apo me rezultatin.</i>	Nxënësi: ✓ <i>identifikon elementet e problemit që duhet zgjidhur ose kërkesat që duhet të plotësohen;</i> ✓ <i>formulon hipoteza apo zgjidhje të mundshme që marrin në konsideratë disa nga kufizimet që lidhen me këtë problem;</i> ✓ <i>propozon një plan bazë veprimi që identifikon variablat që mund të ndikojnë në rezultat;</i> ✓ <i>punon në një mënyrë që tregon shqetësim për sigurinë e vet dhe të njerëzve të tjerë;</i> ✓ <i>paraqet disa nga informacionet e mbledhura dhe ndjek hapat e planifikuar për kryerjen e veprimtarisë;</i> ✓ <i>në një veprimtari shkencore, bën lidhjet midis hipotezës dhe analizës së tij të rezultateve;</i>	Nxënësi: ✓ <i>zgjedh informacionin përkatës lidhur me një problem gjenetik, mjedisor, shëndetsor që duhet zgjidhur;</i> ✓ <i>formulon hipoteza të besueshme apo zgjidhje të realizueshme që pasqyrojnë kufizimet që lidhen me problemin dhe kushtet me të cilat duhet të zgjidhet;</i> ✓ <i>planifikon çdo hap në planin e tij të veprimit, duke siguruar kontrollin e variablave që detyrimisht ndikojnë në rezultat;</i> ✓ <i>në kryerjen e planit të tij të veprimit, mban shënim elementet e nevojshëm për të dhënë përgjigje ose zgjidhje, dhe bën ndonjë rregullim të nevojshëm;</i> ✓ <i>mbledh të dhëna të vlefshme duke përdorur saktë mjetet e zgjedhura dhe instrumentet;</i>

	✓ në një veprimtari teknologjike, <i>propozon një zgjidhje në lidhje me hulumtimet e tij</i> që plotëson pjesërisht nevojën e identifikuar ose specifikimet; ✓ propozon përgjigje apo zgjidhje që <i>në përgjithësi</i> pasqyrojnë rezultatet ose provat e tij.	✓ në një veprimtari shkencore, <i>kontrollon</i> nëse hipoteza është në përputhje me analizën e rezultateve; ✓ <i>siguron se zgjidhja që ka bërë plotëson</i> nevojat e identifikuara; ✓ propozon përgjigje ose zgjidhje që reflektojnë rezultatet e tij apo gjykimet e duhura; ✓ nëse është e nevojshme, <i>sugjeron përmirësime</i> për planin e tij të veprimit.
Kompetenca II : Përdorimi i mjeteve, objekteve dhe procedurave shkencore në biologji		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi studion ndikimet afatgjata të shkencës dhe të teknologjisë tek individët, shoqëria, mjedisi dhe ekonomia. Ai vendos shkencën dhe teknologjinë në kontekstet e tyre sociale dhe historike, si dhe studion ndikimin e tyre në mënyrën e jetesës së njerëzve. Nxënësi identifikon pyetje ose çështje etike që lidhen me klonimin, diseksionin e kafshëve, abortin etj.. Ai kupton si funksionojnë objektet teknike, tregon kuriozitet për to, shqyrton përbërjen dhe funksionimin e tyre dhe, nëse është e nevojshme, i zbërthen në pjesë, identifikon materialet, pjesët dhe tipat e ndryshëm të lidhjeve në objektet teknike, dallon sisteme dhe nënsisteme të ndryshme dhe shpjegon si funksionojnë ato. Nxënësi kupton dukuritë natyrore, pyet veten rreth mjedisit të tij, familjarizohet me konceptet që lidhen me dukuritë dhe pranon lidhjen e tyre. Ai përdor njohuritë biologjike për shpjegimin e dukurive ose zbatimin e koncepteve biologjike duke përdorur metodën e vëzhgimit, metodën eksperimentale si dhe modelimin. Nxënësi përdor aparatit matematikor për të mbështetur arsyetimin e tij dhe argumenton shpjegimet duke përdorur diagrama skematike.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ <i>formulon pyetje</i> që fokusohen kryesisht në <i>elemente dytësore të një çështjeje</i> ose dukurie biologjike;	Nxënësi: ✓ <i>formulon pyetje ose ofron një shpjegim paraprak</i>, zgjidhje apo mendim duke përcaktuar <i>disa nga</i>	Nxënësi: ✓ <i>propozon zgjidhje ose jep shpjegimin e tij për çështjen ose dukurinë biologjike</i> duke zbatuar



✓ propozon një shpjegim, zgjidhje apo mendim që është i pabazuar; ✓ përmend konceptet që lidhen me këtë çështje; ✓ emërton disa nga parimet e funksionimit të një objekt teknik, një sistemi teknologjik apo një produkti; ✓ jep vetëm fillimet e një shpjegimi apo zgjidhjeje.	<i>aspektet thelbësore të çështjes ose dukurisë biologjike;</i> ✓ përcakton funksionimin e përgjithshëm të një objekti teknik, një sistemi teknologjik apo një produkti; ✓ zbaton me korrektësi disa koncepte të kërkuara; ✓ ofron një përshkrim të shkurtër të parimeve të funksionimit të objektit teknik ose sistemit teknologjik; ✓ përdor aparatin matematikor, por bën gabime të vogla në proces; ✓ jep shpjegime të pjesshme ose propozon zgjidhje lidhur me këtë çështje; ✓ identifikon pasojat dytësore që kanë të bëjnë me çështjen e shqyrtuar.	parimet e njohura shkencore ose teknologjike; ✓ tregon se zotëron aftësinë për të zbatuar konceptet; ✓ sugjeron përmirësime që kanë të bëjnë me zgjedhjen e materialeve apo proceseve prodhuese të lidhur me objektin teknik apo teknologjik të sistemit; ✓ jep shpjegime, justifikon zgjidhjet e tij ose mbron mendimet e veta duke respektuar parimet themelore shkencore ose teknologjike; ✓ pasuron shpjegimet e tij duke përdorur aparatin matematikor; ✓ identifikon pasojat pozitive dhe negative në lidhje me çështjen e shqyrtuar.
--	--	--

Kompetenca III : Komunikimi i ideve biologjike duke përdorur gjuhën dhe terminologjinë e shkencës

Përshkrimi i kompetencës:

Nxënësi shkëmben informacione shkencore me të tjerët. Ai kupton rolin e ndarjes së informacionit dhe është i hapur në këndvështrimet e të tjerëve, krahason të dhënat dhe procedurat e tij me ato të të tjerëve dhe vlerëson këndvështrimin ose zgjidhjen e tij duke i krahasuar me ato të të tjerëve. Nxënësi përhap dhe zhvillon njohuritë ose rezultatet shkencore. Ai prezanton idetë që lidhen me konceptet të përgjithshme si : mjedisore, gjenetike, qelizore, shëndetsore, anatomike. Ai merr parasysh përbërjen e audiencës, përdor mënyra të ndryshme për prezantimin e informacionit (p.sh., simbolet, tabelat, vizatimet teknike) dhe përshtat mesazhin sipas tipit të medias që përdor (p.sh. prezantim me gojë ose me shkrim etj.). Nxënësi interpreton dhe formulon mesazhe shkencore. Ai përdor informacionin



shkencor dhe teknologjik të marrë nga burime të ndryshme duke u siguruar që burimet të jenë të besueshme dhe të përshtatshme. Ai prezanton informacionin sipas rregullave dhe konvencioneve të shkencës, teknologjisë dhe matematikës.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ jep një mesazh duke paraqitur elementet e tij, pa ia përshtatur atë audiencës së synuar; ✓ përdor fjalorin bazë ose mjetet e prezantimit që janë në masë të madhe në kundërshtim me rregullat dhe marrëveshjet.	Nxënësi: ✓ përzgjedh disa informacione në mesazh; ✓ përdor burime informacioni që mund të ndryshojnë besueshmërinë e tyre; ✓ organizon dhe përshtatet pjesërisht elementet e mesazhit të tij; ✓ prodhon një mesazh pa shkelur drejtat e pronësisë intelektuale; ✓ për koncepte më të thjeshta, përdor terminologji në përputhje me rregullat dhe marrëveshjet; ✓ përzgjedh dhe përdor mjete të pranueshme të prezantimit për të shfaqur të dhënat.	Nxënësi: ✓ përzgjedh elementet e duhur për përfundimin e detyrës; ✓ zgjedh dhe përdor burime të ndryshme dhe të besueshme të informacionit; ✓ organizon me korrektësi elementet e mesazhit të tij, e përshtat atë në audiencën e synuar dhe e përcjell në mënyrë të qartë; ✓ përdor terminologji në përputhje me rregullat e pranuar; ✓ përdor mjete të përshtatshme të prezantimit si dhe teknologjinë e informacionit dhe të komunikimit, sipas nevojës, për të paraqitur të dhëna në tabela, grafikë ose diagrama.

6.3 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “KIMI”

SHKALLA IV
Kompetenca I: Identifikimi dhe zgjidhja e problemeve kimike



Përshkrimi i kompetencës:

Nxënësi identifikon karakteristikat shkencore të problemit, thekson elementet që kanë lidhje me njeri-tjetrin dhe formulon problemin. Ai demonstroi aftësitë e tij për kërkimin e përgjigjeve ose zgjidhjen e problemeve kryesore kimike si dhe zbatimin e metodologjisë së duhur për zgjidhjen e problemeve praktike. Ai pranon për trajtimin e zgjidhjes së problemeve, në pjesën më të madhe, metodën eksperimentale, metodën e modelimit dhe vëzhgimit dhe në disa raste, metodën empirike.

Nxënësi zhvillon idetë që lidhen me konceptet e përgjithshme: të gjendjeve të lëndës, ndryshimet e energjisë në reaksione, shpejtësinë e reaksionit, shkrimin dhe zbatimin e formulave të njohura kimike. Ai përdor metodat, strategjitë apo teknikat e duhura, në lidhje me konceptet e analizës cilësore dhe sasiore, sipas kontekstit si dhe përdorimin e aparatit matematikor për të mbështetur arsyetimin e tij.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi : ✓ <i>bën supozime të cilat lidhen pak a shumë me problemin që do të zgjidhet;</i> ✓ <i>propozon një plan jo të plotë të veprimit duke identifikuar variabla që kanë pak ose aspak rëndësi;</i> ✓ <i>në punën e tij përshkruan disa nga hapat e kryer ose disa aspekte të zgjidhjes;</i> ✓ <i>paraqet rezultatet dhe propozon përgjigje apo zgjidhje pa kontrolluar nëse ato janë të lidhura me rezultatin apo problemin.</i>	Nxënësi : ✓ <i>identifikon elementet e problemit që duhet zgjidhur;</i> ✓ <i>formulon pyetje, shpjegime apo hipoteza që pasqyrojnë disa kufizime që lidhen me problemin;</i> ✓ <i>propozon një plan bazë veprimi që identifikon variablat që mund të ndikojnë në rezultat;</i> ✓ <i>punon në një mënyrë që tregon shqetësim për sigurinë e tij dhe të njerëzve të tjerë;</i> ✓ <i>paraqet disa nga informacionet e mbledhura dhe ndjek hapat e planifikuar për kryerjen e veprimtarisë;</i> ✓ <i>propozon përgjigje ose zgjidhje që</i>	Nxënësi : ✓ <i>zgjedh informacionin përkatës lidhur me problemin që duhet zgjidhur;</i> ✓ <i>formulon pyetje të besueshme, shpjegime apo hipoteza që pasqyrojnë kufizimet që lidhen me problemin dhe kushtet me të cilat duhet të zgjidhet;</i> ✓ <i>planifikon çdo hap në planin e tij / saj të veprimit, duke siguruar kontrollin e variablave që detyrimisht ndikojnë në rezultat;</i> ✓ <i>mbledh të dhëna të vlefshme duke përdorur saktë mjetet dhe instrumentet e përzgjedhura;</i> ✓ <i>merr parasysh gabimet lidhur me</i>



	<i>në përgjithësi pasqyrojnë rezultatet e tij ;</i> ✓ <i>përdor aparatën matematikore të nevojshëm , por bën gabime të vogla gjatë procesit (psh në konvertimin e njësive matëse);</i> ✓ <i>llogarit rezultatet pa sugjeruar ndonjë përmirësim.</i>	<i>matjet, kur mbledh të dhënat dhe merr në llogaritje shifrat e rëndësishme, kur paraqet rezultatet e tij ;</i> ✓ <i>krahason rezultatet e tij me vlerat teorike të pranuar, nëse është e nevojshme;</i> ✓ <i>kontrollon nëse hipoteza është në përputhje me analizën e rezultateve;</i> ✓ <i>përpunon rezultatet e tij dhe përdor aparatën matematikore të nevojshëm për të mbështetur arsyetimin e tij.</i>
Kompetenca II : “ Përdorimi i mjeteve, objekteve dhe procedurave shkencore në kimi”		
Përshkrimi i kompetencës:Nxënësi përdor njohuritë kimike për shpjegimin e dukurive ose zbatimin e koncepteve kimike duke përdorur metodën e vëzhgimit , metodën eksperimentale si dhe modelimin. Ai përdor strategji të ndryshme për të zgjidhur problemet që ndeshen si në raste studimore, debate, projekte kurrikulare etj. Nxënësi paraqet një qëndrim reflektues, analizon të dhënat dhe informacionin në mënyrë që të zhvillojë aftësitë e tij njohëse në situata gjithnjë e më të ndërlikuara. Nxënësi identifikon elementet shkencore (konceptet, ligjet, modelet, teoritë, parimet) të problemit. Nxënësi zhvillon idetë që lidhen me konceptet e përgjithshme: të gjendjeve të lëndës, ndryshimet e energjisë në reaksione, shpejtësinë e reaksionit, shkrimin dhe zbatimin e formulave të njohura kimike. Ai përdor metodat, strategjitë apo teknikat e duhura, në lidhje me konceptet e analizës cilësore dhe sasiore, sipas kontekstit si dhe përdorimin e aparatit matematikor për të mbështetur arsyetimin e tij , argumenton shpjegimet e tij duke përdorur figura të rëndësishme.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi : ✓ <i>formulon pyetje që fokusohen</i>	Nxënësi :	Nxënësi : ✓ <i>formulon pyetje ose jep shpjegime</i>



kryesisht në <i>elemente dytësore</i>; ✓ <i>propozon</i> një shpjegim paraprak që është i <i>pabazuar</i>; ✓ <i>përmend konceptet</i> bazë kimike që lidhen me fenomenin apo zbatimin e tij; ✓ <i>jep vetëm</i> fillimet e një shpjegimi shkencor.	✓ <i>formulon</i> pyetje ose jep shpjegime paraprake, <i>përcakton</i> disa aspekte thelbësore të fenomenit apo zbatimit të tij; ✓ <i>zbaton</i> drejt <i>disa</i> koncepte bazë kimike në mënyrën e duhur; ✓ <i>përdor</i> aparatin matematikor, por <i>bën gabime të vogla</i> në procesin (psh në konvertimin e njësive matëse, ose në lidhje me figura të rëndësishme); ✓ <i>jep</i> shpjegime të <i>pjeshme</i> lidhur me fenomenin apo zbatimin e tij.	paraprake për përcaktimin e aspekteve thelbësore të fenomenit apo zbatimit të tij; ✓ <i>zhvillon</i> qasjet e tij për zgjidhjen e problemeve duke u mbështetur në parimet përkatëse shkencore ose teknologjike; ✓ <i>zbaton</i> drejtë konceptet bazë kimike në mënyrën e duhur; ✓ <i>përdor</i> aparatin matematikor, kur e kërkon situata; ✓ <i>jep sqarimet e duhura</i>, duke përdorur, ndonjëherë në mënyrë implicite, konceptet, ligjet, teoritë dhe modelet kimike; ✓ <i>argumenton shpjegimet</i> e tij me të dhënat e shprehura duke përdorur figura të rëndësishme, kur është e nevojshme, të marrin parasysh paqartësitë lidhur me të.
---	---	--

Kompetenca III : Komunikimi i ideve kimike duke përdorur gjuhën dhe terminologjinë e shkencës

Përshkrimi i kompetencës:

Nxënësi shkëmben informacione shkencore me të tjerët. Ai merr parasysh përbërjen e audiencës, përdor mënyra të ndryshme për prezantimin e informacionit dhe përshtat mesazhin e tij, duke përdorur terma shkencore dhe teknologjike, me gojë ose me shkrim, si dhe bën lidhjen midis koncepteve kimike dhe paraqitjes së tyre në mënyrë grafike ose simbolike. Nxënësi prezanton idetë që lidhen me konceptet e përgjithshme kimike. Ai përdor metodat, strategjitë apo teknikat e duhura, në lidhje me konceptet e analizës cilësore



dhe sasiore, sipas kontekstit. Ai përdor informacionin shkencor dhe teknologjik të marrë nga burime të ndryshme duke vërtetuar burimet e informacionit .

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI III
Nxënësi : ✓ jep një mesazh duke paraqitur elementet e tij, pa ia përshtatur atë audiences së synuar; ✓ përdor fjalorin bazë ose mjetet e prezantimit që janë në masë të madhe në kundërshtim me rregullat dhe marrveshjet.	Nxënësi : ✓ përzgjedh disa informacione në mesazh; ✓ përdor burimet e informacionit që mund të ndryshojnë besueshmërinë e tyre; ✓ organizon dhe përshtat pjesërisht elementet e mesazhit të tij ; ✓ jep një mesazh pa shkelur të drejtat e pronësisë intelektuale; ✓ për të koncepteve të thjeshta, përdor terminologjinë në përputhje me rregullat dhe marrëveshjet; ✓ përzgjedh dhe përdor mjetet e pranueshme të prezantimit për të shfaqur të dhënat.	Nxënësi : ✓ përzgjedh elementet e duhura për përfundimin e detyrës; ✓ përzgjedh dhe përdor burime të ndryshme dhe të besueshme të informacionit; ✓ organizon me korrektësi elementet e mesazhit të tij , e përshtat atë me audiencën e synuar dhe përcjell në mënyrë të qartë; ✓ përdor terminologjinë në përputhje me rregullat dhe marrëveshjet e pranuar; ✓ përzgjedh dhe përdor mjetet e duhura të prezantimit, duke u bazuar në teknologjinë e informacionit dhe komunikimit, sipas nevojës, për të paraqitur të dhënat në tabela, grafikë ose diagrama.





Nxënësi: a. identifikon ngjashmëri dhe ndryshime në mënyrën se si individë dhe grupe të ndryshme plotësojnë nevojat dhe interesat e tyre; b. dallon faktin që njerëz të ndryshëm kanë pikëpamje të ndryshme për probleme dhe dukuri të ndryshme shoqërore; c. dallon raste të ndikimit të gjuhës, të traditave dhe të sjelljeve në zhvillimin e kulturës; d. dallon elemente të lidhjeve ndërmjet reagimeve të ndryshme të individëve dhe të grupeve ndaj mjediseve shoqërore ose ndryshimeve dhe pikëpamjeve, vlerave dhe bindjeve të tyre; e. dallon raste të ndikimit dhe bashkëveprimit të njerëzve me	Nxënësi: a. identifikon ngjashmëritë dhe ndryshimet në mënyrën se si grupet, shoqëritë dhe kulturat plotësojnë nevojat dhe interesat e tyre; b. dallon këndvështrimet e ndryshme të njerëzve me prejardhje të ndryshme kulturore për probleme dhe dukuri të ndryshme shoqërore; c. dallon dhe jep shembuj të ndikimit të gjuhës, letërsisë, arteve, traditave, bindjeve, vlerave dhe sjelljeve në zhvillimin dhe tejçimin e kulturës; d. përshkruan reagimet e ndryshme të individëve dhe të grupeve ndaj mjediseve shoqërore ose fizike dhe ndaj ndryshimeve mbi bazën e pikëpamjeve, vlerave dhe bindjeve të tyre;	Nxënësi: a. krahason ngjashmëritë dhe ndryshimet në mënyrën se si grupet, shoqëritë dhe kulturat plotësojnë nevojat dhe interesat e tyre; b. shpjegon se si njerëzit me prejardhje të ndryshme kulturore, me këndvështrime dhe pikënisje të ndryshme interpretojnë informacionet dhe përvojat; c. shpjegon dhe jep shembuj për mënyrën e ndikimit të gjuhës, letërsisë, arteve, traditave, bindjeve, vlerave dhe sjelljeve në zhvillimin dhe tejçimin e kulturës; d. shpjegon pse individët dhe grupet reagojnë në mënyra të ndryshme ndaj mjediseve shoqërore ose fizike dhe ndaj ndryshimeve mbi bazën e pikëpamjeve, vlerave dhe bindjeve të tyre; e. përshkruan ndikimin dhe bashkëveprimin e diversitetit kulturor si dhe të kohezionit social brenda dhe ndërmjet grupeve.
--	--	--



prejardhje të ndryshme kulturore brenda dhe ndërmjet grupeve.	e. krahason raste të ndikimit dhe bashkëveprimit të diversitetit kulturor brenda dhe ndërmjet grupeve.	
TEMATIKA: KOHA, VAZHDIMËSIA, NDRYSHIMI		
Përshkrimi i kompetencës në lidhje me këtë tematikë: Në fund të klasës VII, nxënësi duhet të jetë i aftë të demonstrojë të kuptuarit e faktit që njerëz të ndryshëm mund të përshkruajnë të njëjtën ngjarje ose situatë në mënyra të ndryshme, si dhe të citojnë arsyet për ndryshimet që kanë në pikëpamje; të demonstrojë aftësi për të përdorur një fjalor korrekt që shoqërohet me konceptin kohë si: e shkuar, e tashme, e ardhme, dhe njëherë e një kohë; të lexojë dhe të ndërtojë planifikime të thjeshta kohore; të identifikojë shembuj të marrëdhënieve shkak pasojë nga jeta e përditshme; të krahasojë dhe të dallojë ndryshimet ndërmjet shpjegimeve për ngjarje, njerëz, vende ose situata të shkuara duke nxjerrë në pah se si ato kanë kontribuar për të kuptuarin e së kaluarës; të identifikojë dhe të përdorë burime të ndryshme për të kuptuar dhe rindërtuar të kaluarën si dokumente, letra, ditar, harta, libra, fotografi etj.; të demonstrojë të kuptuarit e faktit që njerëzit në kohë dhe në vende të ndryshme e shikojnë botën në mënyra dhe pamje të ndryshme; të përdorin njohuritë për fakte ose koncepte të marra nga historia, bashkë me elementët e hulumtimit historik, për të folur për vendimmarrjet dhe veprimet e ndërmarra lidhur me çështjet publike në zonën ku jeton.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV



Nxënësi: a. dallon raste ose shembuj të këndvështrimit të ndryshme të të njëjtave ngjarje; b. dallon elementë të lidhjes ndërmjet ndryshimit dhe vazhdimësisë dhe të marrëdhënieve shkak pasojë nga historia dhe jeta e përditshme; c. dallon periudha të caktuara historike dhe elemente të ndryshme të ndryshimit që ekziston ndërmjet tyre; d. rindërton elemente të veçantë të historisë duke përdorur të dhëna ose	Nxënësi: a. përshkruan shembuj të përshkrimit të të njëjtave ngjarje ose situata nga njerëz të ndryshëm nga këndvështrime të ndryshme; b. përshkruan lidhjet ndërmjet ndryshimit dhe vazhdimësisë duke përdorur konceptet kyç si kronologjia, rastësia, ndryshimi, konflikti dhe kompleksiteti; c. përshkruan periudha të caktuara të ndryshimit brenda dhe ndërmjet kulturave, të tilla si rritja e qytetërimit, zhvillimi i sistemeve politike, ekonomike etj; d. përdor burime të ndryshme për të rindërtuar dhe për të riinterpretuar të kaluarën. verifikon besueshmërinë e burimeve të përdorura;	Nxënësi: a. shpjegon dhe argumenton me shembuj dhe fakte pse njerëz të ndryshëm mund të përshkruajnë të njëjtat ngjarje ose situata në mënyra të ndryshme; b. shpjegon dhe analizon lidhjet ndërmjet ndryshimit dhe vazhdimësisë dhe përdor konceptet kyç si kronologjia, rastësia, ndryshimi, konflikti dhe kompleksiteti për të shpjeguar, analizuar dhe treguar lidhjet midis ndryshimit dhe vazhdimësisë; c. përshkruan <i>periudha</i> të caktuara historike dhe <i>modele</i> të ndryshimit brenda dhe ndërmjet kulturave, të tilla si zhvillimi i kulturave, zhvillimi i sistemeve politike, ekonomike të transportit, komunikimit etj.; d. përdor sistematikisht metodat e vështirimit kritik të historisë e burime të ndryshme për të rindërtuar dhe për të riinterpretuar të kaluarën dhe verifikon vazhdimisht besueshmërinë dhe vlerën e burimeve të përdorura;
---	--	--



burime të shkëputura dhe jo të rëndësishme. nuk bën përpjekje për të verifikuar besueshmërinë ose vlerën e tyre; e. shpreh lehtësisht qëndrimin e tij (simpatinë dhe antipatinë) e tij për qëndrimet, vlerat dhe sjelljet e njerëzve të marrë jashtë konteksteve të ndryshme historike dhe jashtë shikimit kritik; f. merr vendime individuale mbi bazën e gjykimeve të shpejtuara të elementëve të veçanta ose të shkëputura të realitetit.	e. mban qëndrime të caktuara si simpatia ose dyshimi për qëndrimet, vlerat, dhe sjelljet e njerëzve në kontekste të ndryshme historike; f. përdor njohjen e fakteve të caktuara për vendimmarrje dhe pjesëmarrje në veprime konkrete.	e. mbron dhe zhvillon qëndrime ndjenja kritike të tilla si simpatia ose dyshimi lidhur me qëndrimet, vlerat, dhe sjelljet e njerëzve në kontekste të ndryshme historike; f. përdor njohjen e fakteve dhe të koncepteve të nxjerra nga historia për vendimmarrje dhe pjesëmarrje në veprime konkrete për çështjet publike.
--	---	---

TEMATIKA: NJERËZ, VENDE, MJEDISE

Përshkrimi i kompetencës në lidhje me këtë tematikë:

Në fund të klasës VII, nxënësi duhet të jetë i aftë të ndërtojë dhe të përdorë një hartë mendore të zonës ku jeton (fshat-qytet, komunë, bashki,) të vendeve fqinjë, të botës në tërësi, duke demonstruar të kuptuarin e karakterit relativ të madhësisë etj. ; të dallojë, të përdorë dhe të interpretojë përgjegjësitë që kanë njerëzit ndaj mjedisit përreth si dhe ndryshimeve në botë, duke pasur parasysh njohjen e hartave, globit, si dhe fotografive të ndryshme; të përdorë burime të përshtatshme, burime të dhënash, mjete gjeografike si atlase, baza të dhënash, sisteme të koordinatave, grafikë, harta që të gjenerojë, të përpunojë dhe të interpretojë informacionin e marrë; të vlerësojë dhe të llogaritë shkallëzimet e distancat e ndryshme në mjedisin ku jeton; të përcaktojë dhe të dallojë përmes formave të ndryshme dhe skicimeve gjeografike malet, fushat, ishujt dhe oqeanet, për të cilat ai ka marrë informacion dhe nga rrugë të tjera jashtë procesit mësimor; të përshkruajë dhe të shpjegojë ndryshimet e sistemit fizik që ka lidhje me stinët, klimën, motin dhe ciklin e ujit. të përshkruajë se si njerëzit krijojnë vendet e tyre të banimit, si ata reflektojnë idetë e tyre, si krijojnë



kulturën, personalitetin, si shprehin dëshirat dhe prezantojnë nevojat që ata kanë si shtëpi, shkollë etj.; të shqyrtojë ndërveprimin e genieve njerëzore dhe mjediseve të tyre fizike si përdorimi i tokës, ndërtimi i qyteteve, ndryshimet në ekosisteme që lidhen me përzgjedhjen e zonave dhe rajoneve të banimit; të vëzhgojë dhe të shpjegojë rreth rezultateve sociale dhe ekonomike të ndryshimeve mjedisore dhe krizave të ndryshme që rezultojnë nga fenomene të tilla si përmytje, thatësira, stuhi etj. ; të eksplorojë rrugët dhe veçoritë e botës fizike, duke shpjeguar se si ato kanë ndryshuar në kohë në zonën ku ata jetojnë e më gjerë dhe, si këto ndryshime në kohë, mund të jenë lidhur me njëra-tjetrën.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: a. dallon tipare të veçanta të mjedisit në nivel lokal dhe rajonal; b. identifikon ndryshime në zakonet e banorëve që jetojnë në një mjedis të caktuar; c. identifikon lidhje që ekzistojnë ndërmjet idealeve të njerëzve dhe mënyrës së ndërtimit të vendeve ku banojnë etj.; d. dallon raste të bashkëveprimit ndërmjet traditave fizike dhe kulturore si përdorimi i tokës, transmetimi i ideve, ndryshimet e ekosistemit etj.; e. dallon raste të ndikimit të ngjarjeve të caktuara dhe të faktorëve fizikë në	Nxënësi: a. përshkruan tiparet e mjediseve në nivel lokal dhe rajonal; b. përshkruan lidhjet që ekzistojnë ndërmjet ndryshimeve në mjedis dhe zakoneve të banorëve që jetojnë në të; c. përshkruan se si njerëzit krijojnë vende (vende banimi, parqe etj.) që pasqyrojnë vlerat dhe idealet e tyre kulturore; d. shqyrton bashkëveprimin ndërmjet traditave fizike dhe kulturore si përdorimi i tokës, transmetimi i ideve, ndryshimet e ekosistemit etj.;	Nxënësi: a. shpjegon marrëdhëniet ndërmjet tipareve të mjedisit në nivel lokal dhe rajonal; b. shpjegon marrëdhëniet ndërmjet ndryshimeve në mjedis dhe zakoneve të banorëve që jetojnë në të; c. shpjegon lidhjet që ekzistojnë ndërmjet mënyrës së ndërtimit të qendrave të banuara, të biznesit etj. dhe vlerave dhe idealeve kulturore të njerëzve që i ndërtojnë ato; d. analizon dhe interpreton bashkëveprimin ndërmjet traditave fizike dhe kulturore si përdorimi i tokës, transmetimi i ideve, ndryshimet e ekosistemit etj.;



zhvillimin e komunitetit ose të vendit ku jeton; f. shpreh mendimin e tij për pasoja të veçanta që sjellin ndryshime të caktuara mjedisore si stuhitë, thatësira, përmytjes etj.; g. flet për lidhjet ndërmjet njeriut dhe mjedisit, duke u mbështetur në burime të tilla si fotografi, gazeta etj.; h. jep mendimin e tij për mënyrën e përdorimit të burimeve të caktuara natyrore në bashkësinë ku jeton .	e. përkshkruan ndikimin e ngjarjeve historike dhe faktorët fizikë në zhvillimin lokal dhe kombëtar; f. diskuton rreth pasojave sociale dhe ekonomike të ndryshimeve mjedisore dhe të dukurive që burojnë prej tyre si stuhi, thatësira, përmytje etj.; g. përkshkruan bashkëveprimin e njeriut me mjedisin, duke përdorur burime të vlefshme dhe mjete të tilla si fotografi, harta, libra, gazeta, etj.; h. propozon alternativa të përdorimit të burimeve natyrore në bashkësinë ku jeton dhe më gjerë.	e. shpjegon ndikimin e ngjarjeve historike dhe faktorëve fizikë në zhvillimin lokal, kombëtar dhe global; f. debaton me argumente rreth pasojave sociale dhe ekonomike të ndryshimeve mjedisore dhe të dukurive që burojnë prej tyre si stuhitë, thatësira, përmytjet etj.; g. bën përgjithësime dhe interpreton, bashkëveprimin e njerëzve me vendet dhe mjedisin, duke përdorur burime dhe mjete të vlefshme; h. vlerëson dhe propozon alternativa të përdorimit të burimeve natyrore në bashkësinë ku jeton dhe më gjerë.
--	---	--

TEMATIKA: ZHVILLIMI INDIVIDUAL DHE IDENTITETI

Përkshkrimi i kompetencës në lidhje me këtë tematikë:

Në fund të klasës VII, nxënësi duhet të jetë i aftë të dallojë ndryshimet personale në kohë, të tilla që kanë lidhje me zhvillimin fizik dhe interesat vetjake, personale; të dallojë lidhjet personale të vendit ku jeton, ose të vendit të preferuar të tij, duke i shoqëruar drejtpërdrejt me mjedisin rrethues; të dallojë veçoritë e përbashkëta të një familje-bërthamë dhe të një familjeje të zgjeruar; të prezantojë të nxënit dhe zhvillimin fizik të tij, si dhe sjelljet e të vepruarit personal. të identifikojë dhe të dallojë rrugët e krijimit të familjeve, të grupeve, si dhe influencat e komunitetit në jetën ditore individuale dhe zgjedhjet personale të njerëzve; të eksplorojë



faktorët që kontribuojë drejt krijimit të një identiteti personal përmes interesave, kapaciteteve dhe perceptimeve vetjake; të analizojë një ngjarje të hollësishme përmes identifikimit të arsyetimeve individuale, duke iu përgjigjur kësaj situatë në rrugë të ndryshme; të punojë i pavarur dhe bashkërisht në grupe për realizimin e qëllimeve të vëna

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: a. formon një album fotografik me fotot më përfaqësuese të tij dhe familjes dhe vendos për çdo fotografi nga një diçiturë ose koment; b. liston në dy kategori dëshirat dhe nevojat personale; c. shpreh ose mbështet mendimin e shokëve, të pjesëtarëve të familjes për një çështje të caktuar; d. komenton elementët e një pasaporte si dokument që identifikon individin.	Nxënësi: a. krahason moshatarët e tij të cilët shfaqen me individualitete dhe identitete të ndryshme; b. dallon identitetin nga individualiteti dhe liston faktorët që përcaktojnë individualitetin e individit; c. prezanton veten (në mjedise të caktuara) si individ i caktuar me individualitet dhe identitet; d. komenton në mënyrë të pavarur një ngjarje apo fakt të jetës së tij personale.	Nxënësi: a. evidenton dhe krahason ndryshimet personale në një hark kohor të caktuar dhe brenda një konteksti social, kulturor ekonomik; b. argumenton ndikimet e grupit(ve) sociale (familje - shkollë) në zhvillimin e tij individual; c. krahason ndikimet që vijnë nga mjedisi i jashtëm në shkollë, me ndikimet që këto institucione kanë tek individë të tjerë; d. formulon një ese për veten titulluar “kush jam unë” ose “ky jam unë”.
TEMATIKA: INDIVIDËT, GRUPET, INSTITUCIONET		
Përshkrimi i kompetencës në lidhje me këtë tematikë:		



Në fund të klasës VII, nxënësi duhet të jetë i aftë të identifikojë rolet si shembull i sjelljeve të të nxënësve të tij në situatat e grupit: si nxënës, anëtar familje, anëtar i barabartë i grupit në një lojë, ose anëtar i klubeve të ndryshme shkollë; të japë shembuj të grupeve dhe të shpjegojë ndikimet institucionale si ligjet, rregullat si dhe ndikimet e moshatarëve te njerëzit, ngjarjet dhe elementët kulturorë p.sh rregullat e klasës, të shkollës, të komunitetit; të thotë emra të institucioneve të ndryshme, si dhe të dallojë ndërveprimet e njerëzve me to si shkolla, familja, komuniteti, pushtetin vendor dhe ai qendror; të identifikojë dhe të shqyrtojë shembuj të acarimit midis grupeve, individëve, ose institucioneve, të cilat i përkasin më shumë një grupi që mund të shkaktojë një konflikt të brendshëm; të identifikojë dhe të shqyrtojë shembuj të acarimit ndërmjet besimit individual dhe ligjeve, rregullave dhe praktikave qeverisëse në shkollë, familje dhe komunitet. të japë shembuj të rolit të institucioneve (shkollë, familje, komunitet, pushtet lokal) në përkrahjen që ata i japin të dy çështjeve: vazhdimësisë dhe ndryshimit. të prezantojë grupe dhe institucione që punojnë për plotësimin e nevojave individuale, si dhe për sigurimin e të mirave të përbashkëta, duke identifikuar edhe shembuj për rastet kur këto grupe dhe institucione nuk punojnë në këtë drejtim.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: a. liston grupet sociale në të cilat bën apo dëshiron të bëjë pjesë dhe veçon rolin që ai/ajo luan më mirë; b. dallon nevojat që i përmbush secili grup social si dhe dëshirat që i përmbush secili; c. demonstron nevojën dhe gatishmërinë për të qenë anëtar i një grupi të caktuar;	Nxënësi: a. dallon dhe krahason konceptet “rol social” “status social” “grup social”; b. përshkruan si grupi social plotëson nevojat e individit dhe cilat nevoja konkretisht plotëson; c. pranon dhe stimulon përfshirjen e pjesëtarëve të rinj në grupin (et) social (e) ku ai bën pjesë;	Nxënësi: a. përshkruan “rolin” e tij social (detyrat dhe përgjegjësitë) brenda një grupi të caktuar (familje, klasë, grup shoqëror); b. evidenton “statusin e tij social” dhe përshkruan elementët përbërës të këtij statusi; c. analizon rastet kur individë dhe grupe me interesa të kundërta vendosin marrëdhënie midis tyre në rrethana të caktuara; d. analizon me shembuj, raste kur marrëdhëniet ndërmjet grupeve të



d. pranon rregullat e grupit social ku bën pjesë; e. dallon prirje të anëtarëve të grupit për të sunduar grupin.	d. vlerëson dhe respekton vendimet e grupit ku bën pjesë; e. zbulon prirjet e anëtarëve të tjerë të grupit për të sunduar vetë grupin.	ndryshme bëhen në emër të së “mirës së përbashkët”; e. negocion marrëdhëniet ndërmjet anëtarëve të një grupi social, kur rrezikohet ekuilibri i anëtarëve të grupit.
TEMATIKA: PUSHTETI, AUTORITETI, QEVERISJA		
Përshkrimi i kompetencës në lidhje me këtë tematikë: Në fund të klasës VII, nxënësi duhet të jetë i aftë : të prezantojë të drejtat dhe përgjegjësitë individuale në lidhje me grupin e tij social si familja, grup i barabartë, klasë, shkollë; të shpjegojë thjeshtë qëllimet më kryesore të qeverisjes vendore dhe asaj shtetërore; të japë shembuj se si qeveria punon për të siguruar, ose jo, nevojat dhe dëshirat e njerëzve, se si krijon rendin dhe sigurinë, si dhe menaxhon konfliktet; të shpjegojë se si grupet dhe organizatat duhet të nxitin unitetin dhe e trajtojnë diversitetin duke mbajtur marrëdhënie miqësore, që bën të mundur sigurimin e rendit dhe qetësisë; të dallojë ndërmjet tyre qeverisjen vendore dhe atë shtetërore, si dhe qeverinë (në nivel kombëtar), si dhe të identifikojë drejtuesit-përgjegjës të këtyre niveleve si kryetar bashkie, kryeministër dhe president; të identifikojë dhe të dallojë faktorët që kontribuojnë për bashkëpunimin, si dhe shkaqet që krijojnë debate dhe kundërshti brenda ose në mes grupeve të ndryshme; të eksplorojnë rolin e teknologjisë në komunikim, në transport, në proceset e informacionit, në përdorimin e armëve ose të tjera fusha, që ndihmojnë ose kontribuojnë në zgjidhjen e konflikteve; të shpjegojë dhe të japë shembuj të konflikteve ndërmjet dëshirave dhe nevojave individuale dhe të grupeve, si dhe koncepteve të tilla si drejtësi, paanësi, ndershmëri.		
NIVELI III	NIVELI III	NIVELI IV



Nxënësi: a. identifikon emrat e udhëheqësve lokalë si kryetar i bashkisë, kryetar i qarkut etj.; b. veçon institucionet lokale që plotësojnë dëshirat e qytetarëve dhe institucionet që plotësojnë nevojat e tyre; c. rendit institucionet që garantojnë: rendin, shëndetin, arsimin, punësimin etj.; d. rendit kategoritë shoqërore që përfitojnë mbështetje financiare dhe sociale nga qeverisja lokale; e. dallon elemente pushteti dhe autoriteti në marrëdhëniet në shkollë.	Nxënësi: a. formulon pyetje që lidhen me mbarëvajtjen ose jo të qeverisjes lokale; b. identifikon debatet e ndryshme në medien rreth çështjeve të mënyrës si funksionon qeverisja; c. analizon qeverisjen në nivelin e shkollës dhe, komenton mënyrën si funksionon “qeveria “ e nxënësve në shkollë; d. vepron shpejt dhe natyrshëm me pyetësorë të cilët sigurojnë. informacion për aspekte të ndryshme të qeverisjes lokale; e. dallon pushtetin nga autoriteti në shembuj të dhënë.	Nxënësi: a. shqyrton rolin (rolet) dhe rrugën (t) përmes të cilës individ merr pjesë në qeverisjen lokale dhe kombëtare; b. argumenton në çdo rast nevojën për qeverisje lokale dhe kombëtare; c. interpretton skemën e qeverisjes lokale (institucionet që lidhen me arsimin) dhe kombëtare; d. formulon qëndrime individuale ose në grup (thirrje-peticione) ndaj qeverisjes lokale; e. shpjegon me shembuj konkretë dallimin ndërmjet “pushtetit” dhe “autoritetit”.
TEMATIKA: PRODHIMI, SHPËRNDARJA, KONSUMI		
Përshkrimi i kompetencës në lidhje me këtë tematikë:		



Në fund të klasës VII, nxënësi duhet të jetë i aftë: të tregojë me shembuj se pamjaftueshmëria e burimeve dhe zgjidhjet që bëhen mbi bazën e saj luajnë rolin kryesor në vendimmarrjet në fushën ekonomike; të bëjë dallimin ndërmjet nevojave dhe dëshirave; të japë shembuj të të mirave dhe shërbimeve që ofrohen në sektorin privat dhe atë publik; të japë shembuj të institucioneve të ndryshme që përbëjnë sistemet ekonomike si familja, punëtorët, bankat, institucionet qeveritare, biznesi i vogël dhe i madh etj.; të përshkruajë varësinë e shoqërisë nga ndarja e punës dhe nga specializimet e domosdoshme për secilën punë si dhe ndihmesën që japin ato për prodhimin dhe shkëmbimin e të mirave dhe shërbimeve; të përshkruajë ndikimin e vlerave, traditave dhe zakoneve në marrjen e vendimeve ekonomike; të përshkruajë marrëdhëniet ndërmjet çmimit, kërkesës dhe ofertës; të përdorë koncepte ekonomike si kërkesa, oferta, çmimi për të shpjeguar dukuri të ndryshme në komunitetin ku jeton etj.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: a. liston jo më pak se tre nga institucionet ekonomike lokale private dhe publike; b. dallon elemente të thjeshta të prodhimit ; c. dallon elemente prodhimi që gjenden në bashkësinë ku jeton; d. përkufizon dhe dallon konceptin “eksport” nga “import”;	Nxënësi: a. përkufizon termat dhe konceptet si: kërkesë/ofertë/ çmimi i prodhimit/ tregu i prodhimit; b. përshkruan elemente të prodhimit; c. identifikon burimet natyrore lokale që janë bazë për zhvillimin ekonomik lokal; d. sjell shembuj dhe liston produkte të cilat eksportohen dhe produkte të cilat importohen; e. përshkruan si (në çfarë mënyre) tradita ndikon në procesin e prodhimit;	Nxënësi: a. përshkruan “sistemet ekonomike” që vijnë nga institucione sociale si p.sh. ekonomia familjare prodhimi i vogël artizanal, deri tek firmat, korporatat, bankat e tjerë; b. përshkruan si realizohet lidhja ndërmjet elementeve të prodhimit; c. përshkruan rëndësinë e burimeve natyrore për zhvillimin ekonomik të vendit; d. shpjegon rëndësinë që ka eksporti dhe importi për ekonominë e një vendi; e. sugjeron veprimtari ekonomike që bazohen në traditën e vendit etj.;



Faqe**74** nga **154**



b. dallon raste të ndikimit të shkencës dhe teknologjisë në ndryshimin e perceptimeve të njerëzve për jetën e tyre ekonomike dhe shoqërore dhe marrëdhëniet me natyrën; c. dallon raste të veçanta të ndikimit të zbulimeve të reja shkencore dhe teknologjike, si shpikja e shtypit, konceptimi i gjithësisë, zbatimi i energjisë atomike dhe zbulimet gjenetike në vlerat dhe besimet e tyre; d. tregon ose flet për raste të nevojës së ligjeve për të qeverisur zbatimet shkencore dhe teknologjike të tilla si siguria dhe mirëqenia e punëtorëve dhe konsumatorëve, rregullimi i gjërave të dobishme si radioja, televizioni etj.	b. përshkruan me shembuj se si shkenca dhe teknologjia kanë ndryshuar perceptimet e njerëzve për botën natyrore dhe shoqërore, për marrëdhëniet e tyre me tokën, për jetën e kafshëve, për jetën familjare, nevojat ekonomike dhe sigurinë; c. përshkruan ndikimin e zbulimeve të reja shkencore dhe teknologjike, si shpikja e shtypit, konceptimi i gjithësisë, zbatimi i energjisë atomike dhe zbulimet gjenetike në vlerat dhe besimet e tyre; d. përshkruan me shembuj nevojën e ligjeve dhe të politikës për të qeverisur zbatimet shkencore dhe teknologjike të tilla si siguria dhe mirëqenia e punëtorëve dhe konsumatorëve, rregullimi i gjërave të dobishme si radioja, televizioni etj.	b. analizon, duke përdorur shembuj se si shkenca dhe teknologjia kanë ndryshuar perceptimet e njerëzve për botën natyrore dhe shoqërore, për marrëdhëniet e tyre me tokën, për jetën e kafshëve, për jetën familjare, nevojat ekonomike dhe sigurinë; c. analizon ndikimin e zbulimeve të reja shkencore dhe teknologjike, si shpikja e shtypit, konceptimi i gjithësisë, zbatimi i energjisë atomike dhe zbulimet gjenetike në vlerat dhe besimet e tyre; d. shpjegon nevojën për ligje dhe politika për të qeverisur zbatimet shkencore dhe teknologjike të tilla si siguria dhe mirëqenia e punëtorëve dhe konsumatorëve, rregullimi i gjërave të dobishme si radioja, televizioni etj.
--	---	--

TEMATIKA: LIDHJET GLOBALE



Përshkrimi i kompetencës në lidhje me këtë tematikë:

Në fund të klasës VII, nxënësi duhet të jetë i aftë të tregojë se elementë kulturorë si gjuha, arti, muzika, besimet etj. mund të lehtësojnë ose pengojnë mirëkuptimin global; të japë shembuj të bashkëpunimeve, ndërvarësisë ose konflikteve ndërmjet individëve, grupeve dhe kombeve; të shqyrtojë ndikimin e ndryshimeve teknologjike në komunitetin global; të zbulojë shkaqe, pasojat dhe zgjidhje të mundshme të disa prej problemeve bashkëkohore, të trashëgueshme ose të reja si ndotja ose speciet në rrezik; të shqyrtojë marrëdhëniet dhe kontradiktat ndërmjet nevojave, dëshirave dhe shqetësimeve të ndryshme globale si për shembull përdorimi i naftës së importuar dhe mbrojtjes së mjedisit; të shqyrtojë çështje, shqetësime, standarde ose konflikte që lidhen me të drejtat e njeriut, si trajtimi i fëmijëve, ndikimet e luftërave etj.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: a. dallon raste ose elemente të veçanta kulturore që kanë luajtur dhe luajnë rol në mirëkuptimin ose jo në nivel kombëtar ose global; b. përmend shembuj bashkëpunimi ose konfliktesh ndërmjet individëve, grupeve ose kombeve;	Nxënësi: a. përshkruan ndikimin e elementëve të veçantë kulturorë (gjuha, besimet, arti etj.) në rritjen ose jo të mirëkuptimit global; b. identifikon dhe përshkruan shembuj bashkëpunimi ose konfliktesh ndërmjet individëve, grupeve ose kombeve; c. përshkruan ndikimin e ndryshimeve teknologjike në komunitetin global;	Nxënësi: a. shpjegon me shembuj ndikimin e kulturës në rritjen ose jo të mirëkuptimit global; b. analizon shembuj bashkëpunimi, ndërvarësie ose konfliktesh ndërmjet individëve, grupeve ose kombeve;



c. dallon raste e shembuj të ndikimit të teknologjisë në komunitetin global; d. identifikon disa prej problemeve bashkëkohore ose të trashëguara për shembull në fushën e shëndetit, e mjedisit, e shpërndarjes së të ardhurave etj., dhe disa prej pasojave të tyre; e. dallon probleme të veçanta që lindin nga marrëdhëniet ndërmjet kombit me vendet e tjera lidhur me çështje të tilla si territori, burimet natyrore, tregtia, përdorimi i teknologjisë, mirëqenia e popujve etj.; f. identifikon çështje të njohura globale si të drejtat e njeriut, mjedisin, paqen etj.; g. përmend organizmat kryesore ndërkombëtare dhe të organizatave ndërshtetërore.	d. përshkruan disa prej problemeve bashkëkohore, të trashëgueshme ose të reja si shëndeti, sigurimi, shpërndarja e burimeve, zhvillimet ekonomike dhe cilësia e mjedisit si dhe disa prej pasojave të tyre; e. përshkruan disa prej rrjedhëve pozitive ose negative të marrëdhënieve ose kontradiktave të vendit me komunitetin ndërkombëtar, lidhur me çështje të tilla si territori, burimet natyrore, tregtia, përdorimi i teknologjisë, mirëqenia e popujve etj.; f. përshkruan me shembuj disa nga çështjet më të njohura globale si të drejtat e njeriut, mjedisi, paqja etj.; g. përshkruan disa nga karakteristikat kryesore të organizmave kryesore ndërkombëtare dhe të organizatave ndërshtetërore.	c. përshkruan dhe analizon ndikimin e ndryshimeve teknologjike në komunitetin global; d. shqyrton shkaqe, pasoja dhe zgjidhje të mundshme të disa prej problemeve bashkëkohore, të trashëgueshme ose reja si shëndeti, sigurimi, shpërndarja e burimeve, zhvillimet ekonomike dhe cilësia e mjedisit; e. shpjegon marrëdhëniet dhe kontradiktat ndërmjet mundësisë për të marrë vendime të pavarura në interesin kombëtar dhe interesave globale në çështje të tilla si territori, burimet natyrore, tregtia, përdorimi i teknologjisë dhe mirëqenia e popujve; f. argumenton me shembuj ekzistencën e problemeve globale si të drejtat e njeriut, ndotja e mjedisit, paqja etj. dhe shpreh qëndrimin e tij personal për pasojat e tyre për botën; g. përshkruan rolin e organizmave ndërkombëtare dhe të organizatave ndërshtetërore dhe disa nga raportet që ato krijojnë me organizmat kombëtarë.
--	--	--



TEMATIKA: IDEALET DHE PRAKTIKAT E QYTETARISË		
Përshkrimi i kompetencës në lidhje me këtë tematikë: Në fund të klasës VII, nxënësi duhet të jetë i aftë të identifikojë idealet kryesore të shoqërisë demokratike si dinjiteti njerëzor, liria, drejtësia, barazia dhe shteti i së drejtës dhe të diskutojë për zbatimin e tyre në situata të thjeshta në klasë, komunitet etj.; të identifikojë shembuj të të drejtave dhe të përgjegjësisë të qytetarëve. të gjejë, të grumbullojë, organizojë dhe shfrytëzojë informacion për çështje të interesit publik nga pikëpamje të ndryshme. të identifikojë dhe të zbatojë në praktikë forma të caktuara të diskutimeve dhe të pjesëmarrjes publike që janë në përputhje me idealet e qytetarisë në një shoqëri demokratike; të shpjegojë veprimet që qytetarët duhet të ndërmarrin për të ndikuar në vendimet e politikës publike; të pranojnë që politika publike ndikohet dhe merr formë nga veprimi i shumë faktorëve që veprojnë në sektorin publik dhe në shoqërinë civile; të shqyrtojë ndikimin e opinionit publik në vendimmarrjet personale dhe në politikën e qeverisë për çështjet publike; të shpjegojë që politikat publike dhe sjelljet e qytetarëve mund të mos pasqyrojnë idealet e qytetarisë demokratike; të përshkruajë përdorimin e politikave publike në trajtimin e çështjeve që janë në interes të përbashkët; të pranojnë dhe interpretojnë mënyrat e realizimit dhe të fuqizimit të të mirës së përbashkët me anë të veprimit qytetar.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: a. identifikon raste të ndikimeve të idealeve të shoqërisë si liria, barazia, drejtësia në jetën e shoqërisë; b. identifikon dhe grumbullon fakte ose informacione që lidhen me çështje publike; c. me vështirësi merr pjesë në forma të thjeshta diskutimesh;	Nxënësi: a. përshkruan ndikimin e idealeve të shoqërisë demokratike si dinjiteti njerëzor, liria, drejtësia, barazia dhe shteti i së drejtës; b. grumbullon dhe organizon informacion për çështje publike;	Nxënësi: a. shqyrton dhe shpjegon origjinën dhe ndikimin e vazhdueshëm të idealeve të shoqërisë demokratike si dinjiteti njerëzor, liria, shteti i së drejtës etj.; b. shqyrton dhe interpreton informacione për çështje të ndryshme publike; c. shfrytëzon informacione për çështje të veçanta publike;



d. ndjek me vështirësi rregulla të domosdoshme për diskutimet që zhvillohen në përputhje me idealet e qytetarisë në një shoqëri demokratike; e. identifikon veprime të veçanta qytetare që mund të ndikojnë në vendimet e grupit ose të komunitetit; f. identifikon dhe rendit elementë të veçantë të rolit që mund të luajnë aktorë të ndryshëm në politikën publike; g. dallon forma të ndryshme të opinionit publik dhe elementë të pjesshme të ndikimit të tij në çështje publike; h. dallon ndikimin e veprimeve ose të sjelljeve të caktuara të politikanëve në realizimin e idealeve të shoqërisë demokratike;	c. merr pjesë në diskutime për çështje publike që janë në përputhje me idealet e qytetarisë; d. përshkruan veprime të ndryshme që qytetarët mund të marrin për të ndikuar në vendimet publike; e. përshkruan rolin që mund të luajnë aktorët kryesorë që veprojnë në sektorin publik dhe në shoqërinë civile dhe në procesin e vendimmarrjes; f. përshkruan format e ndryshme të opinionit publik; g. përshkruan rolin e tij në çështje të ndryshme publike; h. përshkruan ndikimin e politikave publike dhe të sjelljeve të qytetarëve në realizimin e idealeve të shoqërisë demokratike;	d. praktikon dhe udhëheq forma të thjeshta diskutimesh në përputhje me idealet e shoqërisë demokratike; e. analizon veprimet e ndryshme që qytetarët duhet të ndërmarrin për të ndikuar në vendimet e politikës publike dhe shpjegon arsyen e veprimeve të ndërmarra; f. shpjegon rolin që luajnë aktorët e ndryshëm politikë në hartimin dhe modelimin e politikës publike dhe të procesit të vendimmarrjes; g. analizon ndikimin e formave të ndryshme të opinionit publik në zhvillimin e politikës dhe në procesin e vendimmarrjes; h. analizon efektshmërinë e politikave të caktuara publike dhe të sjelljeve të qytetarëve në realizimin e idealeve të shoqërisë demokratike; i. shpjegon marrëdhëniet ndërmjet politikave të shpallura dhe planit të veprimeve që përdoret për të trajtuar çështjet në interes të përbashkët;
--	--	---



i. identifikon, dallon, krahason elemente të lidhjeve të veprimeve qytetare dhe interesave të përbashkëta;	i. krahason dhe përshkruan lidhjet ndërmjet politikave dhe veprimeve lidhur me çështjet në interes të përbashkët;	j. shqyrton, analizon, shpjegon strategjitë e hartuara për realizmin dhe fuqizimin e të mirës së përbashkët.
j. dallon, krahason lidhje të elementëve të veçantë të strategjive të paraqitura dhe të mirës së përbashkët;	j. përshkruan lidhjet ndërmjet strategjive të hartuara për të mirën e përbashkët dhe vetë të mirës së përbashkët.	

TEMATIKA: TË DREJTAT E NJERIUT SI IDEAL DHE PRAKTIKA TË QYTETARISË

Përshkrimi i kompetencës në lidhje me këtë tematikë:

Në fund të klasës VII, nxënësi duhet të jetë i aftë të përshkruajë se si shoqëria njerëzore i plotëson nevojat e anëtarëve të saj dhe të shpjegojë pse plotësimi i nevojave bazë përbën një të drejtë që takon si atij ashtu edhe të tjerëve. të dallojë të drejtat dhe llojet kryesore të tyre si të drejtat personale, politike, ekonomike etj.; të flasë për rëndësinë që kanë të drejtat dhe realizimi i tyre për vete dhe për të tjerët; të identifikojë të drejta që lidhen me lirinë e njeriut, opinionin dhe shprehjen e tij, mjedisin dhe marrëdhëniet e tij me nevojat e njeriut mirësjelljen, komunikimin, shkëmbimin e informacionit etj.; të mbajë qëndrim të caktuar për çështje që kanë të bëjnë me të drejtat dhe respektimin e tyre në mjedisin ku jeton dhe më gjerë.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi:	Nxënësi:	Nxënësi:
a. dallon nevoja dhe dëshira bazë të individit;	a. përshkruan lidhjen ndërmjet të drejtave të njeriut dhe nevojave bazë të tij;	a. përshkruan dhe klasifikon nevojat dhe dëshirat bazë të qenies njerëzore;
b. identifikon në dokumentet kryesore të të drejtave të njeriut dhe në	b. bën dallimin ndërmjet kategorive të ndryshme të të drejtave civile e	b. shpjegon pse plotësimi i nevojave bazë të njeriut përbën një të drejtë që u takon si atij ashtu edhe të tjerëve;



kushtetutën shqiptare të drejtat dhe liritë themelore, c. dallon raste të kufizimit të të drejtave në jetën e përditshme; d. flet për rëndësinë e plotësimit të të drejtave të njeriut për jetën e tij.; e. merr pjesë në diskutime lidhur me çështje që kanë të bëjnë me fushën e veprimit dhe të kufizimit të të drejtave; f. mbështet veprimet konkrete në mbrojtje të të drejtave të tij dhe të të tjerëve.	politike, ekonomike, sociale dhe kulturore; c. përshkruan, me shembuj, kufizimin e të drejtave në jetën e përditshme, në familje, klasë etj.; d. përshkruan rëndësinë që kanë të drejta të caktuara për jetën e individit; e. mban qëndrim caktuar lidhur me çështje që kanë të bëjnë me fushën e veprimit dhe të kufizimit të të drejtave; f. merr pjesë në veprime konkrete në mbrojtje të të drejtave të tij dhe të të tjerëve.	c. përshkruan llojet kryesore të të drejtave dhe i grupon ato sipas veçorive, në kategori dhe diskuton rreth ndryshimeve të tyre; d. shpjegon se të drejtat veprojnë në një fushë të caktuar dhe ato kanë kufizimet e tyre; e. argumenton se të drejtat kufizohen nga nevoja për të respektuar të drejtat e tij dhe të të tjerëve në emër të harmonisë shoqërore; f. vlerëson, merr dhe mbron qëndrime të caktuara lidhur me çështje që kanë të bëjnë me fushën e veprimit dhe të kufizimit të të drejtave; g. respekton dhe ndërmerr veprime konkrete në mbrojtje të të drejtave të tij dhe të të tjerëve.
--	---	---

SHKALLA IV

TEMATIKA: KULTURA

Përshkrimi i kompetencës:



Në fund të klasës VII, nxënësi duhet të jetë i aftë të krahasojë ngjashmëritë dhe ndryshimet në mënyrën se si grupet, shoqëritë dhe kulturat plotësojnë nevojat dhe interesat e tyre; të shpjegojë se si njerëzit me prejardhje të ndryshme kulturore, me këndvështrime dhe pikënisje të ndryshme interpretojnë informacionet dhe përvojat; të shpjegojë dhe të japë shembuj për mënyrën e ndikimit të gjuhës, letërsisë, arteve, traditave, bindjeve, vlerave dhe sjelljeve në zhvillimin dhe tejçimin e kulturës; të shpjegojë pse individët dhe grupet reagojnë në mënyra të ndryshme ndaj mjediseve shoqërore ose fizike dhe ndaj ndryshimeve mbi bazën e pikëpamjeve, vlerave dhe bindjeve të tyre; të përshkruajë ndikimin dhe bashkëveprimin e diversitetit kulturor si dhe të kohezionit social brenda dhe ndërmjet grupeve.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV



Nxënësi: a. identifikon ngjashmëri dhe ndryshime në mënyrën se si individë dhe grupe të ndryshme plotësojnë nevojat dhe interesat e tyre; b. dallon faktin që njerëz të ndryshëm kanë pikëpamje të ndryshme për probleme dhe dukuri të ndryshme shoqërore; c. dallon raste të ndikimit të gjuhës, të traditave dhe të sjelljeve në zhvillimin e kulturës; d. dallon elemente të lidhjeve ndërmjet reagimeve të ndryshme të individëve dhe të grupeve ndaj mjediseve shoqërore ose ndryshimeve dhe pikëpamjeve, vlerave dhe bindjeve të tyre; e. dallon raste të ndikimit dhe bashkëveprimit të njerëzve me prejardhje të ndryshme kulturore brenda dhe ndërmjet grupeve.	Nxënësi: a. identifikon ngjashmëritë dhe ndryshimet në mënyrën se si grupet, shoqëritë dhe kulturat plotësojnë nevojat dhe interesat e tyre; b. dallon këndvështrimet e ndryshme të njerëzve me prejardhje të ndryshme kulturore për probleme dhe dukuri të ndryshme shoqërore; c. dallon dhe jep shembuj të ndikimit të gjuhës, letërsisë, arteve, traditave, bindjeve, vlerave dhe sjelljeve në zhvillimin dhe tejçimin e kulturës; d. përshkruan reagimet e ndryshme të individëve dhe të grupeve ndaj mjediseve shoqërore ose fizike dhe ndaj ndryshimeve mbi bazën e pikëpamjeve, vlerave dhe bindjeve të tyre; e. krahason raste të ndikimit dhe bashkëveprimit të diversitetit kulturor brenda dhe ndërmjet grupeve.	Nxënësi: a. krahason ngjashmëritë dhe ndryshimet në mënyrën se si grupet, shoqëritë dhe kulturat plotësojnë nevojat dhe interesat e tyre; b. shpjegon se si njerëzit me prejardhje të ndryshme kulturore, me këndvështrime dhe pikënisje të ndryshme nga njëri-tjetri interpretojnë informacionet dhe përvojat; c. shpjegon me shembuj mënyrën e ndikimit të gjuhës, arteve, traditave, bindjeve, vlerave dhe sjelljeve në zhvillimin dhe tejçimin e kulturës; d. shpjegon pse individët dhe grupet reagojnë në mënyra të ndryshme ndaj mjediseve shoqërore ose fizike dhe ndaj ndryshimeve mbi bazën e pikëpamjeve, vlerave dhe bindjeve të tyre; e. përshkruan ndikimin dhe bashkëveprimin e diversitetit kulturor si dhe të kohezionit social brenda dhe ndërmjet grupeve.
--	---	---



TEMATIKA: KOHA, VAZHDIMËSIA, NDRYSHIMI		
Përshkrimi i kompetencës: Në fund të klasës së nëntë, nxënësi duhet të jetë i aftë të shqyrtojë ngjarjet, dukuritë, proceset etj., në zhvillimin e tyre kohor; të demonstrojë të kuptuarin që njerëz të ndryshëm mund të përshkruajnë të njëjtat ngjarje ose situata në mënyra të ndryshme, por duke dhënë arsye ose evidenca për këndvështrimet e tyre; të identifikojë dhe të përdorë konceptet kyç si kronologjia, rastësia, ndryshimi, konflikti dhe kompleksiteti për të shpjeguar, analizuar dhe treguar lidhjet midis ndryshimit dhe vazhdimësisë; të identifikojë dhe të përshkruajë periudha të caktuara të ndryshimit nëpërmjet kulturave, të tilla si rritja e qytetërimit, zhvillimi i sistemeve të transportit, komunikimit etj.; të identifikojë dhe të përdorë proceset e rëndësishme për të rindërtuar dhe për të riinterpretuar të kaluarën, të tilla si përdorimi i një larmie burimesh që furnizojnë me të dhëna të vlefshme dhe të besueshme; të zhvillojë ndjenja kritike të tilla si simpatia apo skepticizmi lidhur me qëndrimet, vlerat, dhe sjelljet e njerëzve në kontekste të ndryshme historike; të përdorë njohjen e fakteve dhe koncepteve të nxjerra nga historia, shfrytëzimin e tyre, për të informuar rreth vendimmarrjes dhe pjesëmarrjes në veprime konkrete për çështjet publike.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV



Nxënësi: a. dallon raste ose shembuj të këndvështrimit të ndryshme të njëjtave ngjarje; b. dallon elementë të lidhjes ndërmjet ndryshimit dhe vazhdimësisë dhe të marrëdhënieve shkak pasojë nga historia dhe jeta e përditshme; c. dallon periudha të caktuara historike dhe elemente të ndryshme të ndryshimit që ekziston ndërmjet tyre; d. rindërton elemente të veçantë të historisë duke përdorur të dhëna ose burime të shkëputura dhe jo të rëndësishme; nuk bën përpjekje për të verifikuar besueshmërinë ose vlerën e tyre; e. shpreh lehtësisht qëndrimin e tij për qëndrimet, vlerat dhe sjelljet e njerëzve të marrë jashtë konteksteve	Nxënësi: a. përshkruan shembuj të përshkrimit të njëjtave ngjarje ose situata nga njerëz të ndryshëm nga këndvështrime të ndryshme; b. përshkruan lidhjet ndërmjet ndryshimit dhe vazhdimësisë duke përdorur konceptet kyç si kronologjia, rastësia, ndryshimi, konflikti dhe kompleksiteti; c. përshkruan periudha të caktuara të ndryshimit brenda dhe ndërmjet kulturave, të tilla si rritja e qytetërimit, zhvillimi i sistemeve politike, ekonomike etj.; d. përdor burime të ndryshme për të rindërtuar dhe për të riinterpretuar të kaluarën; verifikon besueshmërinë e burimeve të përdorura; e. mban qëndrime të caktuara si simpatia ose dyshimi për qëndrimet, vlerat, dhe	Nxënësi: a. shpjegon dhe argumenton pse njerëz të ndryshëm mund të përshkruajnë të njëjtat ngjarje ose situata në mënyra të ndryshme; b. shpjegon dhe analizon lidhjet ndërmjet ndryshimit dhe vazhdimësisë dhe përdor konceptet e duhura për të shpjeguar, analizuar dhe treguar lidhjet midis ndryshimit dhe vazhdimësisë; c. përshkruan <i>periudha</i> të caktuara historike dhe <i>modele</i> të ndryshimit brenda dhe ndërmjet kulturave, të tilla; d. përdor sistematikisht metodat e vështrimit kritik të historisë dhe burime të ndryshme për të rindërtuar dhe për të riinterpretuar të kaluarën, verifikon vazhdimisht besueshmërinë dhe vlerën e burimeve të përdorura. e. mban dhe zhvillon qëndrime ndjenjash kritike të tilla si simpatia ose dyshimi lidhur me qëndrimet, vlerat, dhe sjelljet
---	--	--



të ndryshme historike dhe jashtë shikimit kritik; f. merr vendime individuale dhe merr pjesë në veprime të caktuara konkrete mbi bazën e gjykimeve të shpejtuara të elementëve të veçanta ose të shkëputura të realitetit.	sjelljet e njerëzve në kontekste të ndryshme historike; f. përdor njohjen e fakteve të caktuara për vendimmarrje dhe pjesëmarrje në veprime konkrete.	e njerëzve në kontekste të ndryshme historike; f. përdor njohjen e fakteve dhe të koncepteve të nxjerra nga historia për vendimmarrje dhe pjesëmarrje në veprime konkrete për çështjet publike.
--	--	--

TEMATIKA: NJERËZ, VENDE, MJEDISE

Përshkrimi i kompetencës:

Në fund të klasës së nëntë, nxënësi duhet të jetë i aftë të përzgjedhë pamje të komunitetit lokal dhe rajonal të cilat ndihmojnë për një të kuptuar të përmasave, formave dhe drejtimeve të mjedisit në këtë komunitet; të krijojë, të interpretojë, të përdorë dhe të dallojë paraqitje të ndryshme të planetit tonë në harta, globe dhe fotografi; të përdorë burime të vlefshme, të dhëna burimore dhe mjete didaktike të tilla si fotografi, harta, libra, gazeta, statistika, si dhe të tjera që ndihmojnë për të bërë përgjithësime, përpunime dhe interpretime rreth bashkëveprimit të njerëzve me vendet dhe mjedisin; të përshkruajë tiparet e mjediseve në nivel lokal, rajonal duke u ndalur te lumenjtë, liqenet, detet, malet, pyjet, etj dhe të shpjegojë marrëdhëniet brenda ekosistemit; të përshkruajë ndryshimet e sistemit si stinët, klimën dhe motin, ciklin ujor, si dhe të identifikojë zakonet e banorëve të zonës lidhur me to; të përshkruajë si njerëzit krijojnë vende që reflektojnë vlerat dhe idealet e tyre kulturore, si ndërtojnë qendrat e banimit me parqe, qendra biznesi etj.; të shqyrtojë, të interpretojë dhe të analizojë traditat fizike dhe kulturore dhe bashkëveprimet me to, të tilla si përdorimi i tokës, transmetimi kulturor i zakoneve dhe ideve, ndryshimet e ekosistemit etj; të përshkruajë si kanë ndikuar dhe ndikojnë ngjarjet historike



NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: a. dallon tipare të veçanta të mjedisit në nivel lokal dhe rajonal; b. identifikon ndryshime në zakonet e banorëve që jetojnë në një mjedis të caktuar; c. identifikon lidhje që ekzistojnë ndërmjet idealeve të njerëzve dhe mënyrës së ndërtimit të vendeve ku banojnë etj.; d. dallon raste të bashkëveprimit ndërmjet traditave fizike dhe kulturore si përdorimi i tokës, transmetimi i ideve, ndryshimet e ekosistemit etj.; e. dallon raste të ndikimit të ngjarjeve të caktuara dhe të faktorëve fizikë në	Nxënësi: a. përshkruan tiparet e mjediseve në nivel lokal dhe rajonal; b. përshkruan lidhjet që ekzistojnë ndërmjet ndryshimeve në mjedis dhe zakoneve të banorëve që jetojnë në të; c. përshkruan se si njerëzit krijojnë vende (vende banimi, parqe etj.) që pasqyrojnë vlerat dhe idealet e tyre kulturore; d. shqyrton bashkëveprimin ndërmjet traditave fizike dhe kulturore si përdorimi i tokës, transmetimi i ideve, ndryshimet e ekosistemit etj.; e. përshkruan ndikimin e ngjarjeve historike dhe faktorët fizikë në zhvillimin lokal dhe kombëtar;	Nxënësi: a. shpjegon marrëdhëniet ndërmjet tipareve të mjedisit në nivel lokal dhe rajonal; b. shpjegon marrëdhëniet ndërmjet ndryshimeve në mjedis dhe zakoneve të banorëve që jetojnë në të; c. shpjegon lidhjet që ekzistojnë ndërmjet mënyrës së ndërtimit të qendrave të banuara etj., dhe vlerave dhe idealeve kulturore të njerëzve që i ndërtojnë ato; d. analizon dhe interpreton bashkëveprimin ndërmjet traditave fizike dhe kulturore si përdorimi i tokës, transmetimi i ideve, ndryshimet e ekosistemit etj.; e. shpjegon ndikimin e ngjarjeve historike dhe faktorët fizikë në zhvillimin lokal, kombëtar dhe global;

zhvillimin e komunitetit ose të vendit ku jeton; f. shpreh mendimin e tij për pasoja të veçanta që sjellin ndryshime të caktuara mjedisore si stuhitë, thatësira, përmytjet etj.; g. flet për lidhjet ndërmjet njeriut dhe mjedisit, duke u mbështetur në burime të tilla si fotografi, gazeta etj.; h. jep mendimin e tij për mënyrën e përdorimit të burimeve të caktuara natyrore në bashkësinë ku jeton .	f. diskuton rreth pasojave sociale dhe ekonomike të ndryshimeve mjedisore dhe të dukurive që burojnë prej tyre si stuhi, thatësira, përmytje etj.; g. përshkruan bashkëveprimin e njeriut me mjedisin, duke përdorur burime të vlefshme dhe mjete të tilla si fotografi, harta, libra, gazeta etj.; h. propozon alternativa të përdorimit të burimeve natyrore në bashkësinë ku jeton dhe më gjerë.	f. debaton me argumente rreth pasojave sociale dhe ekonomike të ndryshimeve mjedisore dhe të dukurive që burojnë prej tyre si stuhitë, thatësira, përmytjet etj.; g. bën përgjithësime dhe interpreton bashkëveprimin e njerëzve me vendet dhe mjedisin, duke përdorur burime të vlefshme dhe mjete të duhura; h. vlerëson dhe propozon alternativa të përdorimit të burimeve natyrore në bashkësinë ku jeton dhe më gjerë.
--	---	---

TEMATIKA: ZHVILLIMI INDIVIDUAL DHE IDENTITETI

Përshkrimi i kompetencës:

Në fund të klasës së nëntë, nxënësi duhet të jetë i aftë të lidhë ndryshimet personale me kontekstet sociale, kulturore dhe historike; të përshkruajë lidhjet personale me vendin të shoqëruar me komunitetin, kombin, rajonin dhe botën; të përshkruajë mënyrat sesi familja, gjinia, etnia, kombësia dhe lidhjet institucionale kontribuojnë në identitetin e personit; të lidhë faktorë të tillë si mjedisi dhe aftësitë fizike me të mësuarin, motivimin, personalitetin, perceptimin dhe sjelljen për zhvillimin individual; të identifikojë dhe të përshkruajë mënyrat sesi kulturat rajonale, etnike dhe kombëtare, ndikojnë në jetën e përditshme të individit; të identifikojë dhe të përshkruajë ndikimin e perceptimit, qëndrimeve, vlerave dhe besimeve në identitetin personal; të identifikojë dhe të interpretojë shembuj të indiferencës dhe të solidaritetit; të punojë në mënyrë të pavarur dhe në bashkëpunim për arritjen e qëllimeve.



NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: a. formon një album fotografik me fotot më përfaqësuese të tij dhe familjes dhe vendos për çdo fotografi nga një diçiturë ose koment; b. liston në dy kategori dëshirat dhe nevojat personale; c. shpreh ose mbështet mendimin e shokëve, të pjesëtarëve të familjes për një çështje të caktuar; d. dallon elementët e një pasaporte si dokument që identifikon individin.	Nxënësi: a. krahason moshatarët e tij/saj të cilët shfaqen me individualitete dhe identitete të ndryshme; b. dallon identitetin nga individualiteti dhe liston faktorët që përcaktojnë individualitetin e individit; c. prezanton veten (në mjedise të caktuara) si individ i caktuar me individualitet dhe identitet; d. komenton në mënyrë të pavarur një ngjarje ose fakt të jetës së tij personale.	Nxënësi: a. evidenton dhe krahason ndryshimet personale në një hark kohor të caktuar dhe brenda një konteksti social, kulturor ekonomik; b. argumenton ndikimet e grupit(ve) sociale (familje - shkollë) në zhvillimin e tij individual; c. krahason ndikimet që vinë tek ai/ajo nga familja-shkolla-mjedisi i jashtëm në shkollë, media e tjer me ndikimet që këto institucione kanë tek individë të tjerë; d. formulon një ese për veten titulluar “kush jam unë” ose “ky jam unë”.
TEMATIKA: INDIVIDËT, GRUPET, INSTITUCIONET		
Përshkrimi i kompetencës: Në fund të klasës së nëntë, nxënësi duhet të jetë i aftë të demonstrojë të kuptuarin e koncepteve të tilla si roli, statusi dhe klasa sociale në përshkrimin e ndërveprimit të individit me grupet sociale; të analizojë ndikimet e grupit dhe të institucioneve të njerëzisë, ngjarjet dhe elementet e kulturës; të përshkruajë forma të ndryshme se si institucionet marrin pjesë dhe bashkëveprojnë me njerëzisë; të identifikojë dhe të analizojë shembuj tensionesh midis shprehjeve të individualitetit dhe grupit ose përpjekjeve institucionale për të vënë në lëvizje konformitetin social; të identifikojë dhe të përshkruajë shembuj të tensioneve midis sistemeve të besimit dhe ligjeve		



e politikave të qeverisjes; të përshkruajë rolin e institucioneve për të përshpejtuar vazhdimësinë dhe ndryshimin; të zbatojë njohuritë e të tregojë se si grupet dhe institucionet punojnë për të përmbushur nevojat individuale dhe për të nxitur të mirën e përgjithshme.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: a. liston grupet sociale në të cilat bën apo dëshiron të bëjë pjesë dhe veçon rolin që ai/ajo luan më mirë; b. dallon nevojat që i përmbush secili grup social si dhe dëshirat që i përmbush secili; c. demonstron nevojën dhe gatishmërinë për të qenë anëtar i një grupi të caktuar; d. pranon rregullat e grupit social ku bën pjesë.	Nxënësi: a. dallon dhe krahason konceptet “rol social”, “status social”, “grup social”; b. përshkruan si grupi social plotëson nevojat e individit dhe cilat nevoja konkretisht plotëson; c. pranon dhe stimulon përfshirjen e pjesëtarëve të rinj në grupin social ku bën pjesë; d. vlerëson dhe respekton vendimet e grupit ku bën pjesë;	Nxënësi: a. përshkruan “rolin” e tij social (detyrat dhe përgjegjësitë) brenda një grupi të caktuar (familje, klasë, grup shoqëror); b. evidenton “statusin e tij social” dhe përshkruan elementët përbërës të këtij statusi; c. analizon rastet kur individë dhe grupe me interesa të kundërta vendosin marrëdhënie midis tyre në rrethana të caktuara; d. analizon dhe sjell raste kur marrëdhëniet ndërmjet grupeve të ndryshme bëhen në emër të së “mirës së përbashkët”;
TEMATIKA: PUSHTETI, AUTORITETI, QEVERISJA		
Përshkrimi i kompetencës:		



Në fund të klasës së nëntë, nxënësi duhet të jetë i aftë të ekzaminojë në mënyrë të vazhdueshme çështjet që përfshijnë të drejtat, rolet dhe statusin individual në lidhje me mirëqenien e përgjithshme; të përshkruajë qëllimin e qeverisjes dhe sesi janë ruajtur, përdorur dhe justifikuar fuqitë e saj; të analizojë dhe të përshkruajë idetë dhe mekanizmat qeveritare për të përmbushur nevojat dhe dëshirat e qytetarëve, për të rregulluar territorin, për të menaxhuar konfliktet dhe për të vendosur rregull dhe siguri; të përshkruajë sesi mënyrat e organizimit të kombeve i përgjigjen forcave të unitetit dhe diversitetit duke ndikuar në rregullin dhe sigurinë; të identifikojë dhe të përshkruajë tiparet bazë të sistemit politik në vendin tonë dhe të identifikojë udhëheqësit përfaqësues nga nivele dhe degë të ndryshme të qeverisjes; të shpjegojë kushtet, veprimet dhe motivimet që kontribuojnë për bashkëpunimin dhe konfliktin brenda dhe ndërmjet kombeve; të përshkruajë dhe të analizojë rolin e teknologjisë në komunikim, transport, procesin e informimit, si dhe zhvillimin në fusha të tjera që kontribuojnë për të zgjidhur konfliktet; të shpjegojë dhe të zbatojë koncepte të tilla si fuqia, roli, statusi, drejtësia, dhe ndikimi për ekzaminimin e çështjeve të përhershme dhe problemeve sociale; të japë shembuj dhe të shpjegojë se si qeveritë përpiqen të arrijnë idealet e deklaruara brenda dhe jashtë vendit.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: a. identifikon emrat e udhëheqësve lokalë si kryetar i bashkisë, kryetar i qarkut etj.; b. veçon institucionet lokale që plotësojnë dëshirat e qytetarëve dhe institucionet që plotësojnë nevojat e tyre; c. rendit institucionet që garantojnë: rendin, shëndetin, arsimin, punësimin etj.;	Nxënësi: a. formulon pyetje që lidhen me mbarëvajtjen ose jo të qeverisjes lokale; b. identifikon debatet e ndryshme në medien pamore ose të shkruar lokale rreth çështjeve të mënyrës si funksionon qeverisja; c. analizon qeverisjen në nivelin e shkollës dhe komenton mënyrën si funksionon “qeveria e nxënësve” në shkollë;	Nxënësi: a. shqyrton rolin (rolet) dhe rrugën (t) përmes të cilës individ merr pjesë në qeverisjen lokale dhe kombëtare; b. argumenton në çdo rast nevojën për qeverisje lokale dhe kombëtare; c. interpretton skemën e qeverisjes lokale (institucionet që lidhen me arsimin) dhe kombëtare;



Përshkrimi i kompetencës:

Në fund të klasës së nëntë, nxënësi duhet të jetë i aftë të japë dhe të përshkruajë shembuj për mënyrat se si sistemet ekonomike bëjnë zgjedhjet e tyre për prodhimin dhe shpërndarjen e të mirave materiale dhe shërbimeve; të përshkruajë rolin që luajnë oferta, kërkesa, mënyra e shpërblimit, çmimi dhe fitimet në përcaktimin e asaj që prodhohet dhe shpërndahet në një sistem konkurrencial tregu; të shpjegojë ndryshimin që ekziston ndërmjet të mirave dhe shërbimeve të sektorit privat dhe atij publik; të përshkruajë shembuj të ndryshëm të institucioneve që formojnë sistemet ekonomike si prodhimi i vogël (edhe ai familjar), firmat prodhuese, bankat, institucionet qeveritare, sindikatat dhe korporatat; të përshkruajë rolin e specializimeve dhe të shkëmbimit në proceset ekonomike; të përshkruajë dhe të tregojë me shembuj për ndikimin e vlerave dhe bindjeve në vendimet e ndryshme ekonomike; të bëjë dallimin ndërmjet formave të ndryshme të shkëmbimit dhe parave; të krahasojë sistemet kryesore ekonomike bazuar në kriterin se kush përcakton prodhimin, shpërndarjen dhe konsumin e të mirave dhe shërbimeve; të përdorë koncepte ekonomike për të shpjeguar zhvillimet aktuale dhe historike dhe çështjet në kontekstin lokal, kombëtar dhe global; të përdorë arsyetimin ekonomik për të krahasuar propozimet e ndryshme që lidhen me çështje shoqërore bashkëkohore si papunësia, shiu acid ose cilësia e arsimit.

teknologjia kanë ndryshuar perceptimet e njerëzve për botën natyrore dhe sociale, si marrëdhëniet e tyre me tokën, jetën e kafshëve, jetën familjare, nevojat dhe dëshirat ekonomike dhe sigurinë; të përshkruajë shembuj në të cilat vlerat, besimet dhe qëndrimet janë ndikuar nga zbulimet e reja shkencore dhe teknologjike, si shpikja e shtypit, konceptimi i universit, zbatimi i energjisë atomike dhe zbulimet gjenetike; të shpjegojë nevojën për ligje dhe politika për të qeverisur zbatimet shkencore dhe teknologjike, të tilla si siguria dhe mirëqenia e punëtorëve dhe e konsumatorëve, rregullimi gjërave të dobishme si radio, televizioni etj.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: a. dallon raste të ndikimit të elementëve të kulturës në arritje të veçanta në fushën e shkencës dhe të teknologjisë, si në transport, mjekësi; b. dallon raste të ndikimit të shkencës dhe teknologjisë në ndryshimin e perceptimeve të njerëzve për jetën e tyre ekonomike dhe shoqërore dhe marrëdhëniet me natyrën; c. dallon raste të veçanta të ndikimit të zbulimeve të reja shkencore dhe teknologjike, si shpikja e shtypit, konceptimi i gjithësisë, zbatimi i energjisë atomike dhe zbulimet gjenetike në vlerat dhe besimet e tyre;	Nxënësi: a. përshkruan me shembuj ndikimin e kulturës në zgjedhjet dhe arritjet e shkencës dhe teknologjisë, si në transport, mjekësi etj.; b. përshkruan me shembuj se si shkenca dhe teknologjia kanë ndryshuar perceptimet e njerëzve për botën natyrore dhe shoqërore, për marrëdhëniet e tyre me tokën, për jetën e kafshëve, për jetën familjare, nevojat ekonomike dhe sigurinë; c. përshkruan ndikimin që kanë zbulimet e reja shkencore dhe teknologjike, si shpikja e shtypit, konceptimi i gjithësisë, zbatimi i energjisë atomike dhe zbulimet gjenetike në vlerat dhe besimet e tyre;	Nxënësi: a. shqyrton ndikimin e kulturës në zgjedhjet dhe arritjet e shkencës dhe teknologjisë, si në transport, mjekësi etj.; b. analizon, duke përdorur shembuj se si shkenca dhe teknologjia kanë ndryshuar perceptimet e njerëzve për botën natyrore dhe shoqërore, për marrëdhëniet e tyre me tokën, për jetën e kafshëve, për jetën familjare, nevojat ekonomike dhe sigurinë; c. analizon ndikimin e zbulimeve të reja shkencore dhe teknologjike, si shpikja e shtypit, konceptimi i gjithësisë, zbatimi i energjisë atomike dhe zbulimet gjenetike në vlerat dhe besimet e tyre;



d. tregon ose flet për raste të nevojës së ligjeve për të qeverisur zbatimet shkencore dhe teknologjike të tilla si siguria dhe mirëqenia e punëtorëve dhe konsumatorëve, rregullimi i gjërave të dobishme si radioja, televizioni etj.	d. përshkruan me shembuj nevojën e ligjeve dhe të politikës për të qeverisur zbatimet shkencore dhe teknologjike të tilla si siguria dhe mirëqenia e punëtorëve dhe konsumatorëve, rregullimi i gjërave të dobishme si radioja, televizioni etj.	d. shpjegon nevojën për ligje dhe politika për të qeverisur zbatimet shkencore dhe teknologjike të tilla si siguria dhe mirëqenia e punëtorëve dhe konsumatorëve, rregullimi i gjërave të dobishme si radioja, televizioni etj.
TEMATIKA: LIDHJET GLOBALE		
Përshkrimi i kompetencës: Në fund të klasës së nëntë, nxënësi duhet të jetë i aftë të përshkruajë me shembuj ndikimin (lehtësimin ose jo) e elementëve kulturorë si gjuha, arti, muzika, besimet etj. në mirëkuptimin ose keqkuptimin në nivel global; të analizojë shembuj bashkëpunimi, ndërvarësie ose konfliktesh ndërmjet individëve, grupeve ose kombeve; të përshkruajë dhe të analizojë ndikimin e ndryshimeve teknologjike në komunitetin global; të shqyrtojë shkaqe, pasoja dhe zgjidhje të mundshme të disa prej problemeve bashkëkohore, të trashëgueshme ose të reja si shëndeti, sigurimi, shpërndarja e burimeve, zhvillimet ekonomike dhe cilësia e mjedisit; të përshkruajë dhe të shpjegojë marrëdhëniet dhe kontradiktat ndërmjet sovranitetit kombëtar dhe interesave globale në çështje të tilla si territori, burimet natyrore, tregtia, përdorimi i teknologjisë dhe mirëqenia e popujve; të dëshmojë me shembuj praktikë nivelin e të kuptuarit të çështjeve, standardeve dhe konflikteve lidhur me të drejtat e njeriut dhe çështje të tjera globale; të identifikojë dhe të përshkruajë rolin e organizmave ndërkombëtarë dhe të organizatave ndërshtetërore.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: a. dallon raste ose elemente të veçanta kulturore që kanë luajtur dhe luajnë rol në mirëkuptimin ose jo në nivel kombëtar ose global;	Nxënësi: a. përshkruan ndikimin e elementëve të veçantë kulturorë (gjuha, besimet, arti etj) në rritjen ose jo të mirëkuptimit në nivel kombëtar ose global;	Nxënësi: a. përshkruan me shembuj ndikimin e kulturës në rritjen ose jo të mirëkuptimit global;



b. përmend shembuj bashkëpunimi ose konfliktesh ndërmjet individëve, grupeve ose kombeve; c. dallon raste e shembuj të ndikimit të teknologjisë në komunitetin global; d. identifikon disa prej problemeve bashkëkohore ose të trashëguara për shembull në fushën e shëndetit, mjedisit, shpërndarjes së të ardhurave etj. dhe disa prej pasojave të tyre; e. dallon probleme të veçanta që lindin nga marrëdhëniet ndërmjet kombit me vendet e tjera lidhur me çështje të tilla si territori, burimet natyrore, tregtia, përdorimi i teknologjisë, mirëqenia e popujve etj.;	b. identifikon dhe përshkruan shembuj bashkëpunimi ose konfliktesh ndërmjet individëve, grupeve ose kombeve; c. përshkruan ndikimin e ndryshimeve teknologjike në komunitetin global; d. përshkruan disa prej problemeve bashkëkohore, të trashëgueshme ose të reja si shëndeti, siguri, shpërndarja e burimeve, zhvillimet ekonomike dhe cilësia e mjedisit si dhe disa prej pasojave të tyre; e. përshkruan disa prej rrjedhëve pozitive ose negative të marrëdhënieve ose kontradiktave të vendit me komunitetin ndërkombëtar, lidhur me çështje të tilla si territori, burimet natyrore, tregtia, përdorimi i teknologjisë, mirëqenia e popujve etj.; f. përshkruan me shembuj disa nga çështjet më të njohura globale si të drejtat e njeriut, mjedisin, paqen etj.;	b. analizon shembuj bashkëpunimi, ndërvarësie ose konfliktesh ndërmjet individëve, grupeve ose kombeve; c. përshkruan dhe analizon ndikimin e ndryshimeve teknologjike në komunitetin global; d. shqyrton shkaqe, pasoja dhe zgjidhje të mundshme të disa prej problemeve bashkëkohore, të trashëgueshme ose të reja si shëndeti, siguri, shpërndarja e burimeve, zhvillimet ekonomike dhe cilësia e mjedisit; e. shpjegon marrëdhëniet dhe kontradiktat ndërmjet mundësisë për të marrë vendime të pavarura në interesin kombëtar dhe interesave globale në çështje të tilla si territori, burimet natyrore, tregtia, përdorimi i teknologjisë dhe mirëqenia e popujve; f. argumenton me shembuj ekzistencën e problemeve globale dhe shpreh qëndrimin e tij personal për pasojat e tyre për botën;
---	---	--



Nxënësi: a. identifikon raste të ndikimeve të idealeve të shoqërisë si liria, barazia, drejtësia në jetën e shoqërisë; b. identifikon dhe grumbullon fakte ose informacione që lidhen me çështje publike; c. me vështirësi merr pjesë në forma të thjeshta diskutimesh; d. identifikon veprime të veçanta qytetare që mund të ndikojnë në vendimet e grupit ose të komunitetit; e. dallon elemente të ndikimit të veprimit qytetar në vendimet e grupit ose të komunitetit ku bën pjesë;	Nxënësi: a. përshkruan ndikimin e idealeve të shoqërisë demokratike si dinjiteti njerëzor, liria, drejtësia, barazia dhe shteti i së drejtës; b. grumbullon dhe organizon informacion për çështje publike; dallon këndvështrimet e ndryshme për to; c. merr pjesë në diskutime për çështje publike që janë në përputhje me idealet e qytetarisë në një shoqëri demokratike; d. përshkruan veprime të ndryshme që qytetarët mund të marrin për të ndikuar në vendimet publike; e. përshkruan rolin që mund të luajnë aktorët kryesorë që veprojnë në sektorin publik dhe në procesin e vendimmarrjes; f. përshkruan format e ndryshme të opinionit publik; përshkruan rolin e tyre në çështje të ndryshme publike; g. përshkruan ndikimin e politikave publike dhe të sjelljeve të qytetarëve në	Nxënësi: a. shpjegon origjinën dhe ndikimin e vazhdueshëm të idealeve të shoqërisë demokratike; b. shqyrton dhe interpretton informacione për çështje të ndryshme publike; c. shfrytëzon informacione për çështje të veçanta publike dhe udhëheq forma të thjeshta diskutimesh në përputhje me idealet e shoqërisë demokratike; d. analizon veprimet e ndryshme që qytetarët duhet të ndërmarrin dhe shpjegon arsyen e veprimeve të ndërmarra; e. shpjegon rolin që luajnë aktorët e ndryshëm politikë në sektorin publik në hartimin e politikës publike dhe të procesit të vendimmarrjes; f. analizon ndikimin e formave të ndryshme të opinionit publik në zhvillimin e politikës dhe në procesin e vendimmarrjes për çështjet publike; g. analizon efektshmërinë e politikave të caktuara publike dhe të sjelljeve të
---	---	--



f. identifikon dhe rendit elementë të veçantë të rolit që mund të luajnë aktorë të ndryshëm në politikën publike; g. dallon forma të ndryshme të opinionit publik; h. dallon ndikimin e veprimeve ose të sjelljeve të caktuara të politikanëve në realizmin e idealeve të shoqërisë demokratike; i. identifikon, dallon, krahason elemente të lidhjeve të veprimeve qytetare dhe interesave të përbashkëta;	realizimin e idealeve të shoqërisë demokratike; h. krahason dhe përshkruan lidhjet ndërmjet politikave dhe veprimeve lidhur me çështjet në interes të përbashkët; i. përshkruan lidhjet ndërmjet strategjive të hartuara për të mirën e përbashkët dhe vetë të mirës së përbashkët.	qytetarëve në realizimin e idealeve të shoqërisë demokratike; h. shpjegon marrëdhëniet ndërmjet politikave të shpallura dhe planit të veprimeve që përdoret për të trajtuar çështjet në interes të përbashkët; i. shqyrton, analizon, shpjegon strategjitë e hartuara për realizmin dhe fuqizimin e të mirës së përbashkët.
---	--	--

TEMATIKA: TË DREJTAT E NJERIUT SI IDEAL DHE PRAKTIKA TË QYTETARISË

Përshkrimi i kompetencës:

Në fund të klasës së nëntë, nxënësi duhet të jetë i aftë të identifikojë, përshkruajë dhe klasifikojë nevojat dhe dëshirat bazë të qenies njerëzore; të shpjegojë pse plotësimi i nevojave dhe i dëshirave bazë përbën një të drejtë që u takon si atij ashtu edhe të tjerëve; të identifikojë, në dokumentet kryesore të të drejtave të njeriut dhe në kushtetutën shqiptare të drejtat dhe liritë themelore; të dallojë llojet kryesore të të drejtave si të drejtat personale, të drejtat civile dhe politike, të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore, të drejtat për një mjedis të shëndetshëm etj. dhe të diskutojë rreth tyre; të shpjegojë me shembuj rëndësinë që kanë të drejtat dhe realizimi i tyre për vete dhe për të tjerët; të vlerësojë, të marrë dhe të mbrojë qëndrime të caktuara lidhur me çështje që



kanë të bëjnë me fushën e veprimit dhe të kufizimit të të drejtave; të shpjegojë me fjalët e tij se të drejtat veprojnë në një fushë të caktuar dhe ato kanë kufizimet e tyre për shembull, e drejta për informacion dhe shtyp të lirë dhe e drejta e njerëzve për të patur jetën e tyre private pa ndërhyrje nga të tjerët (edhe nga shtypi) etj.; të dallojë raste të kufizimit të të drejtave në jetën e përditshme (familje, klasë etj) dhe të tregojë se të drejtat kufizohen nga nevoja për të respektuar të drejta e tij dhe të të tjerëve në emër të harmonisë shoqërore; të respektojë e të ndërmarrë veprime konkrete në mbrojtje të të drejtave të tij dhe të të tjerëve; të shqyrtojë strategjitë e hartuara për realizimin dhe fuqizimin e të mirës së përbashkët.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: a. dallon nevoja dhe dëshira bazë të individit; b. identifikon në dokumentet kryesore të të drejtave të njeriut dhe në kushtetutën shqiptare të drejtat dhe liritë themelore; c. dallon raste të kufizimit të të drejtave në jetën e përditshme; d. flet për rëndësinë e plotësimit të të drejtave të njeriut për jetën e tij; e. merr pjesë në diskutime lidhur me çështje që kanë të bëjnë me kufizimin të të drejtave;	Nxënësi: a. përshkruan lidhjen ndërmjet të drejtave të njeriut dhe nevojave bazë të tij; b. bën dallimin ndërmjet kategorive të ndryshme të të drejtave të njeriut; c. përshkruan, me shembuj, kufizimin e të drejtave në jetën e përditshme; d. përshkruan rëndësinë që kanë të drejta të caktuara për jetën e individit; e. mban qëndrim të caktuar lidhur me çështje që kanë të bëjnë me fushën e veprimit dhe të kufizimit të të drejtave;	Nxënësi: a. klasifikon nevojat dhe dëshirat bazë të qenies njerëzore dhe shpjegon pse plotësimi i nevojave i tyre përbën një të drejtë njerëzore; b. grupon llojet kryesore të të drejtave në kategori të ndryshme; c. shpjegon se të drejtat veprojnë në një fushë të caktuar dhe ato kanë kufizimet e tyre; d. argumenton se të drejtat kufizohen nga nevoja për të respektuar të drejtat e të tjerëve; e. shpjegon, me shembuj, rëndësinë që kanë të drejtat dhe realizimi i tyre për vete dhe për të tjerët;



f. mbështet veprimet konkrete në mbrojtje të të drejtave të tij dhe të të tjerëve.	f. merr pjesë në veprime konkrete në mbrojtje të të drejtave të tij dhe të të tjerëve.	f. respekton dhe ndërmerr veprime konkrete në mbrojtje të të drejtave të tij dhe të të tjerëve.
---	---	--

7.2 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “HISTORI”

SHKALLA III
Kompetenca I: Kërkimi historik dhe analiza shkak-pasojë
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi përcakton dhe kryen kërkim për një ngjarje/çështje të caktuar historike nga historia e qytetërimeve botërore dhe historia e vendit të tij për periudhën antike, mesjetare dhe moderne. Ai shtron pyetje për të shkuarën dhe shqyrton një sërë burimesh historike dhe informacioni, si bazë për t’iu përgjigjur këtyre pyetjeve dhe për të ndërtuar ngjarjen/çështjen historike. Harton dhe përmirëson pyetje për të strukturuar një shqyrtim për zhvillimin e hipotezave, për përzgjedhjen dhe dhënien e fakteve për të nxjerrë dhe për të justifikuar konkluzionet e tij për ngjarjen/çështjen/figurën historike për të cilën zhvillohet kërkimi historik. Nxënësi nëpërmjet kërkimit për të kaluarën dhe trashëgimisë së saj zhvillon dhe ndërtton konceptet historike që lidhen me kohën dhe kronologjinë, vazhdimësinë dhe ndryshimin në marrëdhëniet shoqërore, vijimësinë e ngjarjeve në të kaluarën dhe lidhjen e tyre shkak-pasojë, rolin e tyre në perspektivat e së ardhmes, nëpërmjet kuptimit të historisë së qytetërimeve botërore në periudhën antike, mesjetare dhe moderne si dhe lidhjen dhe ndikimin këtyre qytetërimeve në qytetërimin shqiptar për periudhën e mësipërme historike. Ai vendos ngjarjet, njerëzit dhe ndryshimet në periudhën e saktë kohore duke bërë lidhjet ndërmjet ngjarjeve kryesore, situatave dhe ndryshimeve për një periudhë të caktuar historike dhe për periudha të ndryshme të shoqërisë. Vlerëson shumëllojshmërinë kulturore, etnike dhe fetare, përcakton marrëdhëniet shkak-pasojë, rëndësinë dhe perspektivat për ngjarjen/çështjen historike dhe kupton se kultura e vendit të tij dhe kulturat e tjera janë pjesë e një procesi historik.



Nxënësi analizon ngjarjet historike në lidhjet e tyre shkak-pasojë dhe shpjegon pasojat në përfundimin e ngjarjeve, të situatave dhe të ndryshimeve historike.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi : ✓ formulon një numër pyetjesh, i bazuar vetëm në një aspekt të ngjarjes/çështjes historike të historisë së qytetërimeve në antikitet, në mesjetë dhe në periudhën moderne, duke iu referuar ndonjë burimi të përcaktuar historik për t'iu përgjigjur pyetjeve për atë aspekt të ngjarjes; ✓ identifikon lidhjet shkak-pasojë për periudhën historike në të cilën zhvillohet ngjarja; ✓ identifikon ndonjë prej koncepteve që lidhen me kohën dhe kronologjinë, shumëllojshmërinë kulturore, etnike dhe fetare, ndryshimin dhe vazhdimësinë, marrëdhëniet shkak-pasojë, ndërveprimin dhe rëndësinë e tyre historike; ✓ përdor ndonjë prej koncepteve historike që janë pak a shumë të rëndësishme në lidhje me çështjen të	Nxënësi : ✓ formulon një numër të caktuar pyetjesh për të identifikuar aspektet thelbësore, të historisë së qytetërimeve në antikitet, në mesjetë dhe në periudhën moderne për një ngjarje apo çështje historike duke përdorur burime të përcaktuara historike për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve; ✓ përdor për ndërtimin e ngjarjes historike , që zhvillohet, kërkimin e disa prej koncepteve historike si: koha dhe kronologjia, shumëllojshmëria kulturore, etnike dhe fetare, ndryshimi dhe vazhdimësia dhe rëndësia historike; ✓ jep shpjegime të përgjithshme për zhvillimin e ngjarjes apo çështjes historike dhe përcakton rrethanat në të cilat ka ndodhur ngjarja duke	Nxënësi : ✓ kërkon, shtron dhe drejton pyetje për çështje/ngjarje/figura historike, historinë e qytetërimeve në antikitet, në mesjetë dhe në periudhën moderne duke përdorur burimet historike; ✓ përdor drejt dhe saktë për ndërtimin e ngjarjes historike që zhvillohet, kërkimin, konceptet historike si: koha dhe kronologjia, shumëllojshmëria kulturore, etnike dhe fetare, ndryshimi dhe vazhdimësia dhe rëndësia historike; ✓ përcakton saktë ngjarjet historike në lidhjet e tyre shkak-pasojë duke treguar lidhjet ndërmjet ngjarjeve, situatave dhe ndryshimeve kryesore, për periudhën antike, mesjetare dhe moderne; ✓ përdor me lehtësi në mënyrën e duhur konceptet që lidhen me ngjarjen/çështjen apo figurën historike



marrë në shqyrtim për periudhën antike, mesjetare dhe moderne.	dalluar marrëdhëniet shkak-pasojë; ✓ përdor disa prej koncepteve që lidhen me ngjarjen/çështjen apo figurën historike të marrë në shqyrtim për periudhën antike, mesjetare dhe moderne.	në shqyrtim për periudhën antike, mesjetare dhe moderne.
Kompetenca II: Përdorimi i burimeve dhe interpretimi historik		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi identifikon dhe shqyrton burimet historike dhe burimet e informacionit që përdor për kërkim. Vlerëson burimet për vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre. Nxënësi përdor burime të sakta historike për të kuptuar lidhjet e brendshme e të jashtme midis ngjarjeve, periudhave dhe shoqërive të ndryshme, marrëdhëniet shkak-pasojë, si dhe lidhjet e qytetërimit të popullit shqiptar me qytetërimet botërore, duke shpjeguar se qytetërimet e sotme janë një vazhdimësi progresive e qytetërimeve të hershme, pra e sotmja e ka burimin tek e kaluara dhe është e lidhur me të. Vlerëson burimet e përdorura për të arritur përfundime të arsyetuara dhe logjike. Analizon dhe vlerëson në mënyrë kritike interpretimet për ngjarje apo dukuri të ndryshme historike, shpjegon se si dhe pse ngjarjet historike janë interpretuar në mënyra të ndryshme dhe vlerëson rëndësinë e ngjarjeve, të njerëzve dhe të zhvillimeve në kontekstin e tyre historik dhe në ditët e sotme. Shqyrton një sërë interpretimesh të së kaluarës për të vlerësuar vlefshmërinë e tyre. Nxënësi nëpërmjet përdorimit të burimeve dhe interpretimit të ngjarjeve në të kaluarën dhe sot zhvillon dhe ndërton konceptet historike që lidhen me kohën dhe kronologjinë, vazhdimësinë dhe ndryshimin në marrëdhëniet shoqërore, vijimësinë e ngjarjeve në të kaluarën dhe lidhjen e tyre shkak-pasojë, rolin e tyre në perspektivat e së ardhmes, nëpërmjet kuptimit të historisë së qytetërimeve botërore në periudhën antike, mesjetare dhe moderne si dhe lidhjen dhe ndikimin këtyre qytetërimeve në qytetërimin shqiptar për periudhën e mësipërme historike.		



NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ përzgjedh pak informacion për problemin që do të interpretohet; ✓ përdor disa burime informacionesh të diskutueshme; ✓ i referohet ndonjë prej burimeve historike të përcaktuara për t'iu përgjigjur dhe për të interpretuar ndonjë pyetje për ngjarje të caktuara nga historia e qytetërimeve në periudhën antike, mesjetare dhe në periudhën moderne.	Nxënësi: ✓ identifikon në burime të ndryshme informacionin e nevojshëm për një ngjarje apo çështje historike; ✓ përcakton aspektet më të rëndësishëm për informacionin që do të interpretohet; ✓ përdor burime të përcaktuara historike për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe për të shpjeguar dhe interpretuar një ngjarje të caktuar nga historia e qytetërimeve në periudhën antike, mesjetare dhe në periudhën moderne.	Nxënësi: ✓ identifikon informacionin e rëndësishëm në burime të ndryshme, përveç atyre të ofruara nga mësuesi; ✓ vlerëson burimet për vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre; ✓ shqyrton dhe përdor një sërë burimesh historike për t'iu përgjigjur pyetjeve, për të ndërtuar, analizuar dhe interpretuar një ngjarje të caktuar nga historia e qytetërimeve në periudhën antike, mesjetare dhe në periudhën moderne.
Kompetenca III: Shpjegimi dhe komunikimi për të kaluarën		
Përshkrimi i kompetencës: Komunikon njohuritë historike në mënyra të ndryshme (me shkrim, me gojë, TIK) përmes përdorimit të burimeve të ndryshme historike, duke përdorur fjalorin e përshtatshëm dhe të saktë historik. Mbledh informacion për një çështje të caktuar historike dhe e prezanton atë në mënyra alternative para grupit. Nxënësi , nëpërmjet shpjegimit dhe prezantimit të ngjarjeve në të kaluarën dhe sot, zhvillon dhe ndërton konceptet historike që lidhen me kohën dhe kronologjinë, vazhdimësinë dhe ndryshimin në marrëdhëniet shoqërore, vijimësinë e ngjarjeve në të kaluarën dhe		



lidhjen e tyre shkak-pasojë, rolin e tyre në perspektivat e së ardhmes, nëpërmjet kuptimit të historisë së qytetërimeve botërore në periudhën antike, mesjetare dhe moderne si dhe lidhjen dhe ndikimin këtyre qytetërimeve në qytetërimin shqiptar për periudhën e mësipërme historike.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ përdor gjuhën dhe terminologjinë e përshtatshme në lidhje me çështjet apo ngjarjen historike që trajtohet; ✓ përzgjedh mjete të përshtatshme për të vendosur të dhënat në tabela, diagrame dhe grafikë; ✓ përdor me vështirësi hartat dhe burimet historike për prezantimin e informacionit; ✓ prezanton një ngjarje të caktuar nga historia e qytetërimeve në periudhën antike, mesjetare dhe në periudhën moderne në mënyrë të ç'organizuar.	Nxënësi: ✓ organizon me ndihmë informacionin në tabela, diagrame, tabela; ✓ përdor materiale referuese (p.sh., enciklopedi, fjalorë) në kërkimin e tij; ✓ prezanton një ngjarje të caktuar nga historia e qytetërimeve në periudhën antike, mesjetare dhe në periudhën moderne në mënyrë koherente duke përdorur disa prej koncepteve dhe simboleve historike të mësuara.	Nxënësi: ✓ organizon informacionin historik duke përdorur mjetet e përshtatshme (p.sh., grafikë, tabela, diagrame); ✓ fokusohet në informacionin më të rëndësishëm të mbledhur dhe e riformulon atë për adresimin e problemit; ✓ prezanton saktë një ngjarje të caktuar nga historia e qytetërimeve në periudhën antike, mesjetare dhe në periudhën moderne përmes përdorimit të burimeve dhe duke përdorur me lehtësi fjalorin e përshtatshëm historik.



SHKALLA IV

Kompetenca I: Kërkimi historik dhe analiza shkak-pasojë

Përshkrimi i kompetencës:

Nxënësi përcakton dhe kryen kërkim për një ngjarje/çështje të caktuar historike nga historia e shqiptarëve dhe historia e qytetërimeve botërore. Ai shtron pyetje për të shkuarën dhe shqyrton një sërë burimesh historike dhe informacioni, si bazë për t'iu përgjigjur këtyre pyetjeve dhe për të ndërtuar ngjarjen/çështjen historike. Harton dhe përmirëson pyetje për të strukturuar një shqyrtim për zhvillimin e hipotezave, për përzgjedhjen dhe dhënien e fakteve për të nxjerrë dhe për të justifikuar konkluzionet e tij për ngjarjen/çështjen/figurën historike për të cilën zhvillohet kërkimi historik.

Nxënësi nëpërmjet kërkimit për të kaluarën dhe trashëgimisë së saj zhvillon dhe ndërton konceptet historike që lidhen me kohën dhe kronologjinë, vazhdimësinë dhe ndryshimin në marrëdhëniet shoqërore, vijimësinë e ngjarjeve në të kaluarën dhe lidhjen e tyre shkak-pasojë, rolin e tyre në perspektivat e së ardhmes, nëpërmjet kuptimit të historisë së qytetërimeve botërore në periudhën bashkëkohore dhe historisë së shqiptarëve përgjatë gjithë periudhave historike.

Nxënësi analizon ngjarjet historike në lidhjet e tyre shkak-pasojë dhe shpjegon pasojat në përfundimin e ngjarjeve, të situatave dhe të ndryshimeve historike. Ai vlerëson rëndësinë e ngjarjeve, të njerëzve dhe të zhvillimeve historike që u përkasin periudhave të ndryshme kohore në kontekstin e tyre historik dhe në ditët e sotme.

Ai analizon ndikimin e qytetërimeve botërore në qytetërimin shqiptar dhe anasjelltas, vlerëson shumëllojshmërinë kulturore, etnike dhe fetare, përcakton marrëdhëniet shkak-pasojë, rëndësinë dhe perspektivat për ngjarjen/çështjen historike dhe kupton se kultura e vendit të tij dhe kulturat e tjera janë pjesë e një procesi historik.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi : ✓ zhvillon kërkim dhe formulon pyetje që adresojnë vetëm një aspekt të	Nxënësi : ✓ zhvillon kërkimin për një ngjarje/çështje/ figurë të përcaktuar historike	Nxënësi : ✓ kërkon, shtron dhe drejton pyetje për çështje/ngjarje/figura historike, të



ngjarjes/çështjes apo figurës historike nga historia e vendit të tij ose historia e qytetërimeve botërore për periudha të ndryshme historike, duke iu referuar një burimi të përcaktuar historik për t'iu përgjigjur pyetjeve për aspektin e ngjarjes për të cilin zhvillon kërkimin; ✓ identifikon ndonjë prej koncepteve që lidhen me kohën dhe kronologjinë, shumëllojshmërinë kulturore, etnike dhe fetare, ndryshimin dhe vazhdimësinë, marrëdhëniet shkak-pasojë, ndërveprimin dhe rëndësinë e tyre historike; ✓ dallon me vështirësi lidhjet shkak-pasojë për një periudhe të caktuar historike apo për periudha të ndryshme të shoqërisë në nivel kombëtar, evropian e botëror, në varësi të ngjarjes/çështjes/figurës, për të cilën zhvillohet kërkimi historik; ✓ identifikon ndonjë ndër konceptet historike që lidhen me ngjarjen/çështjen apo figurën historike për të cilën zhvillohet kërkimi; ✓ kryen detyra që nuk adresojnë problemin.	nga historia e vendit të tij ose historia e qytetërimeve botërore për periudha të ndryshme historike duke përdorur burimet historike të përcaktuara; ✓ formulon pyetje që adresojnë disa nga aspektet thelbësore të një ngjarje/çështje apo figure, duke përdorur burimet e përcaktuara historike, për t'iu përgjigjur pyetjeve për ngjarjen/çështjen/figurën historike për të cilën zhvillohet kërkimi historik; ✓ përdor disa prej koncepteve që lidhen me kohën dhe kronologjinë, shumëllojshmërinë kulturore, etnike dhe fetare, ndryshimin dhe vazhdimësinë, marrëdhëniet shkak-pasojë, ndërveprimin dhe rëndësinë e tyre historike; ✓ identifikon disa ndër lidhjet shkak-pasojë për një periudhe të caktuar historike apo për periudha të ndryshme të shoqërisë në nivel kombëtar, evropian e botëror, në varësi të ngjarjes/çështjes/ figurës, për të cilën zhvillohet kërkimi historik;	historisë së vendit të tij ose historisë së qytetërimeve botërore për periudha të ndryshme historike duke përdorur burimet historike; ✓ përdor drejt dhe saktë për ndërtimin e ngjarjes historike që zhvillohet kërkimi, konceptet historike si: koha dhe kronologjia, shumëllojshmëria kulturore, etnike dhe fetare, ndryshimi dhe vazhdimësia dhe rëndësia historike; ✓ përcakton saktë ngjarjet historike në lidhjet e tyre shkak-pasojë duke treguar lidhjet ndërmjet ngjarjeve, situatave dhe ndryshimeve kryesore, si dhe lidhjet e qytetërimit të popullit shqiptar me qytetërimet botërore, për një periudhe të caktuar historike apo për periudha të ndryshme të shoqërisë, në varësi të ngjarjes/çështjes/figurës, për të cilën zhvillohet kërkimi historik; ✓ përdor me lehtësi në mënyrën e duhur konceptet që lidhen me ngjarjen/çështjen apo figurën historike në shqyrtim për periudhën antike, mesjetare dhe moderne.
---	---	--



	✓ përdor disa prej koncepteve kryesore që lidhen me ngjarjen çështjen apo figurën historike të marrë në shqyrtim.	
Kompetenca II : Përdorimi i burimeve dhe interpretimi historik		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi identifikon dhe shqyrton burimet historike dhe burimet e informacionit që përdor për interpretimin e qytetërimeve botërore në periudhën bashkëkohore dhe për interpretimin e historisë së shqiptarëve përgjatë gjithë periudhave historike, vlerëson ato për vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre. Nxënësi përdor burime të sakta historike për të kuptuar lidhjet e brendshme e të jashtme midis ngjarjeve, periudhave dhe shoqërive të ndryshme, marrëdhëniet shkak-pasojë, si dhe lidhjet e qytetërimit të popullit shqiptar me qytetërimet botërore, duke shpjeguar se qytetërimet e sotme janë një vazhdimësi progresive e qytetërimeve të hershme, pra e sotmja e ka burimin tek e kaluara dhe është e lidhur me të. Vlerëson burimet e përdorura për të arritur përfundime të arsyetuara dhe logjike. Analizon dhe vlerëson në mënyrë kritike interpretimet për ngjarje apo dukuri të ndryshme historike, shpjegon se si dhe pse ngjarjet historike janë interpretuar në mënyra të ndryshme dhe vlerëson rëndësinë e ngjarjeve, të njerëzve dhe të zhvillimeve në kontekstin e tyre historik dhe në ditët e sotme. Shqyrton një sërë interpretimesh të së kaluarës për të vlerësuar vlefshmërinë e tyre. Kupton se njerëzit dhe shoqëritë e përfshira në të njëjtën ngjarje historike që i përket periudhës antike mesjetare, moderne dhe bashkëkohore mund të kenë përvoja dhe pikëpamje të ndryshme për të njëjtën ngjarje historike. Nxënësi , nëpërmjet përdorimit të burimeve dhe interpretimit të ngjarjeve dhe shoqërive në të kaluarën dhe sot , zhvillon dhe ndërton konceptet historike që lidhen me kohën dhe kronologjinë, vazhdimësinë dhe ndryshimin në marrëdhëniet shoqërore, vijimësinë e ngjarjeve në të kaluarën dhe lidhjen e tyre shkak-pasojë, rolin e tyre në perspektivat e së ardhmes, nëpërmjet kuptimit të historisë së qytetërimeve botërore në periudhën bashkëkohore dhe historisë së shqiptarëve përgjatë gjithë periudhave historike si dhe ndikimin e qytetërimeve botërore në qytetërimin shqiptar dhe anasjelltas.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV



Nxënësi: ✓ përdor me vështirësi ndonjë prej informacioneve historike për të interpretuar me ndihmën e mësuesit ngjarjet që kanë të bëjnë me historinë e shqiptarëve përgjatë gjithë periudhave të historisë dhe historinë e qytetërimeve botërore në periudhën bashkëkohore; ✓ i referohet ndonjë burimi historik të përcaktuar për t'iu përgjigjur dhe për të interpretuar ndonjë pyetje për ngjarje të caktuara nga historia e vendit të tij ose historia e qytetërimeve botërore për periudha të ndryshme historike.	Nxënësi: ✓ përdor disa prej informacioneve historike për interpretimin e ngjarjeve që kanë të bëjnë me historinë e shqiptarëve përgjatë gjithë periudhave të historisë dhe historinë e qytetërimeve botërore në periudhën bashkëkohore duke shfrytëzuar disa prej burimeve parësore dhe dytësore; ✓ përdor burimet e informacionit që mund të ndryshojnë në besueshmërinë e tyre; ✓ përdor burimet e përcaktuara historike, për t'iu përgjigjur pyetjeve dhe për të interpretuar konkluzionet për një ngjarje të caktuar nga historia e vendit të tij ose historia e qytetërimeve botërore për periudha të ndryshme historike.	Nxënësi: ✓ përdor me saktësi informacionin historik për interpretimin e ngjarjeve që kanë të bëjnë me historinë e shqiptarëve për gjatë gjithë periudhave të historisë dhe historinë e qytetërimeve botërore në periudhën bashkëkohore duke shfrytëzuar burimet parësore dhe dytësore; ✓ vlerëson burimet për vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre në interpretimin e ngjarjeve, situatave, çështje dhe figurave të ndryshme historike; ✓ vlerëson, përdor dhe shfrytëzon një sërë hartash dhe burimesh historike për t'iu përgjigjur pyetjeve, për të strukturuar një shqyrtim, për të zhvilluar hipoteza, për të përzgjedhur faktet, si dhe për të nxjerrë dhe për të interpretuar konkluzionet e tij për një ngjarje të caktuar nga historia e vendit të tij ose historia e qytetërimeve botërore për periudha të ndryshme historike.
--	---	--



Kompetenca III : Shpjegimi dhe komunikimi për të kaluarën		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi shpjegon ndryshimin dhe vazhdimësinë e ngjarjeve për historinë e shqiptarëve brenda dhe përtej periudhave historike (parahistorike, antike, mesjetare, moderne, bashkëkohore) dhe për historinë e qytetërimeve botërore në periudhën bashkëkohore. Ai shpjegon lidhjet e qytetërimit të popullit shqiptar me qytetërimet botërore. Prezanton ritmin e ndryshimit, nëse ndryshimi arriti në progres dhe nëse po, për kë për ngjarje historike, kupton dhe ndërgjegjësohet për veçoritë e prirjeve historike sipas periudhave (antike, mesjetare, moderne, bashkëkohore), të cilat sollën progresin e shoqërisë në shkallë kombëtare, evropiane dhe botërore. Nxënësi nëpërmjet shpjegimit dhe prezantimit të ngjarjeve dhe shoqërive në të kaluarën dhe sot zhvillon dhe ndërton konceptet historike që lidhen me kohën dhe kronologjinë, vazhdimësinë dhe ndryshimin në marrëdhëniet shoqërore, vijimësinë e ngjarjeve në të kaluarën dhe lidhjen e tyre shkak-pasojë, rolin e tyre në perspektivat e së ardhmes, nëpërmjet kuptimit të historisë së qytetërimeve botërore në periudhën bashkëkohore dhe historisë së shqiptarëve përgjatë gjithë periudhave historike si dhe ndikimin qytetërimeve botërore në qytetërimin shqiptar dhe anasjelltas.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ prezanton informacionin në mënyrë të ç'organizuar për pyetje të drejtuara nga mësuesja lidhur me ngjarjeve të caktuara nga historia e vendit të tij ose historia e qytetërimeve botërore për periudha të ndryshme historike;	Nxënësi: ✓ prezanton me ndihmë informacionin përmes përdorimit të burimeve të përcaktuara dhe duke përdorur fjalorin historik për shpjegimin e ngjarjeve të caktuar nga historia e vendit të tij ose historia e qytetërimeve botërore për	Nxënësi: ✓ prezanton informacionin përmes përdorimit të burimeve dhe duke përdorur me lehtësi fjalorin e përshtatshëm historik për argumentimin e ngjarjeve të caktuar nga historia e vendit të tij ose historia e qytetërimeve botërore



✓ përzgjedh me vështirësi pak informacion që është i rëndësishëm për çështjen apo ngjarjen historike për të cilën zhvillohet kërkimi; ✓ përdor rrallë terminologjinë dhe simbolet historike të mësuara; ✓ përdor me vështirësi hartat dhe burimet historike për prezantimin e informacionit.	- periudha të ndryshme historike; ✓ organizon dhe përshtat informacionin për audiencën; ✓ organizon me ndihmë informacionin në tabela, diagrame; ✓ zgjedh dhe përdor mjete të pranueshme të prezantimit për të shfaqur të dhënat; ✓ përdor me ndihmë burimet dhe hartat historike për prezantimin e informacionit; ✓ përdor në disa raste terminologjinë dhe simbolet historike të mësuara.	- për periudha të ndryshme historike; ✓ përzgjedh dhe përdor mjete të përshtatshme për prezantim; ✓ përdor gjuhën e përditshme për ta bërë mesazhin e tij/saj më të lehtë për t'u kuptuar dhe interpretuar; ✓ përzgjedh mjetet e duhura për t'i vendosur të dhënat në tabela, diagrame dhe grafikë; ✓ parashtron pyetje që nxisin debat për temën/çështjen e dhënë dhe u jep përgjigje pyetjeve të bëra nga të tjerët përmes formave të ndryshme të komunikimit.
---	---	--

7.3 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “GJEOGRAFI”

SHKALLA III		
Kompetenca I : Hetimi i dukurive gjeografike		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi identifikon një çështje gjeografike dhe heton për të. Zhvillon dhe vlerëson çështjen duke përdorur konceptet që lidhen me vendin, rajonin, mjedisin, ndërveprimin. Nxënësi përcakton marrëdhëniet shkak-pasojë të dukurive gjeografike që ndodhin në sistemet natyrore të Tokës, hulumton ndërveprimin ndërmjet mjediseve fizike dhe humane, në nivel lokal, kombëtar, rajonal e botëror.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV



Nxënësi: ✓ identifikon disa ndër konceptet shkencore që lidhen me çështjen apo dukurinë gjeografike për të cilën zhvillohet kërkimi; ✓ përdor një shkallë të vetme të analizës së dukurisë apo çështjes gjeografike (lokale/rajonale/kombëtare/ndërkombëtare); ✓ dallon karakteristikat e përgjithshme fiziko-gjeografike të vendlindjes dhe rajoneve të Shqipërisë; ✓ identifikon disa ndër marrëdhëniet shkak-pasojë të dukurive gjeografike që ndodhin në sistemet e Tokës; ✓ përshekruan ndërveprimin e veprimtarisë njëezore në mjedisin gjeografik dhe anasjelltas; ✓ kryen detyra që nuk adresojnë problemin.	Nxënësi: ✓ identifikon dhe përdor disa prej koncepteve që lidhen me çështjen apo dukurinë gjeografike të marrë në hetim, në situata mësimore; ✓ përdor më shumë se një shkallë të analizës për të trajtuar problemin (lokale/rajonale/kombëtare/ndërkombëtare); ✓ shpjegon karakteristikat e përgjithshme fiziko-gjeografike të vendlindjes dhe rajoneve të Shqipërisë; ✓ përshekruan disa ndër marrëdhëniet shkak-pasojë të dukurive gjeografike që ndodhin në sistemet e Tokës; ✓ identifikon pasoja të ndërveprimit të veprimtarisë njëezore në mjedisin gjeografik dhe anasjelltas, duke përdorur shembuj të gatshëm; ✓ kryen detyra që pjesërisht e adresojnë problemin.	Nxënësi: ✓ identifikon dhe përdor konceptet që lidhen me çështjen apo dukurinë gjeografike të marrë në hetim, në situata mësimore dhe të jetës së përditshme; ✓ përdor shkallë të ndryshme të analizës (lokale/rajonale/kombëtare/ndërkombëtare); ✓ analizon dhe vlerëson karakteristikat e përgjithshme fiziko-gjeografike të vendlindjes dhe rajoneve të Shqipërisë; ✓ interpretion disa ndër marrëdhëniet shkak-pasojë të dukurive gjeografike që ndodhin në sistemet e Tokës; ✓ interpretion pasojat e ndërveprimit të veprimtarisë njëezore në mjedisin gjeografik dhe anasjelltas, përmes shembujve që ai sjell; ✓ kryen detyra që e adresojnë plotësisht problemin.
---	--	---

Kompetenca II : Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit

Përshkrimi i kompetencës:

Nxënësi identifikon dhe shqyrton burimet e informacionit që përdor për kërkim. Vlerëson burimet për vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre. Mbledh, përzgjedh dhe regjistron të dhëna gjeografike, duke shfrytëzuar burimet e drejtpërdrejta parësore (intervista, statistika, etj.) dhe dytësore (grafikë, harta, ilustrime, video, CD, internet, etj.). Komunikon (me shkrim, me gojë, grafikiqst, vizualisht) shpërndarjen hapësinore të dukurive gjeografike, përmes përdorimit të hartave të shkallëve të ndryshme, duke përdorur fjalorin e përshtatshëm gjeografik.



NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ përzgjedh me vështirësi informacionin për çështjen ose dukurinë gjeografike për të cilën zhvillohet kërkimi gjeografik dhe e prezanton me vështirësi; ✓ dallon mjetet gjeografike (harta, glob, fotografi ajrore, imazhe satelitore etj), si mjete për lokalizimin e vendndodhjes së tipareve dhe dukurive fiziko-gjeografike e humane; ✓ përdor fjalor të thjeshtë gjeografik për të prezantuar gjetjet; ✓ lexon të dhënat e vendosura në tabela, diagrame, grafikë.	Nxënësi: ✓ identifikon në një burim të dhënë dhe përpunon informacionin për çështjen ose dukurinë gjeografike dhe e prezanton atë; ✓ përdor me ndihmë mjetet gjeografike (harta, globin, fotografi ajrore, imazhe satelitore etj), si mjete për lokalizimin e vendndodhjes së tipareve dhe dukurive fiziko-gjeografike e humane; ✓ përdor fjalor të përshtatshëm gjeografik për të shpjeguar gjetjet; ✓ organizon me ndihmë informacionin në tabela, grafikë, diagrame etj.	Nxënësi: ✓ identifikon në burime të ndryshme informacionin e nevojshëm për një dukuri ose çështje gjeografike dhe e interpreton atë; ✓ përdor në mënyrë të pavarur mjetet gjeografike (harta, globin, fotografi ajrore, imazhe satelitore etj), si mjete për lokalizimin e vendndodhjes së tipareve dhe dukurive fiziko-gjeografike e humane; ✓ përdor me lehtësi fjalorin gjeografik për të sugjeruar përfundime dhe prezantuar gjetjet; ✓ përzgjedh mjetet e përshtatshme dhe organizon të dhënat në tabela, grafikë, diagrame etj.
Kompetenca III: Marrja e vendimeve Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi kombinon të dhëna dhe informacionin gjeografik për të identifikuar rrugë të ndryshme të veprimit dhe për të parashikuar pasojat për to. Propozon alternativa, strategji apo zgjidhje për çështjen gjeografike dhe jep argumente për zgjedhjen e preferuar. Reflekton në mënyrë të vazhduar në çdo stad të kërimit.		
NIVELI III	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi : ✓ ndjek një plan veprimi të sugjeruar për zgjidhjen e një çështje gjeografike; ✓ identifikon disa nga hapat e ndjekur për zbatimin e planit të veprimit;	Nxënësi : ✓ përgatit një plan veprimi për zgjidhjen e një çështje gjeografike; ✓ përshkruan hapat që ndjek për realizimin e këtij plani;	Nxënësi : ✓ përgatit dhe zbaton një plan veprimi për zgjidhjen e një çështje gjeografike, duke e rishikuar në mënyrë të vazhduar;



✓ liston zgjidhje të mundshme të situatave.	✓ identifikon zgjidhje të mundshme të situatave dhe diskuton për to.	✓ propozon shpjegime ose zgjidhje të bazuara mbi rezultatet dhe, kur e shikon të nevojshme sugjeron përmirësime të procedurave; ✓ propozon dhe argumenton zgjidhje të mundshme të situatave.
--	---	---

SHKALLA IV

Kompetenca I: Hetimi i dukurive gjeografike

Përshkrimi i kompetencës:

Nxënësi përcakton dhe hulumton një çështje. Ai formulon dhe drejton pyetje për çështjen gjeografike për të cilën zhvillohet kërkimi gjeografik. Zhvillon dhe vlerëson çështjen duke përdorur konceptet që lidhen me vendin, rajonin, mjedisin, ndërveprimin. Nxënësi përcakton marrëdhëniet shkak-pasojë të dukurive gjeografike, që ndodhin në sistemet natyrore të Tokës, në mjedisin lokal, hulumton ndërveprimin ndërmjet mjediseve fizike dhe humane në rajone të ndryshme, në nivel lokal, kombëtar, rajonal e botëror.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ identifikon disa ndër ngjashmëritë dhe dallimet midis karakteristikave fizike dhe humane të rajoneve ndryshme të Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare, rajoneve dhe vendeve të tjera të botës; ✓ evidenton kompleksitetin dhe ndërvarësinë midis rajoneve dhe vendeve të ndryshme;	Nxënësi: ✓ përshkruan , përmes shembujve, disa ndër ngjashmëritë dhe dallimet midis karakteristikave fizike dhe humane të rajoneve ndryshme të Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare, rajoneve dhe vendeve të tjera të botës; ✓ përshkruan kompleksitetin dhe ndërvarësinë midis rajoneve dhe vendeve të ndryshme;	Nxënësi: ✓ analizon , duke evidentuar shkaqet, ngjashmëritë dhe dallimet midis karakteristikave fizike dhe humane të rajoneve ndryshme të Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare, rajoneve dhe vendeve të tjera të botës; ✓ vlerëson kompleksitetin dhe ndërvarësinë midis rajoneve dhe vendeve të ndryshme;



✓ formulon pyetje që adresojnë vetëm një aspekt të një çështje apo dukurie gjeografike; ✓ përdor një shkallë të vetme të analizës së dukurisë apo çështjes gjeografike (lokale/rajonale/kombëtare/ndërkombëtare) ; ✓ kryen detyra që nuk adresojnë problemin.	✓ formulon pyetje që adresojnë disa nga aspektet thelbësore të një çështje apo dukurie gjeografike; ✓ përdor më shumë se një shkallë të analizës për të trajtuar problemin (lokale/rajonale/kombëtare/ndërkombëtare) ; ✓ kryen detyra që pjesërisht e adresojnë problemin.	✓ formulon pyetje që adresojnë aspektet thelbësore të një çështje apo dukurie gjeografike; ✓ përdor shkallë të ndryshme të analizës (lokale/rajonale/kombëtare/ndërkombëtare) ; ✓ kryen detyra që e adresojnë plotësisht problemin.
---	---	--

Kompetenca II : Mbledhja, vlerësimi dhe komunikimi i informacionit

Përshkrimi i kompetencës:

Nxënësi ndërton njohuri për rajonet dhe veçoritë e tyre, ndërvarësinë, bashkëveprimin midis tyre, në nivel kombëtar, rajonal e global, duke përdorur mjetet dhe shkathtësitë gjeografike, si hartat, vëzhgimet në terren fotografi, etj. Vlerëson burimet për vlefshmërinë dhe besueshmërinë e tyre, mbledh të dhëna dhe komunikon (me shkrim, me gojë, grafikisht, vizualisht) shpërndarjen hapësinore të dukurive gjeografike, përmes përdorimit të hartave të shkallëve të ndryshme, duke përdorur fjalorin e përshtatshëm gjeografik.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ identifikon informacionin për çështjen apo dukurinë gjeografike për të cilën zhvillohet kërkimi; ✓ organizon me vështirësi informacionin e gjetur; ✓ përdor me vështirësi hartat dhe mjete të tjera gjeografike për prezantimin e informacionit; ✓ lexon grafikë, diagrame, tabela etj., që lidhen me studimin gjeografik të	Nxënësi: ✓ hulumton dhe përzgjedh informacionin më të rëndësishëm për çështjen apo dukuritë gjeografike për të cilat zhvillohet kërkimi; ✓ organizon informacionin dhe e përshtat atë për audiencën; ✓ përdor mjetet gjeografike si harta, atlase, globin, foto ajrore etj., për prezantimin e informacionit; ✓ organizon të dhëna që lidhen me studimin gjeografik të rajoneve të ndryshme të botës,	Nxënësi: ✓ identifikon, përzgjedh nga burime të ndryshme dhe përdor informacionin më të rëndësishëm në përmbushje të çështjes gjeografike, dhe e përpunon atë; ✓ organizon informacionin, e përshtat atë për audiencën e synuar dhe e përcjell qartë; ✓ përzgjedh dhe përdor harta dhe mjete të përshtatshme gjeografike për hulumtimin e informacionit; ✓ organizon dhe interpreton të dhëna që



rajoneve të ndryshme të botës, Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare; ✓ përdor fjalor të thjeshtë gjeografik.	Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare në grafikë, diagrame, tabela etj., dhe i prezanton duke përdorur në disa raste TIK-un; ✓ përdor fjalorin e përshtatshëm gjeografik.	lidhen me studimin gjeografik të rajoneve të ndryshme të botës, Shqipërisë dhe trevave të tjera shqiptare në grafikë, diagrame, tabela etj., duke përdorur TIK-un; ✓ përdor në analiza dhe interpretime fjalorin dhe terminologjinë gjeografike.
Kompetenca III : Marrja e vendimeve		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi kombinon të dhëna dhe informacion për të nxjerrë konkluzione, duke marrë në konsideratë impaktin e tyre. Identifikon rrugë të ndryshme të veprimit dhe parashikon pasojat për to. Propozon alternativa, strategji apo zgjidhje për çështjen gjeografike dhe jep argumente për zgjedhjen e preferuar. Përdor pyetje për të reflektuar në çdo stad të kërkimit “Çfarë funksionoi?”, “Si mund të përmirësohet?”.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ bën supozime që lidhen pak a shumë me problemin që do të zgjidhet; ✓ identifikon një hipotezë që lidhet me çështjen gjeografike; ✓ zbaton një plan veprimi; ✓ përshkruan disa nga hapat e kryer ose disa aspekte të zgjidhjes; ✓ paraqet rezultatet dhe propozon përgjigje ose zgjidhje pa kontrolluar nëse ato janë të lidhura me rezultatet apo problemin.	Nxënësi: ✓ identifikon elementë të problemit që duhet zgjidhur ose kërkesat që duhet të plotësohen; ✓ formulon hipoteza apo zgjidhje të mundshme që marrin në konsideratë disa nga kufizimet që lidhen me këtë problem; ✓ përgatit një plan veprimi dhe e zbaton atë; ✓ propozon përgjigje apo zgjidhje që në përgjithësi pasqyrojnë rezultatet ose provat e tij;	Nxënësi: ✓ identifikon elementë të problemit dhe përzgjedh informacionin përkatës lidhur me një problem që duhet zgjidhur; ✓ formulon hipoteza të besueshme apo zgjidhje të realizueshme që pasqyrojnë kufizimet që lidhen me problemin dhe kushtet me të cilat duhet të zgjidhet; ✓ planifikon çdo hap në planin e tij të veprimit dhe e zbaton atë; ✓ në kryerjen e planit të tij të veprimit, mban shënim elementet e nevojshëm për të dhënë përgjigje ose zgjidhje, dhe bën ndonjë rregullim të nevojshëm;



	✓ gjykon për rezultatet apo provat pa sugjeruar ndonjë përmirësim.	✓ identifikon arsyet e suksesit dhe vështirësive të tij.
--	---	---

8 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË FUSHËN “TIK DHE TEKNOLOGJI”

8.1 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “TIK”

SHKALLA III		
Kompetenca I : Teknologjia, sistemet teknologjike dhe bota e kompjuterit		
Përshkrimi i kompetencës:		
Nxënësi analizon marrëdhëniet e teknologjisë dhe sistemeve teknologjike, ndikimin e tyre në zhvillimin e shoqërisë njerëzore dhe të mjedisit rrethues. Përdor në mënyrë të avancuar shumë medie për realizimin e detyrave, punëve praktike dhe projekteve.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ demonstroi aftësi të pjesshme në analizimin e ndikimit të teknologjisë në zhvillimin e shoqërisë njerëzore dhe të mjedisit rrethues; ✓ zbaton aftësi të pjesshme në përdorimin e metodologjive të duhura për të punuar saktë me teknologjitë; ✓ zbaton me vështirësi funksionet e avancuara të kompjuterit; ✓ demonstroi aftësi të qëndrueshme duke praktikuar TIK-un nëpërmjet krijimit të blogjeve informative dhe komunikimit online nëpërmjet multi-mediave.	Nxënësi: ✓ demonstroi aftësi të mira në analizimin e ndikimit të teknologjisë në zhvillimin e shoqërisë njerëzore dhe të mjedisit rrethues; ✓ zbaton aftësi të mira në përdorimin e metodologjive të duhura për të punuar saktë me teknologjitë; ✓ zbaton mirë funksionet e avancuara të kompjuterit; ✓ demonstroi aftësi të mira duke praktikuar TIK-un nëpërmjet krijimit të blogjeve informative dhe komunikimit online nëpërmjet multi-mediave.	Nxënësi: ✓ demonstroi aftësi dhe shprehi të avancuara në analizimin e ndikimit të teknologjisë në zhvillimin e shoqërisë njerëzore dhe të mjedisit rrethues; ✓ zbaton aftësi dhe shprehi teknologjike shumë të mira në përdorimin e metodologjive të duhura për të punuar saktë me teknologjitë; ✓ zbaton shumë mirë funksionet e avancuara të kompjuterit; ✓ demonstroi aftësi dhe shprehi të avancuara duke praktikuar TIK-un



		nëpërmjet krijimit të blogjeve informative dhe komunikimit online nëpërmjet multi-mediave; ✓ përshkruan me shprehi të avancuara ndërtimin dhe funksionimin e strukturave dhe mekanizmave të thjeshta teknologjike; ✓ shqyrton një gamë të gjerë të objekteve të jetës së përditshme; ✓ eksploron se si një game e gjerë materialesh, (varg i formave,) i objekteve dhe i strukturave të tjera mund të bëhet duke përdorur një shumëllojshmëri të materialeve me përmirësime të mundshme.
Kompetenca II : Strukturat, mekanizmat dhe materialet teknologjike		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi përshkruan ndërtimin dhe funksionimin e strukturave dhe mekanizmave të thjeshta teknologjike, si edhe përshkruan vetitë dhe përdorimet e materialeve teknologjike kryesore në sistemet teknologjike të sotme.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ familjarizohet me vështirësi në njohjen e disa web-page të thjeshta; ✓ analizon me vështirësi informacionin e dëgjuar nga burime elektronike edhe me ndihmën e të tjerëve.	Nxënësi: ✓ familjarizohet duke treguar aftësi të pjesshme në njohjen e disa ëeb-page të thjeshta; ✓ shfaq aftësi të mira në njohjen e disa ëeb-page të thjeshta;	Nxënësi: ✓ demonstroi aftësi dhe shprehi të avancuara në dallimin e materialeve teknologjike të llojeve të ndryshme; ✓ shfaq aftësi shumë të mira në përshkrimin e vetive dhe përdorimet e



	✓ analizon <i>pjesërisht</i> informacionin e dëgjuar nga burime elektronike.	materialeve teknologjike kryesore në sistemet teknologjike të sotme; ✓ realizon <i>në mënyrë origjinale</i> një produkt në mënyrë të pavarur ose në grup , për nevojat personale ose të komunitetit të zonës; ✓ demonstroi <i>aftësi dhe shprehje të avancuara</i> në përshkrimin e funksionimit e strukturave dhe mekanizmave të thjeshta teknologjike; ✓ shfaq <i>aftësi shumë të mira</i> në përdorimin e sistemeve teknologjike në mjedisin familjar.
Kompetenca III : Komunikimi grafik		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi lexon dhe interpreton skica dhe vizatime të objekteve të thjeshta teknike, si edhe përdor mënyra të thjeshta të komunikimit grafik për të prezantuar ide dhe paraqitur objekte të thjeshta teknike.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ demonstroi <i>aftësi të pjesshme</i> në përdorimin e materialeve teknologjike kryesore për realizimin e një produkti familjar; ✓ realizon <i>pjesërisht</i> objekte ose produkte të ndryshme gjatë zbatimit të skicave, të modeleve dhe teknikave artizanale, duke	Nxënësi: ✓ demonstroi <i>aftësi të mira</i> në përdorimin e materialeve teknologjike kryesore për realizimin e një produkti familjar; ✓ realizon <i>saktë</i> objekte ose produkte të ndryshme gjatë zbatimit të skicave, të modeleve dhe teknikave artizanale, duke përdorur një gamë	Nxënësi: ✓ lexon <i>shumë saktë</i> skica të objekteve të thjeshta teknike <i>në mënyrë të pavarur</i>; ✓ shfaq <i>aftësi shumë të mira</i> në vizatimin e saktë të skicave dhe objekteve të thjeshta teknike; ✓ analizon me <i>aftësi shume të mira</i> një vizatim apo skice të një objekti mekanik apo ndërtimor.



përdorur një gamë të gjerë të mjeteve të materialeve dhe veglave të punës; ✓ familjarizohet duke treguar <i>aftësi të pjesshme</i> në njohjen e disa web-page të thjeshta; ✓ analizon me <i>vështirësi</i> informacionin e dëgjuar nga burime elektronike.	të gjerë të mjeteve të materialeve dhe veglave të punës; ✓ shfaq <i>aftësi të mira</i> në njohjen e disa ëeb-page të thjeshta; ✓ analizon me ndihmën e të tjerëve informacionin e dëgjuar nga burime elektronike.	
Kompetenca IV: Teknologjia dhe veprimtaria ekonomike		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi analizon ndikimin e teknologjisë në veprimtaritë ekonomike, si edhe planifikon e realizon produkte dhe shërbime të thjeshta, me përdorimin e materialeve, veglave dhe proceseve të thjeshta teknologjike.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ shfaq <i>aftësi të pjesshme</i> për identifikimin e veprimtarisë dhe realizimin e saj në shtëpi, komunitet dhe shkollë; ✓ demonstroi <i>aftësi dhe shprehi të jo të qëndrueshme</i> në nevojën për realizimin e veprimtarive në shtëpi, komunitet dhe shkollë; ✓ organizon dhe menaxhon <i>me vështirësi</i> identifikimin dhe klasifikimin e materialeve recikluese bazike nga ekonomia familjare duke i dalluar,	Nxënësi: ✓ shfaq <i>aftësi të mira</i> për identifikimin e veprimtarisë dhe realizimin e saj në shtëpi, komunitet dhe shkollë; ✓ demonstroi <i>aftësi dhe shprehi të qëndrueshme</i> në nevojën për realizimin e veprimtarive në shtëpi, komunitet dhe shkollë; ✓ organizon dhe menaxhon <i>saktë</i> identifikimin dhe klasifikimin e materialeve recikluese bazike nga ekonomia familjare duke i dalluar,	Nxënësi: ✓ shfaq <i>aftësi shumë të mira</i> për identifikimin e veprimtarisë dhe realizimin e saj në shtëpi, komunitet dhe shkollë; ✓ demonstroi <i>aftësi dhe shprehi të avancuara</i> në nevojën për realizimin e veprimtarive në shtëpi, komunitet dhe shkollë; ✓ organizon dhe menaxhon <i>në mënyrë të pavarur</i> identifikimin dhe klasifikimin e materialeve recikluese bazike nga ekonomia familjare duke i dalluar,



krahasuar dhe renditur për përdorime të tjera; ✓ përdor dhe menaxhon me vështirësi krijimin e orendive të riciklueshme për përdorim në shkollë.	krahasuar dhe renditur për përdorime të tjera; ✓ përdor dhe menaxhon sakte krijimin e orendive të riciklueshme për përdorim në shkollë.	krahasuar dhe renditur për përdorime të tjera. ✓ përdor dhe menaxhon në mënyrë të pavarur krijimin e orendive të riciklueshme për përdorim në shkollë.
Kompetenca V: Etika dhe kushtet e sigurta në punë		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi zbaton rregullat për mbrojtje dhe siguri nga rreziqet në jetën e përditshme në shtëpi, shkollë dhe mjedisin përreth.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ analizon duke shfaqur <i>qëndrime jo të qarta për rregullat e sigurisë</i> përmes veprimeve dhe i zbaton në shtëpi, komunitet dhe shkollë; ✓ vlerëson <i>në mënyrë të pjesshme</i> rregullat për t'u mbrojtur nga interneti dhe për të punuar në mënyrë të sigurt. ✓ demonstroi <i>gjykime të pjesshme për</i> rrezikun që vjen nga përdorimi i pamasë i mjeteve elektronike.	Nxënësi: ✓ mban <i>qëndrime korrekte</i> për rregullat e sigurisë përmes veprimeve dhe i zbaton në shtëpi, komunitet dhe shkollë; ✓ vlerëson <i>në mënyrë të vazhdueshme</i> rregullat për t'u mbrojtur nga interneti dhe për të punuar në mënyrë të sigurt; ✓ mban <i>qëndrim të korrekt</i> për rrezikun që vjen nga përdorimi i pamasë i mjeteve elektronike.	Nxënësi: ✓ demonstroi shumë saktë sipas <i>rregullave të sigurta</i>, përmes veprimeve nevojën për realizimin e tyre në shtëpi, komunitet dhe shkollë; ✓ zbaton <i>shumë mirë</i> rregullat për t'u mbrojtur nga interneti dhe për të punuar në mënyrë të sigurt. ✓ vlerëson <i>shumë mirë</i> rrezikun që vjen nga përdorimi i pamasë i mjeteve elektronike.
Kompetenca VI : Analizë e thelluar e të dhënave		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi analizon dhe interpreton të dhëna statistikore nëpërmjet programeve të paketës Windows Office. Zhvillon aftësi, qëndrime dhe njohuri që do t'i nevojiten atij në jetën e përditshme, por edhe për t'u aftësuar më shumë në përdorimin e thelluar të kompjuterit dhe internetit.		



NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ zotëron <i>aftësi të pjesshme</i> për korrigjimin e tekstit nga ana ortografike duke përdorur fjalorin elektronik si dhe e formaton sipas modelit të kërkuar; ✓ menaxhon <i>me ndihmesë</i> problemet që mund të dalin gjatë punës me kompjuter.	Nxënësi: ✓ korrigjon <i>mirë</i> tekstet nga ana ortografike duke përdorur fjalorin elektronik si dhe e formatojnë sipas modelit të kërkuar; ✓ <i>menaxhon mirë</i> problemet që mund të dalin gjatë punës me kompjuter.	Nxënësi: ✓ korrigjon <i>shumë mirë</i> tekstet nga ana ortografike duke përdorur fjalorin elektronik si dhe e formatojnë sipas modelit të kërkuar; ✓ <i>menaxhon shumë saktë</i> problemet që mund të dalin gjatë punës me kompjuter.
Kompetenca VII: Motorët e kërkimit dhe mjetet mediatike		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi specifikon motorët e kërkimit dhe është në gjendje të kërkojë informacione në portale të ndryshme elektronike duke përdorur në mënyrë të saktë mjetet mediatike, si dhe funksionin dhe rolin e secilit mjet për realizimin e kërkesave.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ familjarizohet duke treguar <i>aftësi të pjesshme</i> në njohjen e disa web-page të thjeshta; ✓ analizon me <i>vështirësi</i> informacionin e dëgjuar nga burime elektronike.	Nxënësi: ✓ shfaq <i>aftësi të mira</i> në njohjen e disa web-page të thjeshta; ✓ analizon me ndihmën e të tjerëve informacionin e dëgjuar nga burime elektronike.	Nxënësi: ✓ demonstroi <i>aftësi dhe shprehje të avancuara</i> në dallimin midis ëeb-broësere të ndryshme (Internet, Explorer, Mozilla, Google Chrome). ✓ shfaq <i>aftësi shumë të mira</i> në përdorimin e mjeteve të ndryshme multimediale për të realizuar detyrat e kërkuara në projektet kurrikulare.

SHKALLA IV



Kompetenca i: Teknologjia, sistemet teknologjike dhe bota e kompjuterit		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi analizon marrëdhëniet e teknologjisë , sistemeve teknologjike dhe ndikimin e tyre në zhvillimin e shoqërisë njerëzore dhe të mjedisit rrethues. Përdor në mënyrë të avancuar shumë media për realizimin e detyrave, punëve praktike dhe projekteve.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ analizon <i>pjesërisht</i> marrëdhëniet e teknologjisë e sistemeve teknologjike (dhe mban) duke mbajtur qëndrim kritik ndaj marrëdhënies së teknologjisë me sistemet teknologjike për ndikimin e tyre në zhvillimin e shoqërisë njerëzore dhe të mjedisit rrethues; ✓ demonstroi <i>aftësi të pjesshme</i> në përdorimin e mjeteve, mënyrave, tools-ve, (përmbajtje specifike,) softëare dhe stimulimet për të mbështetur të nxënit e tij dhe kërkimin e informacionit; ✓ demonstroi <i>aftësi të qëndrueshme</i> për menaxhimin e antivirusëve , skanimin e file-ve të ndryshme, dhe i instaloi antivirusin në kompjuter; ✓ demonstroi <i>aftësi dhe shprehje të pjesshme</i> në përdorimin e materialeve teknologjike kryesore	Nxënësi: ✓ analizon <i>saktë</i> marrëdhëniet e teknologjisë me sistemet teknologjike dhe mban qëndrim kritik ndaj marrëdhënies së teknologjisë me sistemet teknologjike për ndikimin e tyre në zhvillimin e shoqërisë njerëzore dhe të mjedisit rrethues; ✓ demonstroi <i>aftësi dhe shprehje të mira</i> në përdorimin e mjeteve, përmbajtje specifike, softëare dhe stimulimet për të mbështetur të nxënit e tij dhe kërkimin e informacionit; ✓ organizoi dhe menaxhoi antiviruset dhe i instaloi në mënyrë të pavarur antivirusin në kompjuter si dhe shkarkoi të tjerë për t'i përditësuar; ✓ demonstroi <i>aftësi të mira</i> në përdorimin e materialeve	Nxënësi: ✓ analizon <i>shumë saktë</i> marrëdhëniet e teknologjisë me sistemet teknologjike dhe mban qëndrim kritik ndaj marrëdhënies së teknologjisë me sistemet teknologjike për ndikimin e tyre në zhvillimin e shoqërisë njerëzore dhe të mjedisit rrethues; ✓ demonstroi <i>aftësi dhe shprehje të avancuara</i> në përdorimin e mjeteve, përmbajtje specifike, softëare dhe stimulimet për të mbështetur të nxënit e tij dhe kërkimin e informacionit; ✓ organizoi dhe menaxhoi antiviruset dhe i instaloi në mënyrë të pavarur antivirusin në kompjuter duke ç'instaluar programe nga Software dhe shkarkoi të tjerë për t'i përditësuar;



Kompetenca II : Strukturat, mekanizmat dhe materialet teknologjike Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi përshkruan ndërtimin dhe funksionimin e strukturave dhe mekanizmave të thjeshta teknologjike, si edhe përshkruan vetitë dhe përdorimet e materialeve teknologjike kryesore në sistemet teknologjike të sotme.

Faqe**125** nga **154**



materialeve me përmirësime të mundshme.	shumëllojshmëri të materialeve me përmirësime të mundshme.	gamë të gjerë të mjeteve të materialeve dhe veglave të punës; ✓ përshkruan <i>shumë mirë</i> ndërtimin dhe funksionimin e strukturave dhe mekanizmave të thjeshta teknologjike; ✓ shqyrton <i>në mënyrë të pavarur</i> një gamë të gjerë të objekteve të jetës së përditshme; ✓ eksploron <i>në mënyrë të pavarur</i> se si një varg i formave, i objekteve dhe i strukturave të tjera mund të bëhet duke përdorur një shumëllojshmëri të materialeve me përmirësime të mundshme.
--	---	--

Kompetenca III : Komunikimi grafik

Përshkrimi i kompetencës:

Nxënësi lexon dhe interpreton skica dhe vizatime të objekteve të thjeshta teknike, si edhe përdor mënyra të thjeshta të komunikimit grafik për të prezantuar ide dhe paraqitur objekte të thjeshta teknike.

NIVELI 2	NIVELI 3	NIVELI 4
Nxënësi: ✓ shfaq <i>aftësi të pjesshme</i> në websitet e sigurta në të cilat kërkohen të dhëna konkrete për regjistrimin personal; ✓ demonstroi <i>vështirësi</i> për menaxhimin e të dhënave në kompjuter duke i kushtuar	Nxënësi: ✓ shfaq <i>aftësi të mira</i> në të dhëna të sigurta në të cilat kërkohen të dhëna konkrete për regjistrimin personal; ✓ demonstroi <i>aftësi të sakta</i> për menaxhimin e të dhënave në kompjuter duke i kushtuar rëndësinë e duhur	Nxënësi: ✓ interpretoi <i>shumë saktë</i> skica dhe vizatime të objekteve të thjeshta teknike <i>në mënyrë të pavarur</i>; ✓ demonstroi <i>aftësi dhe shprehje të avancuara</i> të komunikimit grafik për të prezantuar ide dhe objekte të thjeshta teknike;



rëndësinë e duhur mbylljes së adresave personale në raste se punojnë në kompjuter publik.	mbylljes së adresave personale në raste se punojnë në kompjuter publik.	✓ demonstroi aftësi dhe shprehi krijuese në ndërtimin e maketeve të një zone të banuar.
Kompetenca IV : Teknologjia dhe veprimtaria ekonomike		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi analizon ndikimin e teknologjisë në veprimtaritë ekonomike, si edhe planifikon e realizon produkte dhe shërbime të thjeshta, me përdorimin e materialeve, veglave dhe proceseve të thjeshta teknologjike.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ demonstroi aftësi të pjesshme në vlerësimin e veprimtarisë dhe produktit përfundimtar, duke iu referuar planit të veprimit, recetës; ✓ organizon dhe menaxhon kryerjen e llogaritjeve të thjeshta të kostos së materialeve të produktit përfundimtar me vështirësi ; ✓ shfaq aftësi të jo të qëndrueshme për përpunimin e materialeve recikluese bazike nga ekonomia familjare dhe merr masa mbrojtjeje dhe për ruajtjen e mjedisit.	Nxënësi: ✓ demonstroi aftësi të mira në vlerësimin e veprimtarisë dhe produktit përfundimtar, duke iu referuar planit të veprimit, recetës; ✓ organizon dhe menaxhon saktë kryerjen e llogaritjeve të thjeshta të kostos së materialeve të produktit përfundimtar; ✓ shfaq aftësi të mira për përpunimin e materialeve recikluese bazike nga ekonomia familjare dhe merr masa mbrojtjeje dhe për ruajtjen e mjedisit.	Nxënësi: ✓ demonstroi aftësi dhe shprehi të avancuara në vlerësimin e veprimtarisë dhe produktit përfundimtar, duke iu referuar planit të veprimit, recetës; ✓ organizon dhe menaxhon në mënyrë të pavarur kryerjen e llogaritjeve të thjeshta të kostos së materialeve të produktit përfundimtar; ✓ shfaq aftësi shumë të mira për përpunimin e materialeve recikluese bazike nga ekonomia familjare dhe merr masa mbrojtjeje dhe për ruajtjen e mjedisit.
Kompetenca V : Etika dhe kushtet e sigurta në punë		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi zbaton rregullat për mbrojtje dhe siguri nga rreziqet në jetën e përditshme në shtëpi, shkollë dhe mjedisin përreth.		



NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ demonstroi <i>gjykime të pjesshme</i> për rregullat për mbrojtje dhe siguri nga rreziqet në jetën e përditshme në shtëpi, shkollë dhe mjedisin përreth; ✓ analizon duke shfaqur <i>qëndrime jo të qarta</i> për diversitetin individual në klasë, në shkollë dhe në jetë për të përmirësuar të kuptuarit dëshirat dhe aspiratat e të tjerëve, <i>duke mos menaxhuar si duhet</i> situatat dhe zgjidhjen e konflikteve në mënyrë konstruktive dhe paqësore; ✓ shfaq <i>aftësi të pjesshme</i> për rregullat e dërgimit të e-mailit dhe përdor në mënyrë të përshtatshme gjuhën sipas dërguesve; ✓ demonstroi <i>vështirësi</i> për menaxhimin e të dhënave në kompjuter duke i kushtuar rëndësinë e duhur mbylljes së adresave personale në raste se punojnë në kompjuter publik; ✓ demonstroi <i>vështirësi</i> në menaxhimin e etikës së	Nxënësi: ✓ demonstroi <i>saktë</i> rregullat për mbrojtje dhe siguri nga rreziqet në jetën e përditshme në shtëpi, shkollë dhe mjedisin përreth; ✓ vlerëson <i>në mënyrë të vazhdueshme</i> diversitetin individual në klasë, në shkollë dhe në jetë për të përmirësuar të kuptuarit dëshirat dhe aspiratat e të tjerëve, duke menaxhuar situatat dhe zgjidhjen e konflikteve në mënyrë konstruktive dhe paqësore; ✓ zbaton <i>saktë</i> rregullat e dërgimit të e-mailit dhe përdor në mënyrë të përshtatshme gjuhën sipas dërguesve; ✓ demonstroi <i>aftësi të sakta</i> për menaxhimin e të dhënave në kompjuter duke i kushtuar rëndësinë e duhur mbylljes së adresave personale në raste se punojnë në kompjuter publik; ✓ demonstroi aftësi të mira në menaxhimin e etikës së komunikimit gjatë dërgimit të e-mailit.	Nxënësi: ✓ demonstroi <i>shumë saktë</i> rregullat për mbrojtje dhe siguri nga rreziqet në jetën e përditshme në shtëpi, shkollë dhe mjedisin përreth; ✓ analizon duke shfaqur <i>qëndrime të sakta</i> për diversitetin individual në klasë, në shkollë dhe në jetë për të përmirësuar të kuptuarit dëshirat dhe aspiratat e të tjerëve, duke menaxhuar situatat dhe zgjidhjen e konflikteve në mënyrë konstruktive dhe paqësore; ✓ zbaton <i>shumë saktë</i> rregullat e dërgimit të e-mailit dhe përdor në mënyrë të përshtatshme gjuhën sipas dërguesve; ✓ organizon dhe menaxhon <i>në mënyrë të pavarur të</i> dhënat në kompjuter duke i kushtuar rëndësinë e duhur mbylljes së adresave personale në raste se punojnë në kompjuter publik; ✓ demonstroi aftësi shumë të mira dhe menaxhim të pavarur në menaxhimin e etikës së komunikimit gjatë dërgimit të e-mailit.



komunikimit gjatë dërgimit të e-maili-t.		
Kompetenca VI : Analizë e thelluar e të dhënave		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi analizon dhe interpreton të dhëna statistikore nëpërmjet programeve të paketës Windows Office. Zhvillon aftësi, qëndrime dhe njohuri që do t'i nevojiten atij në jetën e përditshme, por edhe për t'u aftësuar më shumë në përdorimin e thelluar të kompjuterit dhe internetit.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ analizon <i>saktë</i> të dhënat e qelizave në Excel sipas formulave; ✓ zotëron <i>aftësi të pjesshme</i> në krijimin e animacioneve origjinale ose dokumentarëve, duke u bazuar tek ngjarjet e komunitetit, lokalitetit dhe mjedisit shkollor; ✓ zotëron <i>aftësi të pjesshme</i> në përpunimin e fotografive si dhe zbaton formatet e ndryshme që ofron kompjuteri për ruajtjen e dokumenteve.	Nxënësi: ✓ analizon <i>saktë</i> të dhënat e qelizave në Excel sipas formulave; ✓ zotëron <i>aftësi të mira</i> në krijimin e animacioneve origjinale ose dokumentarëve, duke u bazuar tek ngjarjet e komunitetit, lokalitetit dhe mjedisit shkollor; ✓ përpunon <i>saktë</i> fotografitë si dhe zbaton <i>mirë</i> formatet e ndryshme që ofron kompjuteri për ruajtjen e dokumenteve.	Nxënësi: ✓ analizon <i>shumë saktë</i> të dhënat e qelizave në Excel sipas formulave; ✓ zotëron <i>aftësi të avancuara</i> në krijimin e animacioneve origjinale ose dokumentarëve, duke u bazuar tek ngjarjet e komunitetit, lokalitetit dhe mjedisit shkollor; ✓ përpunon fotografitë <i>në mënyrë rë pavarur</i> si dhe zbaton <i>shumë saktë</i> formatet e ndryshme që ofron kompjuteri për ruajtjen e dokumenteve.
Kompetenca VII: Motorët e kërkimit dhe mjetet mediatike		
Përshkrimi i kompetencës: Nxënësi specifikon motorët e kërkimit dhe është në gjendje të kërkojë informacione në portale të ndryshme elektronike duke përdorur në mënyrë të saktë mjetet mediatike, si dhe funksionin dhe rolin e secilit mjet për realizimin e kërkesave.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi:	Nxënësi:	Nxënësi:



9.1 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “ARTI PAMOR”

Faqe**131** nga **154**



✓ përmirëson punën duke u mbështetur kryesisht në modele të njohura dhe të gatshme; ✓ shpjegon temën dhe mënyrën e realizimit të punimit të tij; ✓ evidenton eksperiencën e tij në procesin krijues që nga ideja dhe realizimi nëpërmjet teknikës artistike.	✓ përmirëson punën duke u mbështetur në zgjidhje të ndryshme artistike; ✓ shpjegon temën, idenë dhe hapat e realizimit të punimit të tij; ✓ shpjegon eksperiencën e tij në procesin krijues që nga burimi i informacionit, ideja dhe realizimi nëpërmjet teknikës artistike.	✓ përzgjedh në mënyrë të pavarur elementët e duhur për të realizuar idetë artistike në krijim; ✓ përmirëson punën duke u mbështetur në zgjidhje të larmishme dhe të pavarura artistike; ✓ shpjegon temën, idenë, qëllimin dhe hapat e realizimit të punimit të tij; ✓ argumenton eksperiencën e tij në procesin krijues që nga burimi i informacionit, ideja dhe realizimi nëpërmjet teknikës së duhur artistike.
Kompetenca II : Realizimi i punimit		
Përshkrimi i kompetencës: Në realizimin e kësaj kompetence nxënësit përdorin teknikat artistike, elementet e artit pamor në lidhje me mesazhin që do të përcjellin në punën e tyre. Ata krijojnë punë origjinale nëpërmjet vëzhgimit direkt nga natyra ose nëpërmjet kujtesës së tyre mbi objektet, njerëzit, etj. dhe nëpërmjet imagjinatës. Nxënësit ndajnë eksperiencat e tyre krijuese dhe respektojnë mendimin e tjetrit. Ata zgjedhin ide dhe planifikojnë teknikat dhe mjetet për realizim e detyrës. Ekspeimentojnë me mjete dhe teknika për materializimin e idesë së tyre në punime dy dhe tredimensionale dhe vlerësojnë punën e tyre dhe të shokëve dhe eksperincën e tyre artistike.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ realizon punë dy dhe tredimensionale në art dhe dizajn nëpërmjet përdorimit	Nxënësi: ✓ realizon punë dy dhe tre dimensionale në art dhe dizajn nëpërmjet përdorimit të teknikave të ndryshme artistike;	Nxënësi: ✓ realizon punë dy dhe tre dimensionale në art dhe dizajn nëpërmjet përdorimit të teknikave të larmishme artistike;



të proceseve të thjeshta të teknikave artistike; ✓ realizon punë dy dhe tredimensionale nëpërmjet vëzhgimit direkt nga natyra ose modeleve të njohura; ✓ përdor teknika të ndryshme tradicionale duke ndjekur skema të gatshme për realizimin e punimit; ✓ eksperimenton me mjete dhe teknika të thjeshta tradicionale për të realizuar idenë në krijimin e tij; ✓ shpjegon teknikat e thjeshta tradicionale dhe mjetet e përdorura për realizimin e punimit; ✓ evidenton eksperiencën e tij në përdorimin e teknikave tradicionale artistike për realizimin e punimit.	✓ realizon punë dy dhe tredimensionale nëpërmjet vëzhgimit direkt nga natyra ose nëpërmjet kujtesës së tij mbi objektet, njerëzit, etj.; ✓ përdor mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme tradicionale dhe dixhitale për realizimin e punimit ✓ eksperimenton me teknika të ndryshme artistike për të realizuar idenë në krijimin e tij dhe për të dhënë mesazhin; ✓ shpjegon teknika të ndryshme artistike dhe mjetet e përdorura për realizimin e punimit; ✓ shpjegon eksperiencën e tij në përdorimin e teknikave të ndryshme artistike për realizimin e punimit.	✓ realizon punë dy dhe tredimensionale nëpërmjet vëzhgimit direkt nga natyra ose nëpërmjet kujtesës së tij mbi objektet, njerëzit, etj., dhe nëpërmjet imagjinatës; ✓ përdor mundësitë e shumta shprehëse të teknikave të ndryshme tradicionale dhe dixhitale për realizimin e punimit; ✓ eksperimenton me efektet e ndryshme të teknikave artistike për të realizuar idenë në krijimin e tij dhe për të dhënë mesazhin; ✓ shpjegon efekte të ndryshme të teknikave artistike dhe mjetet e përdorura për realizimin e punimit; ✓ vlerëson eksperiencën e tij në përdorimin e teknikave të larmishme artistike për realizimin e punimit.
Kompetenca III : Vlerësimi i veprave të artit		
Përshkrimi i kompetencës: Në realizimin e kësaj kompetence nxënësit identifikojnë elementët e gjuhës vizuale, teknikën, gjininë në një vepër arti dhe aspektin e tyre historik. Ata identifikojnë aspektin shprehës dhe simbolik duke shprehur emocionet e tyre, gjithashtu interpretojnë, argumentojnë dhe shprehin këndvështrimin e tyre për një vepër ose objekt artistik. Nxënësit përdorin një gjuhë specifike të përshtatshme për të përshkruar dhe komentuar veprat e artit dhe eksperiencën e tyre artistike. Identifikojnë elementë të eksperiencës së tyre artistike, çfarë kanë mësuar dhe metodat që kanë përdorur. Ata kuptojnë rëndësinë e rolit të artit pamor dhe artistit në shoqëri dhe identifikojnë një sërë profesioneve që lidhen me artin pamor.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV



Nxënësi: ✓ identifikon elementët e gjuhës vizuale, teknikën, gjininë në një vepër arti; ✓ identifikon vepra arti nga periudha të ndryshme historike; ✓ dallon aspektin shprehës dhe simbolik në një vepër ose objekt arti duke shprehur me vështirësi emocionet e tij; ✓ përdor një gjuhë specifike të thjeshtë për të përshkruar veprat e artit dhe eksperiencën e tij/saj artistike; ✓ evidenton rëndësinë e rolit të artit pamor dhe artistit në shoqëri dhe një sërë profesioneve që lidhen me artin pamor.	Nxënësi: ✓ shpjegon elementët e gjuhës vizuale, teknikën, gjininë në një vepër arti; ✓ shpjegon veprat e artit në aspektin e tyre historik; ✓ identifikon dhe shpjegon aspektin shprehës dhe simbolik në një vepër ose objekt arti duke shprehur emocionet e tij; ✓ përdor një gjuhë specifike të përshtatshme për të përshkruar dhe komentuar veprat e artit dhe eksperiencën e tij artistike; ✓ shpjegon rëndësinë e rolit të artit pamor dhe artistit në shoqëri dhe një sërë profesioneve që lidhen me artin pamor.	Nxënësi: ✓ vlerëson elementët e gjuhës vizuale, teknikën, gjininë në një vepër arti; ✓ vlerëson veprat e artit në aspektin e tyre historik; ✓ identifikon dhe vlerëson aspektin shprehës dhe simbolik në një vepër ose objekt arti duke shprehur emocionet e tij; ✓ përdor një gjuhë specifike të përshtatshme për të përshkruar, komentuar dhe vlerësuar veprat e artit dhe eksperiencën e tij artistike; ✓ vlerëson rëndësinë e rolit të artit pamor dhe artistit në shoqëri dhe një sërë profesioneve që lidhen me artin pamor.
---	---	--



Kompetenca I: Krijimi artistik

Në realizimin e kësaj kompetence nxënësit përdorin ide personale, elementet e gjuhës pamore dhe stimuj për krijim. Ata zbulojnë rrugë të ndryshme të kombinimit të elementeve të artit pamor për të realizuar idetë artistike. Nëpërmjet përdorimit të hapave të procesit krijues, ata përzgjedhin elementët e duhur të artit pamor dhe teknikave artistike për të realizuar tema të personalizuar. Përmirësojnë punën duke u mbështetur tek eksperimenti dhe në zgjidhje të ndryshme artistike duke analizuar burime të ndryshme informacioni dhe qëllimin krijues. Ata identifikojnë elementë të eksperiencës së tyre artistike, në krijim, çfarë kanë mësuar dhe metodat që kanë përdorur.

Faqe**135** nga **154**



zgjedhur të punimit të tij; ✓ evidenton eksperiencën e tij në procesin krijues që nga ideja dhe realizimi nëpërmjet teknikës artistike.	informacioni dhe shpjegon temën dhe idenë e punimit të tij; ✓ shpjegon eksperiencën e tij në procesin krijues që nga burimi i informacionit, ideja dhe realizimi nëpërmjet teknikës artistike.	✓ përzgjedh burime të ndryshme informacioni dhe shpjegon temën, idenë dhe qëllimin e tij krijues; ✓ vlerëson eksperiencën e tij në procesin krijues që nga burimi i informacionit, ideja dhe realizimi nëpërmjet teknikës së duhur artistike.
Kompetenca II: Realizimi i punimit Përshkrimi i kompetencës: Në realizimin e kësaj kompetence, nxënësi përdor teknikat artistike, elementët e artit pamor në lidhje me mesazhin që do të përcjellin në punë dy dhe tredimensionale, në art dhe dizajn. Krijon punë origjinale nëpërmjet vëzhgimit direkt nga natyra ose nëpërmjet kujtesës së tij mbi objektet, njerëzit, etj., ose nëpërmjet imagjinatës duke përdorur mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme artistike. Ai vlerëson eksperiencat e tij krijuese dhe respekton mendimin e tjetrit. Zgjedh ide dhe planifikon teknikat dhe mjetet e duhura për realizim. Eksperimenton me mjetet shprehëse të mjeteve dhe teknikave të ndryshme artistike për të materializuar idetë e tyre. Aalizon teknika të ndryshme artistike për qëllimin e tij krijues dhe identifikon elementë të eksperiencës së tij artistike në lidhje me realizimin e punimit, çfarë kanë mësuar dhe metodat që kanë përdorur.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ realizon punë dy dhe tredimensionale në art dhe dizajn nëpërmjet përdorimit të teknikave të thjeshta dhe modeleve të gatshme të organizimit të elementëve; ✓ realizon punë dy dhe tredimensionale nëpërmjet vëzhgimit direkt nga natyra ose modeleve të gatshme;	Nxënësi: ✓ realizon punë dy dhe tre dimensionale në art dhe dizajn nëpërmjet përdorimit të teknikave të ndryshme artistike dhe organizimit të elementëve; ✓ realizon punë dy dhe tredimensionale nëpërmjet vëzhgimit direkt nga natyra ose nëpërmjet kujtesës së tij mbi objektet, njerëzit, etj.;	Nxënësi: ✓ realizon në mënyrë të pavarur punë dy dhe tre dimensionale në art dhe dizajn nëpërmjet përdorimit të teknikave të larmishme artistike dhe organizimit të elementëve; ✓ realizon në mënyrë të pavarur punë dy dhe tredimensionale nëpërmjet vëzhgimit direkt nga natyra ose



✓ përdor mundësitë shprehëse të teknikave tradicionale sipas modeleve të gatshme në realizimin e punimit; ✓ përdor efekte të thjeshta të teknikave tradicionale sipas modeleve të dhëna, për të realizuar idenë në krijimin e tij; ✓ përshkruan hapat e teknikave artistike që ka përdorur në punimin e tij sipas modelit të dhënë; ✓ evidenton eksperiencën e tij/saj në përdorimin e teknikave të ndryshme artistike për realizimin e punimit.	✓ përdor mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme tradicionale dhe dixhitale në realizimin e punimit; ✓ eksperimenton me efektet e ndryshme të teknikave artistike për të realizuar idenë në krijimin e tij dhe për të dhënë mesazhin; ✓ shpjegon hapat e teknikave artistike, që ka përdorur për realizimin e punimit; ✓ shpjegon eksperiencën e tij në përdorimin e teknikave të ndryshme artistike dhe mundësitë e tyre shprehëse për realizimin e punimit.	nëpërmjet kujtesës së tij mbi objektet, njerëzit, etj., dhe nëpërmjet imagjinatës; ✓ përdor në mënyrë të pavarur mundësitë shprehëse të teknikave të ndryshme tradicionale dhe dixhitale në realizimin e punimit; ✓ eksperimenton në mënyrë të pavarur me efektet e ndryshme të teknikave artistike për të realizuar idenë në krijimin e tij dhe për të dhënë mesazhin; ✓ shpjegon hapat e teknikave artistike dhe mundësitë e tyre shprehëse që ka përdorur për realizimin e punimit; ✓ vlerëson eksperiencën e tij në përdorimin e teknikave të larmishme artistike dhe mundësitë e tyre shprehëse për realizimin e punimit.
---	---	--

Kompetenca III : Vlerësimi i veprave të artit

Përshkrimi i kompetencës:

Në realizimin e kësaj kompetence, nxënësit analizojnë dhe interpretojnë elementët e gjuhës pamore organizimin e tyre, teknikën, gjininë në një vepër arti Ata identifikojnë dhe vlerësojnë veprat e artit në aspektin e tyre historik dhe social kulturor. Nxënësit identifikojnë dhe argumentojnë aspektin shprehës dhe simbolik të veprës së artit, të punës së tyre dhe shokut/shoqes. Përdorin një gjuhë specifike të përshtatshme për të përshkruar dhe komentuar veprat e artit, punën e tyre, të shokut/shoqes dhe eksperiencën artistike. Identifikojnë elementë të eksperiencës së tyre artistike në vlerësimin e veprave të artit, çfarë kanë mësuar dhe metodat që



9.2 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “MUZIKË”

SHKALLA III		
Kompetenca I: Krijimi artistik		
Përshkrimi i kompetencës: Në realizimin e kësaj kompetence nxënësit njohin dhe përdorin ide të ndryshme për të organizuar krijimin muzikor, njohin dhe përdorin elementet muzikore gjatë krijimit, zhvillojnë ide të reja gjatë krijimit muzikor (<i>notat muzikore, vlerat e notave, shkallët muzikore, lidhja vlerëse dhe shprehëse etj., kohët e thjeshta/përbëra</i>), organizojnë krijimin e vet muzikor, sipas kërkesave dhe rregullave të një periudhe muzikore si dhe ndajnë përvojat e veta krijuese artistike me të tjerët.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ realizon krijimin muzikor duke zbatuar idenë sipas modelit të dhënë; ✓ përdor disa nga elementet muzikore (<i>notat muzikore, vlerat e notave, shkallët muzikore, lidhja vlerëse dhe shprehëse etj., koha 2/4,3/4,4/4, 3/8,6/8</i>) gjatë krijimit; ✓ zhvillon një ide të sugjeruar gjatë krijimit të vet muzikor;	Nxënësi: ✓ zhvillon me tej krijimin muzikor duke zbatuar idenë e dhënë, por edhe modifikuar atë sipas udhëzimeve; ✓ përdor mjaftueshëm elementet muzikore (<i>notat muzikore, vlerat e notave, shkallët muzikore, lidhja vlerëse dhe shprehëse etj., koha 2/4,3/4,4/4, 3/8,6/8</i>) gjatë krijimit të vet muzikor;	Nxënësi: ✓ krijon dhe përdor në punën e vet duke zbatuar ide të ndryshme gjatë krijimit muzikor; ✓ përdor të gjitha elementet muzikore (<i>notat muzikore, vlerat e notave, shkallët muzikore, lidhja vlerëse dhe shprehëse etj., koha 2/4,3/4,4/4, 3/8,6/8</i>) në krijime të ndryshme muzikore;



✓ organizon krijimin e vet muzikor, sipas modelit të dhënë; ✓ ndan përvojat e veta krijuese me të tjerët.	✓ zhvillon ide të ndryshme gjatë krijimit të vet muzikor; ✓ organizon krijimin e vet muzikor, sipas rregullave të strukturës së periudhës muzikore; ✓ ndan përvojat e veta krijuese dhe bashkëpunon me të tjerët.	✓ zhvillon ide të reja gjatë krijimit të vet muzikor; ✓ organizon krijimin e vet muzikor, sipas rregullave të strukturës së periudhës muzikore duke përdorur shumëllojshmëri elementesh muzikore; ✓ ndan dhe zhvillon më tej përvojat e veta krijuese me të tjerët.
--	---	---

Kompetenca II: Performimi/interpretimi muzikor

Përshkrimi i kompetencës:

Në realizimin e kësaj kompetence nxënësit njohin dhe zbatojnë teknikat e këndimit, të luajtjes në instrument, të dëgjimit dhe analizimit të veprave muzikore. Përmirësojnë dhe perfeksionojnë më tej mënyrën e të kënduarit, duke zbatuar saktë teknikat interpretimit dhe duke respektuar rregullat.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ zbaton teknikat e këndimit dhe të luajtjes në instrument; ✓ këndon duke zbatuar teknikat performimit/interpretimit muzikor; ✓ zbaton rregullat e luajtjes në instrument; ✓ ndan përvojat e veta performuese me të tjerë.	Nxënësi: ✓ këndon dhe luan pa gabime duke zbatuar teknikat e këndimit dhe të luajtjes në instrument. ✓ këndon me ndjenjë dhe emocion duke zbatuar teknikat performimit/interpretimit muzikor; ✓ respekton rregullat e luajtjes në instrumente; ✓ ndan përvojat e veta performuese dhe bashkëpunon me të tjerët.	Nxënësi: ✓ perfeksion më tej teknikat e këndimit, të luajtjes në instrument, së dëgjimit, analizimit të këngëve dhe pjesëve muzikore; ✓ perfeksion këndimin me ndjenjë dhe emocion, duke zbatuar teknikat performimit/interpretimit muzikor; ✓ luan në instrument me emocion, duke zbatuar rregullat e luajtjes në instrumente;



		✓ ndan dhe zhvillon më tej përvojat e veta performuese me të tjerë.
Kompetenca III: Vlerësimi i veprave muzikore		
Përshkrimi i kompetencës: Në realizimin e kësaj kompetence nxënësit njohin dhe analizojnë veprat muzikore, nga forma dhe gjini të ndryshme muzikore. Ata vlerësojnë veprat muzikore, duke bërë një gjykim kritik dhe estetik.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ dëgjon vepra të ndryshme muzikore të vendosura për dëgjim; ✓ identifikon veprat muzikore sipas periudhave të ndryshme historike; ✓ përjeton veprat muzikore, duke bërë një shpjegim personal të thjeshtë.	Nxënësi: ✓ dëgjon dhe përjeton emocionin që përcjellin veprat muzikore që nga format e vogla e deri tek ato të mëdhatë; ✓ shpjegon veprat muzikore dhe karakteristikat e tyre sipas periudhave të ndryshme historike; ✓ përjeton duke vlerësuar veprat muzikore dhe mban qëndrim personal ndaj tyre.	Nxënësi: ✓ dëgjon dhe analizon veprat muzikore që nga format e vogla e deri tek ato të mëdhatë; ✓ përdor një gjykim personal ndaj veprave muzikore, duke nxjerrë në pah karakteristikat e tyre sipas periudhave të ndryshme historike; ✓ përjeton duke vlerësuar veprat muzikore dhe bërë një gjykim kritik dhe estetik/artistik ndaj tyre.

SHKALLA IV
Kompetenca I: Krijimi artistik
Përshkrimi i kompetencës: Në realizimin e kësaj kompetence nxënësit njohin dhe përdorin ide të ndryshme për të organizuar krijimin e tyre muzikor, përdorin elementet e gjuhës muzikore (<i>ritmet e përziera 5/8,7/8,9/8, sinkopa dhe kontratempo, shkallët me 1 shenjë shartimi etj.,</i>) gjatë krijimeve të ndryshme, duke zhvilluar dhe ndërthurur ide të reja gjatë shpjegimit të krijimit muzikor. Ata organizojnë krijimin e vet muzikor (ritmet e përziera 5/8,7/8,9/8), sipas rregullave të shpjeguara duke ndarë përvojat e veta krijuese me të tjerët.



NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ realizon punën e vet duke zbatuar udhëzimet sipas modelit të dhënë; ✓ përdor disa nga elementet muzikore (<i>ritmet e përziera 5/8,7/8,9/8, sinkopa dhe kontratempo etj.,</i>) gjatë krijimit; ✓ zhvillon një ide të sugjeruar nga mësuesi gjatë krijimit muzikor; ✓ organizon krijimin e vet muzikor (<i>në kohët e mësuara 5/8,7/8,9/8</i>), sipas modelit të dhënë; ✓ ndan përvojat e veta krijuese me të tjerët.	Nxënësi: ✓ zhvillon krijimin muzikor, duke zbatuar ide të ndryshme por edhe modifikuar atë sipas udhëzimeve; ✓ përdor mjaftueshëm elementet muzikore (<i>ritmet e përziera 5/8,7/8,9/8, sinkopa dhe kontratempo etj.,</i>) gjatë krijimit të vet muzikor; ✓ zhvillon idenë muzikore gjatë krijimit të vet muzikor (<i>në kohët e mësuara 5/8,7/8,9/8</i>); ✓ ndan përvojat e veta krijuese dhe bashkëpunon me të tjerët.	Nxënësi: ✓ krijon dhe përdor në punën e vet duke zbatuar ide individuale gjatë krijimit muzikor; ✓ përdor të gjitha elementet e gjuhës muzikore gjatë krijimeve të veta muzikore; ✓ zhvillon dhe ndërthur ide të reja gjatë krijimit të vet muzikor (<i>në kohët e mësuara 5/8,7/8,9/8</i>); ✓ zhvillon më tej përvojat e veta krijuese me të tjerët.
Kompetenca II: Performimi/interpretimi muzikor		
Përshkrimi i kompetencës: Në realizimin e kësaj kompetence nxënësit njohin dhe interpretojnë këngën popullore shqiptare si pjesë e identitetit tonë kombëtar, duke zhvilluar më tej teknikat e këndimit. Perfeksionojnë këndimin gjatë interpretimit vokal popullor, por edhe të këngëve me tematika të tjera (të huaja), duke respektuar gjatë këndimit rregullat e këndimit solo dhe në grup. Ata interpretojnë me ndjenjë dhe emocion këngët popullore dhe ato për të rinj të mësuara duke bashkëpunuar dhe ndarë përvojat e veta interpretuese me të tjerë.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ zbaton teknikat e këndimit dhe interpretimit popullor dhe atij bashkëkohor (këngë për të rinj);	Nxënësi: ✓ këndon pa gabime duke zbatuar teknikat e këndimit dhe interpretimit popullor dhe atij bashkëkohor;	Nxënësi: ✓ zhvillon më tej teknikat e këndimit, teknikat e këndimit dhe interpretimit popullor dhe atij bashkëkohor;



✓ këndon duke zbatuar teknikat performimit/interpretimit muzikor; ✓ ndjek gjatë këndimit rregullat e këndimit solo në grup; ✓ ndan përvojat e veta interpretative me të tjerë.	✓ këndon me ndjenjë dhe emocion duke zbatuar teknikat performimit/interpretimit muzikor; ✓ zbaton gjatë këndimit rregullat e këndimit solo në grup; ✓ ndan përvojat e veta interpretative dhe bashkëpunon me të tjerët gjatë këndimit.	✓ perfeksionon teknikën vokale të këndimit gjatë interpretimit vokal; ✓ respekton gjatë këndimit rregullat e këndimit solo në grup; ✓ interpreton me ndjenjë dhe emocion këngët e mësuara; ✓ zhvillon më tej përvojat e veta interpretuese dhe bashkëpunon gjithmonë me të tjerë gjatë këndimit.
--	--	---

Kompetenca III: Vlerësimi i veprave muzikore

Përshkrimi i kompetencës:

Në realizimin e kësaj kompetence nxënësit njohin dhe evidentojnë vlerat e muzikës popullore shqiptare homofonike dhe polifonike, duke vlerësuar karakteristikat e tyre. Ata dëgjojnë, përjetojnë dhe vlerësojnë vepra muzikore klasike shqiptare dhe të huaja, të periudhave të ndryshme, duke u shprehur në forma të ndryshme dhe vlerësuar ato duke bërë një gjykim kritik dhe estetik.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ dëgjon muzikën popullore shqiptare dhe vepra të ndryshme muzikore të vendosura për dëgjim; ✓ identifikon muzikën popullore të trevave të ndryshme si dhe veprat muzikore sipas periudhave të ndryshme historike; ✓ përjeton muzikën popullore shqiptare si dhe veprat muzikore shqiptare nga repertori shqiptar dhe i huaj, duke bërë një shpjegim personal të thjeshtë.	Nxënësi: ✓ dëgjon dhe përjeton emocionin që përcjellin muzika popullore shqiptare dhe vepra të ndryshme muzikore të vendosura për dëgjim; ✓ shpjegon karakteristika të muzikës popullore nga treva të ndryshme dhe veprat muzikore sipas periudhave të ndryshme historike; ✓ përjeton duke vlerësuar muzikën popullore shqiptare, si dhe veprat muzikore shqiptare nga repertori	Nxënësi: ✓ dëgjon dhe analizon muzikën popullore shqiptare, si dhe veprat muzikore shqiptare nga repertori shqiptar dhe i huaj të periudhave të ndryshme, duke u shprehur në forma të ndryshme; ✓ përdor një gjykim personal ndaj muzikës popullore të trevave të ndryshme dhe veprave muzikore, duke nxjerrë në pah karakteristikat e



	shqiptar dhe i huaj duke mbajtur qëndrim personal ndaj tyre.	tyre sipas periudhave të ndryshme historike; ✓ vlerëson muzikën popullore shqiptare, si dhe veprat muzikore shqiptare nga repertori shqiptar dhe i huaj, duke bërë një gjykim kritik dhe estetik.
--	--	--

9.3 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË LËNDËN “TEATËR”

SHKALLA II-III (klasa V-VI)		
Kompetenca I: Krijimi i veprave teatrore		
Përshkrimi i kompetencës: Në realizimin e kësaj kompetence nxënësit njohin dhe përdorin ide të ndryshme për të organizuar mendimin teatror, duke përdorur elementet dhe gjuhën të interpretimit (<i>gjininë, logjikën, konvencionin, ngjarjen, shkak-pasojën, psikologjinë, besimin tek loja, të folurën publike, të qenët bindës, punën në ansambël, disiplinën skenike dhe rëndësinë e saj, etj.</i>), eksperimentojnë duke zbuluar dhe zhvilluar më tej idetë e veta artistike, organizojnë krijimin e vet në gjininë e teatrit, sipas elementeve të gjuhës teatrore, ose të elementeve të tjerë që përfshin ai (muzikë, arte pamore, etj.), duke ndarë përvojat e veta krijuese me të tjerët.		
NIVELI II	NIVELI II	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ krijon punën e vet duke zbatuar idenë sipas interpretimit dhe modelit të paraqitur; ✓ përdor disa nga elementet dhe gjuhën e interpretimit (<i>gjininë,</i>	Nxënësi: ✓ zhvillon punën e vet krijuese, duke zbatuar ide të ndryshme për të organizuar dhe qartësuar mendimin teatror, sipas udhëzimeve të dhëna;	Nxënësi: ✓ përdor ide të ndryshme për të organizuar dhe qartësuar mendimin teatror; ✓ përdor elementet dhe gjuhën e interpretimit, (<i>gjininë, logjikën,</i>



<i>logjikën, konvencionin , ngjarjen, shkak-pasojën, psikologjinë, besimin tek loja, të folurën publike, të qenët bindës, punën në ansambël, disiplinën skenike dhe rëndësinë e saj, etj.), për të eksperimentuar dhe idenë artistike sipas modelit të dhënë;</i> ✓ organizon krijimin e vet në gjininë e teatrit sipas modelit të dhënë; ✓ ndan përvojat e veta krijuese me të tjerët.	✓ përdor me korrektësi elementet dhe gjuhën e interpretimit, p.sh. (<i>gjininë, logjikën, konvencionin , ngjarjen, shkak-pasojën, psikologjinë, besimin tek loja, të folurën publike, të qenët bindës, punën në ansambël, disiplinën skenike dhe rëndësinë e saj, etj.), gjatë krijimit/punës artistike;</i> ✓ organizon krijimin e vet në gjininë e teatrit, sipas elementeve të gjuhës teatrore, dhe udhëzimeve të dhëna; ✓ ndan përvojat e veta krijuese dhe bashkëpunon me të tjerët.	<i>konvencionin , ngjarjen, shkak-pasojën, psikologjinë, besimin tek loja, të folurën publike, të qenët bindës, punën në ansambël, disiplinën skenike dhe rëndësinë e saj, etj.) duke eksperimentuar dhe zhvilluar më tej idetë e veta artistike;</i> ✓ organizon krijimin e vet në gjininë e teatrit, duke përdorur shumëllojshmëri të elementeve të gjuhës teatrore, ose të elementeve të tjerë që përfshin ai (muzikë, arte pamore, etj.); ✓ ndan dhe zhvillon më tej përvojat e veta krijuese me të tjerët.
---	---	---

Kompetenca II : Interpretimi i veprave teatrore

Përshkrimi i kompetencës:

Në realizimin e kësaj kompetence nxënësit familjarizohen me përmbajtje të ndryshme të veprave teatrore (*lojëra, rite, pjesë të shkurtra letrare, pjesë dramaturgjike*), zbatojnë teknika dhe procese të ndryshme interpretimi (*si: teknikën vokale të të folurit publik, teknikën e aktrimit në rrobën e personazhit, theksin logjik në përcjelljen e një mesazhi të caktuar apo të një tjetri, zbulon nëntekstin e fjalëve që përdorim në bisedë, ushtron të dëgjuarin dhe vëmendjen konkrete, përjeton shkollat e historinë e interpretimit gjatë zbulimit të tyre,*) duke respektuar rregullat dhe disiplinën e interpretimit skenik gjatë lojës skenike apo mbështetjes teknike. Gjithashtu ata ndajnë përvojat e veta skenike me të tjerë.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ familjarizohet me përmbajtje të ndryshme të veprave teatrore (<i>lojëra,</i>	Nxënësi:	Nxënësi:



<i>rite, pjesë të shkurtra letrare, pjesë dramaturgjike</i>); ✓ zbaton disa teknika dhe procese interpretimi në <i>(lojëra, rite, pjesë të shkurtra letrare, pjesë dramaturgjike)</i>; ✓ respekton mjaftueshëm rregullat dhe disiplinën e interpretimit skenik gjatë lojës skenike apo mbështetjes teknike; ✓ ndan përvojat e veta skenike me të tjerë.	✓ punon me përmbajtje të veprave teatrore <i>(lojëra, rite, pjesë të shkurtra letrare, pjesë dramaturgjike)</i>; ✓ zbaton teknika dhe procese të ndryshme interpretimi si: <i>(teknikën vokale të të folurit publik, teknikën e aktrimit në rrobën e personazhit, theksin logjik në përcjelljen e një mesazhi të caktuar apo të një tjetri, zbulon nëntekstin e fjalëve që përdorim në bisedë, ushtron të dëgjuarin dhe vëmendjen konkrete, përjeton shkollat e historinë e interpretimit gjatë zbulimit të tyre)</i>; ✓ respekton rregullat dhe disiplinën e interpretimit skenik gjatë lojës skenike apo mbështetjes teknike; ✓ ndan përvojat e veta skenike dhe interpretative dhe bashkëpunon me të tjerë.	✓ interpreton përmbajtje të ndryshme të veprave teatrore <i>(lojëra, rite, pjesë të shkurtra letrare, pjesë dramaturgjike)</i>; ✓ interpreton dhe përsos më tej teknika dhe procese të reja interpretimi si apo <i>(teknikën vokale të të folurit publik, teknikën e aktrimit në rrobën e personazhit, theksin logjik në përcjelljen e një mesazhi të caktuar apo të një tjetri, zbulon nëntekstin e fjalëve që përdorim në bisedë, ushtron të dëgjuarin dhe vëmendjen konkrete, përjeton shkollat e historinë e interpretimit gjatë zbulimit të tyre)</i>; ✓ perfeksion dhe zbaton rregullat dhe disiplinën e interpretimit skenik gjatë lojës skenike apo mbështetjes teknike; ✓ ndan dhe zhvillon më tej përvojat e veta skenike me të tjerë.
Kompetenca III : Vlerësimi i veprave teatrore		
Përshkrimi i kompetencës: Në realizimin e kësaj kompetence nxënësit njohin dhe analizojnë vepra të thjeshta teatrore <i>(reagojnë emocionalisht ndaj veprave teatrore përmes përjetimit, shikimit, krijimit dhe interpretimit, duke përjetuar dhe shprehur përjetimet personale mbi një pjesë teatrore dhe përdorur gjuhën artistike, prezanton punën e vet artistike, në veprimtaritë artistike të klasës apo të shkollës)</i> , duke i shpjeguar ato dhe duke mbajtur një qëndrim kritik dhe estetik.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV



Nxënësi: ✓ njeh dhe shpjegon vepra të thjeshta teatrore, duke i shpjeguar ato; ✓ vëzhgon dhe përjeton emocionalisht veprën skenike.	Nxënësi: ✓ analizon disa vepra teatrore, duke i shpjeguar ato me fjalë të thjeshta; ✓ mban një qëndrim ndaj veprave të llojeve të ndryshme skenike (komedi, dramë, tragjedi).	Nxënësi: ✓ analizon dhe mban qëndrim ndaj veprave të ndryshme teatrore shqiptare dhe të huaja, duke i shpjeguar ato; ✓ përjeton dhe mban një qëndrim kritik dhe estetik.
---	---	--

10 NIVELET E ARRITJES SË KOMPETENCAVE NË FUSHËN “EDUKIMI FIZIK, SPORTE DHE SHËNDEI”

SHKALLA III		
Kompetenca I: Shfaq aftësi lëvizore në përshtatje me situata të ndryshme lëvizore e sportive		
Përshkrimi i kompetencës: Në realizimin e kësaj kompetence nxënësit njohin dhe ekzekutojnë përmes: <i>koordinimit, rregullimit, kontrollit, ndjesive dhe shprehive</i> , të cilat i referohen aftësisë për të ekzekutuar veprime të ndryshme lëvizore sipas njësive themelore motore si (<i>përkulje, rrotullim, hedhje, ngritje, vertikale, zvarritje, fluturim, lekundje, kaperdimje</i>), e cila zhvillohet në situata të larmishme të të nxënit të lidhura me lloje të shumta aktiviteteve si p.sh: <i>kombinime me përmbajtje të lëvizjeve lokomotore (vrapimi, ecja, notimi, çiklizmi, etj.) dhe lëvizje jolokomotore si (kërcimi, goditja, xhonglimi, etj.), lëvizje manipulative me dhe pa mjete, kombinime teknike e artistike (gjimnastika artistike e ritmike, cirkuite gjimnastikore, stafeta lëvizore).</i>		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ <i>demonstron pjesërisht elementë të ndryshëm të kombinacioneve lëvizore;</i>	Nxënësi: ✓ <i>zbaton elementë të ndryshëm lëvizorë si, ekuilibrim, kthim, rrotullim, goditje ecje, vrapim, kërcim me dhe pa mjete;</i>	Nxënësi: ✓ <i>zotëron teknikën e elementëve gjatë ekzekutimit të kombinacioneve lëvizore të ndryshme jolokomotore</i>



✓ <i>demonstron</i> me vështirësi kryerjen e elementëve akrobatik; ✓ <i>demonstron</i> mjaftueshëm elementet teknike të lojrave spotive; ✓ <i>demonstron</i> kombinime të thjeshta lëvizore sipas situatave të ndryshme; ✓ <i>demonstron</i> mjetet dhe rregullat e kryerjes së marshimit në natyrë.	✓ <i>zbaton</i> koordinim të pjesshëm të elementëve akrobatik të thjeshtë; ✓ <i>zbaton</i> teknikë të mirë në kryerjen e elementëve gjatë një situatë loje mësimore (B.boll, V.boll, H.boll, F.boll); ✓ <i>zbaton</i> mirë elementet levizore gjatë një situatë gjatë lojës; ✓ <i>zotëron</i> njohuri mbi metodat e përshtatshme të kryerjes së veprimtarisë (marrshimit) në natyrë.	(tërheqje, shtytje, ekuilibrim, kthim, rrotullim, xhonglim, goditje etj.), lokomotore (ecje, vrapim, kërcim etj.) dhe manipulative me ose pa mjete; ✓ <i>realizon</i> saktë teknikën e elementëve akrobatikë; ✓ <i>realizon</i> saktë elementë teknikë të lojërave sportive (pasim, driblim, gjuajtje, shërbim); ✓ <i>realizon</i> kombinime lëvizore të sakta në situatave të ndryshme të lojërave sportive; ✓ <i>zotëron</i> aftësi dhe njohuri në zhvillimin e kryerjen e veprimtarive në natyrë(marrshimit).
---	---	--

Kompetenca II: Ndërvepron me të tjerët në situata të ndryshme lëvizore e sportive

Përshkrimi i kompetencës:

Në realizimin e kësaj kompetence nxënësit angazhohen në një proces ku ata zhvillojnë plane të ndryshme të veprimit për të përshtatur e sinkronizuar lëvizjet e tyre me ato të të tjerëve, si dhe për të komunikuar me njëri-tjetrin. Nxënësit mësojnë punën në grup, kryejnë detyra të përbashkëta dhe pranojnë drejt fitoren dhe humbjen. Duke pasur parasysh se nxënësit do të përballen me situata të ngjashme në jetën e tyre të përditshme, kjo kompetencë i ndihmon ata të zhvillojnë aftësitë sociale dhe gjykime etike të favorshme për të ndërtuar marrëdhënie harmonike ndërpersonale.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ <i>demonstron</i> rregullat në lojëra të ndryshme lëvizore, popullore dhe sportive;	Nxënësi: ✓ <i>shfaq</i> aftësi të mira njohëse mbi rregullat në lojëra të ndryshme lëvizore, popullore dhe sportive;	Nxënësi: ✓ <i>njih dhe realizon</i> me saktësi rregullat në lojëra të ndryshme lëvizore, popullore dhe sportive;



KompetencaIII : Përshtat një stil jete aktiv e të shëndetshëm

Në realizimin e kësaj kompetence nxënësit mësojnë të përshtatin një stil jetese aktiv dhe të shëndetshëm për të krijuar mundësitë e një jete, e cila karakterizohet nga një *mirëqenie e përgjithshme fizike, mendore dhe emocionale*, në të cilën një individ gëzon aftësi për të ekzekutuar çdo ditë detyra energjike dhe aktivisht, kryen me kënaqësi veprimtaritë e kohës së lirë dhe realizon lehtësisht kërkesat e ditës. Për nxënësit kjo kompetencë zhvillohet me edukimin e zakoneve të shëndetshme, angazhimin në forma të ndryshme të veprimtarisë fizike e sportive, të ushqyerit në mënyrën e duhur, mosekspozimin ndaj substancave që krijojnë varësi, duke krijuar një model jetese e cila do të sillte efekte të pëlqyeshme afatshkurtra, afatmesme e afatgjata.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ <i>demonstron</i> rregullat e organnizimit dhe ushtrimit fizik e sportiv gjatë një veprimtarie;	Nxënësi: ✓ <i>zotëron njohuri</i> mbi planifikimin dhe ushtrimin e veprimtarisë fizike jashtëshkllore;	Nxënësi: ✓ <i>zhvillon</i> plane individuale e të përgjithshme të ushtruarit me veprimtari fizike e sportive, jashtë programit mësimor;

✓ <i>demonstron njohuri të kufizuara mbi mirëqënien fizike dhe emocionale;</i> ✓ <i>demonstron emocione të kufizuara gjatë veprimtarisë sportive;</i> ✓ <i>demonstron interes në veprimtari fizike e sportive që shkolla organizon brenda dhe jashtë programit mësimor;</i> ✓ <i>demonstron rregullat e higjienës personale dhe ruajtjes së mjedisit sportiv;</i> ✓ <i>demonstron njohuri mbi vlerat ushqimore dhe rregullat për një ushqim më të shëndetshëm;</i> ✓ <i>demonstron njohuri të kufizuara mbi medikamente ndaj të cilave krijohet varësi dhe ndikime negative;</i> ✓ <i>demonstron rregullat respektimit dhe të ruajtjes së ambientit ku jeton dhe mëson.</i>	✓ <i>zotëron njohuri mbi vlerat fizike, emocionale e mendore për rritjen e mirëqënies shëndetsore;</i> ✓ <i>zbaton situata bashkëpunimi dhe i përshtat ato në situata të ndryshme (psh. pune në grupe, loje në shkollë dhe jashtë saj etj);</i> ✓ <i>tregon aftësi menaxhuese gjatë organizimit të aktiviteteve brenda dhe jashtë shkollës;</i> ✓ <i>shfaq aftësi mbi rregullat e ruajtjes së higjienës personale, si dhe të mjedisit në shtëpi, shkollë e komunitet;</i> ✓ <i>zotëron aftësi mbi vlerat dhe përfitimet që sjellin produktet ushqimore mbi plotshëndetshëmri;</i> ✓ <i>identifikon medikamente ndaj të cilave krijohet varësi dhe kupton ndikimet negative të tyre në shëndetin dhe mirëqënien e tij;</i> ✓ <i>zbaton mënyra të respektimit dhe të ruajtjes së ambientit ku jeton: shkollë, shtëpi e më gjerë.</i>	✓ <i>argumenton vlerat e veprimtarisë fizike në rritjen e mirëqënies fizike, emocionale e mendore të tij;</i> ✓ <i>menaxhon emocionet e tij dhe i përshtat ato në situata të ndryshme (psh. pune në grupe, loje në shkollë dhe jashtë saj etj);</i> ✓ <i>zotëron njohuri dhe aftësi në kryerjen e aktiviteteve dhe veprimtarive fizike e sportive që shkolla organizon brenda dhe jashtë programit mësimor;</i> ✓ <i>zbaton me korrektësi rregullat e ruajtjes së higjienës personale, si dhe të mjedisit në shtëpi, shkollë e komunitet;</i> ✓ <i>ndërton dhe zhvillon plane për ushqim të shëndetshëm(dieta) dhe argumenton vlerat e tyre sipas sezoneve, periudhave ditore;</i> ✓ <i>zotëron shkallën e rrezikshmërisë të përdorimit të medikamente ndaj të cilave krijohet varësi dhe ndikime negative për shëndetin dhe mirëqënien e tij;</i> ✓ <i>zotëron qëndrime dhe vlera mbi mënyrën e respektimit dhe kujdesit ndaj ambientit ku jeton e mëson dhe</i>
---	---	--



		nxit frymën e bashkëpunimit me individë ose në grup.
--	--	--

SHKALLA IV

Kompetenca I: Shfaq aftësi lëvizore në përshtatje me situata të ndryshme lëvizore e sportive

Përshkrimi i kompetencës:

Në realizimin e kësaj kompetence nxënësit njohin dhe ekzkeutojnë përmes: *koordinimit, rregullimit, kontrollit, ndjesive dhe shprehjeve*, të cilat i referohen aftësisë për të ekzekutuar veprime të ndryshme lëvizore sipas njësive themelore motore si *(përkulje, rrotullim, hedhje, ngritje, vertikale, zvarritje, fluturim, lëkundje, kapërdimje, flakje, shtytje)*, e cila zhvillohet në situata të larmishme të të nxëniet të lidhura me lloje të shumta aktivitetesh si p.sh: *kombinime me përmbajtje të lëvizjeve lokomotore (vrapimi, ecja, notimi, çiklizmi, etj.) dhe lëvizje jolokomotore si (kërcimi, goditja, xhonglimi, etj.), lëvizje manipulative me dhe pa mjete, kombinime teknike e artistike (gjimnastika artistike e ritmike).*

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ <i>demonstron</i> elementet teknike (të vrapimit , të kërcimit, hedhjes etj.) gjatë të ushtruarit në situata të ndryshme lëvizore e sportive; ✓ <i>demonstron</i> elemente të kombinacionit lëvizor me dhe pa mjete (<i>cirkuide, stafeta</i>); ✓ <i>demonstron</i> elementë akrobatike të thjeshtë; ✓ <i>demonstron</i> teknikën e duhur të vrapimeve (të shpejtësisë, të qendrueshmërisë, me pengesa, etj.);	Nxënësi: ✓ <i>zbaton</i> teknika lëvizore (të vrapimit, të kërcimit, hedhjes etj) gjatë të ushtruarit në situata të ndryshme lëvizore e sportive; ✓ <i>zbaton</i> kombinacione lëvizore me përmbajtte të aftësive lëvizore bazë, të manipulimit lëvizor me dhe pa mjete (<i>cirkuide, stafeta</i>); ✓ <i>zbaton</i> teknikën e elementëve akrobatike gjatë kombinacioneve lëvizore pa muzikë;	Nxënësi: ✓ <i>zotëron</i> teknika lëvizore (të vrapimit, të kërcimit, hedhjes etj) gjatë të ushtruarit në situata të ndryshme lëvizore e sportive; ✓ <i>zotëron</i> aftësi mbi zhvillimin e kombinacioneve të larmishme lëvizore me përmbajtte të aftësive lëvizore bazë, të manipulimit lëvizor me dhe pa mjete(<i>cirkuide, stafeta</i>); ✓ <i>zotëron</i> aftësi mbi zhvillimin kombinacioneve me elementë akrobatikë të thjeshtë te kombinuar



✓ <i>demonstron pjesërisht</i> fazat e teknikës së kercimit (vrulli, rrahja, fluturimi dhe renia); ✓ <i>demonstron</i> elementët teknikë (driblim, pasim, gjuajtje etj); ✓ <i>demonstron</i> rregullullat e marrshimit dhe vrapimit në natyrë.	✓ <i>zbaton</i> fazat e teknikës së vrapimeve (nisja nga starti, vrapimi në distancë, vrapimi midis pengesave, vrapimi në finish.); ✓ <i>zbaton dhe ekzekuton</i> skemën e plotë të fazave të kërcimit; ✓ <i>zbaton</i> kombinime lëvizore me elemente teknike të basketbollit, volejbollit dhe futbollit etj, në situata loje mësimore; ✓ <i>zbaton</i> rregullat e kryerjes së veprimtarive (marshimit dhe vrapimit) në natyrë.	me lëvizje artistike të shoqëruar me muzikë; ✓ <i>zotëron aftësi</i> në kryerjen e fazave dhe elementëve teknikë të vrapimeve (të shpejtësisë, të qendrueshmërisë, me pengesa, etj.); ✓ <i>zotëron</i> teknikën në kërcime: së gjati dhe së larti (stil “gërshërë”); ✓ <i>zotëron</i> teknikën e elementëve kryesore të lojërave: basketboll, volejboll dhe futboll, si dhe i aplikon saktë ato gjatë situatave të lojës; ✓ <i>zotëron aftësi</i> drejtuese në organizimin e marrshimit dhe vrapimit në natyrë.
--	--	---

Kompetenca II : Ndërvepron me të tjerët në situata të ndryshme lëvizore e sportive

Përshkrimi i kompetencës:

Në realizimin e kësaj kompetence nxënësit angazhohen në një proces ku ata zhvillojnë plane të ndryshme të veprimit për të përshtatur e sinkronizuar lëvizjet e tyre me ato të të tjerëve, si dhe për të komunikuar me njëri-tjetrin. Nxënësit mësojnë punën në grup, kryejnë detyra të përbashkëta dhe pranojnë drejt fitoren dhe humbjen. Duke pasur parasysh se nxënësit do të përballen me situata të ngjashme në jetën e tyre të përditshme, kjo kompetencë i ndihmon ata të zhvillojnë aftësitë sociale dhe gjykime etike të favorshme për të ndërtuar marrëdhënie harmonike ndër personale.

NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ <i>demonstron qëndrime dhe vlera në kryerjen në lojëra të ndryshme lëvizore, popullore dhe sportive;</i>	Nxënësi: ✓ <i>zbaton rregullat e organizimit të lojërave të ndryshme lëvizore, popullore dhe sportive;</i>	Nxënësi: ✓ <i>zotëron aftësi menaxhuese mbi organizimin dhe drejtimin e</i>



Kompetenca III: Përshtat një stil jete aktiv e të shëndetshëm		
Përshkrimi i kompetencës: Në realizimin e kësaj kompetence nxënësit mësojnë të përshtatin një stil jetese aktiv dhe të shëndetshëm për të krijuar mundësitë e një jete, e cila karakterizohet nga një mirëqenie e përgjithshme fizike, mendore dhe emocionale, në të cilën një individ gëzon aftësi për të ekzekutuar çdo ditë detyra energjikut dhe aktivisht, kryen me kënaqësi veprimtaritë e kohës së lirë dhe realizon lehtësisht kërkesat e ditës. Për një nxënës kjo kompetencë zhvillohet me edukimin e zakoneve të shëndetshme, angazhimin në forma të ndryshme të veprimtarisë fizike e sportive, të ushqyerit në mënyrën e duhur, mosekspozimin ndaj substancave që krijojnë varësi, duke krijuar një model jetese e cila do të sillte efekte të pëlqyeshme afatshkurtra, afatmesme e afatgjata.		
NIVELI II	NIVELI III	NIVELI IV
Nxënësi: ✓ <i>demonstron</i> rregullat e duhura të nxehtësisë së trupit në përshtatje me	Nxënësi:	Nxënësi: ✓ <i>zotëron</i> rregullat e duhura të nxehtësisë së trupit në përshtatje me llojin e

